

1 E mërkurë, 4 dhjetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo
8 është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër
9 Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup
10 Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të
12 vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë W04401.

13 Për procesverbal vërej që të akuzuarit janë në sallë.

14 Përpara sesa të vijë i akuzuari në sallë, Trupi Gjykues
15 do të lëshojë shtatë urdhra me gojë.

16 Së pari, Trupi Gjykues do të lëshojë vendimin e vet
17 lidhur me kundërshtimet e Mbrojtjes që ka të bëjë me
18 përdorimin nga ZPS-ja të dy dokumenteve për pyetjet plotësuese
19 për dëshmitarin.

20 Znj. Sekretare, ju lutem na sillni në seancë private.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
14 jemi në seancë publike.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses
16 tani do të nxjerrë një urdhër gojor që pranon provën P01874 në
17 prova. Kjo është një provë që deri tani ka pasur numër
18 provizor prove.

19 ZPS-ja ka kërkuar pranimin e dokumentit 01879 në prova
20 gjyqësore pasi ka përdorur pjesë të caktuara të dokumentit me
21 Dëshmitarin 04401 gjatë pyetjeve të dëshmitarit. Trup vëren që
22 dokumenti përbëhet nga një historik i aktivitetit ose
23 veprimtarisë së LPK-së i përgatitur nga Emrush Xhemajli.

24 ZPS-ja ka parashtruar se ky dokument është diskutuar në
25 mënyrë të përsëritur në Gjykatë gjatë javës së fundit gjatë

1 dëshmisë me këtë dëshmitar dhe Dëshmitarin 03873 dhe për
2 pasojë është *prima facie* i pranueshëm.

3 Mbrojtja e Thaçit dhe e Veselit u përgjigjën që
4 Dëshmitari 04401 nuk ka dhënë dëshmi sa i takon rrethanave në
5 të cilat është krijuar ky dokument dhe as nuk ka vërtetuar
6 autenticitetin apo ka pranuar propozimet e dhëna në këtë
7 dokument.

8 Trupi Gjykses vëren që dokumenti është përdorur në mënyrë
9 të gjerësishme gjatë pyetjeve nga Prokuroria të Dëshmitarit
10 04401, ashtu edhe pyetjeve nga Mbrojtja e z. Krasniqi. Kur u
11 përball me dokumentin dëshmitari komentoi lidhur me të dhe
12 ofroi pikëpamjet e veta sa i takon konsistencës së vetme
13 programin dhe statutin e LPK-së në përshkrimin dhe krijimin e
14 forcës ushtarake brenda LPK-së dhe kalimit të LPK-së nga puna
15 politike në punën ushtarake. Autori i dokumentit është
16 identifikuar me emër, organizatën në të cilën lidhet është e
17 identifikuar dhe dokumenti mban një datë.

18 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses është i bindur që dokumenti
19 me numër prove provizore P01874 është autentik *prima facie* dhe
20 ka vlerë provuese. Duke marrë parasysh faktin që Mbrojtja ka
21 pasur mundësi që të marrë dëshmitarin në pyetje lidhur me këtë
22 dokument, Trupi Gjykses është i bindur që vlera provuese e
23 P01874 nuk zhbëhet nga efekti cenues.

24 Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykses e pranon
25 provën 01874 në prova të përhershme.

1 Ky është fundi i urdhrit të dytë me gojë.

2 Trupi tani do të nxjerrë një urdhër që kundërshton
3 pranimin e dokumentit që ka numër provizor prove P01879.

4 ZPS-ja ka kërkuar pranimin në prova të dokumentit P01879
5 pasi ka diskutuar pjesë të caktuara të dokumentit me
6 Dëshmitarin 04401 gjatë marrjes në pyetje të tij. Trupi
7 Gjykues vëren se dokumenti pretendohet që të jetë një studim i
8 LPK-së mbi taktikat, inteligjencën që pretendohet që të jetë
9 marrë nga forcat serbe në Kosovë dhe që t'i jetë dhënë TPNJ-
10 së.

11 Mbrojtja e Thaçit dhe Veselit kanë kundërshtuar pranimin
12 e dokumentit duke argumentuar që kriteret e rregullës 138 në
13 veçanti sa i takon autenticitetit, autorësisë dhe origjinës
14 nuk janë përmbushur dhe se dokumenti nuk mund të pranohet
15 vetëm mbështetur në ngjashmëri të caktuara që pretendohet që
16 të kenë me përshkrimin e dëshmitarit sa i takon përpjekjeve
17 kundër kolaboracioniste të UÇK-së.

18 Pasi e ka rishikuar dokumentin që i ka caktuar numër
19 provizor prove P01879 dhe pjesëve të transkriptit ku
20 Dëshmitari 04401 ka folur lidhur me dokumentin, Trupi Gjykues
21 është i bindur që ky dokument ka relevancë *prima facie* të
22 këtyre pjesëve të dokumentit që janë diskutuar me dëshmitarin
23 dhe që janë tani pjesë e procesverbalit së bashku me komentet
24 e dëshmitarit dhe të cilat mund të përdoren si bazë nga ZPS-ja
25 për arsye ngjashmërie.

1 Tani duke iu kthyer kundërshtimit të Mbrojtjes lidhur me
2 origjinën e dokumentit që origjina, pra, nuk është vërtetuar,
3 Trupi Gjykses kujton që prova e autorësisë ose origjinës së
4 një dokumenti nuk është parakusht për pranueshmërinë e tij në
5 prova, me kusht që pala kërkuese të ketë vërtetuar ndryshe
6 autenticitetin dhe besueshmërinë *prima facie*. Çështjet e
7 autorësisë dhe të origjinës kanë të bëjnë me peshën që do i
8 japi provës Trupi Gjykses dhe jo me pranueshmërinë e
9 dokumentit, kështu që Trupi Gjykses vendosë që duhen marrë
10 parasysh e gjithë prova në vetvete.

11 Në rrethanat aktuale, Trupi Gjykses ka mendimin që fakti
12 që studimi i LPK-së pretendon që përmban ngjashmëri me mënyrën
13 se si e ka kuptuar dëshmitari rolin ose përpjekjet anti-
14 kolaboracioniste të UÇK-së nuk është e mjaftueshme për të
15 vërtetuar autenticitetin *prima facie* të këtij dokumenti.

16 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka
17 arritur të vërtetojë ose të tregojë indicie të mjaftueshme
18 *prima facie* për sa i takon autenticitetit për studimit të LPK-
19 së dhe pranimit të dokumentit. Dhe kjo është pacenuar të
20 drejtën e ZPS-së për të kërkuar që dokumenti të përmbushë
21 kërkesat e rregullës 138(1).

22 Për këtë arsye, Trupi Gjykses nuk e pranon në prova
23 provën P01879 numër MFI.

24 Kjo përfundon urdhrin e tretë gojor.

25 Trupi Gjykses tani do të nxjerrë një urdhër që

1 kundërshton pranimin e dokumentit 1D00219 MFI dhe 1D00220 në
2 prova gjyqësore.

3 Mbrojtja e Thaçit kërkoi që të regjistrohej në prova
4 dokumenti 1D00219 - që është një shënim i përgatitur nga
5 Mbrojtja e Thaçit sa i takon takimit me Dëshmitarin 04401 -
6 dhe dokumentin 1D00221 - që është një korrigjim i këtij
7 dokumenti - pasi e ka diskutuar atë me Dëshmitarin 04401 dhe
8 të dyja dokumentet janë diskutuar gjatë marrjes në pyetje të
9 dëshmitarit nga Mbrojtja e Thaçit.

10 Mbrojtja argumenton që pranimi i të dy dokumenteve nuk
11 pengohet ose nuk ndalohet nga rregullat 152 deri në 155 të
12 Trupit Gjyqës, kështu që ky dokument duhet që të pranohet
13 sipas rregullës 138(1).

14 ZPS-ja kundërshtoi pranimin e dokumentit 1D00219 dhe
15 1D00221, duke argumentuar se ndryshe nga ajo çfarë ka ndodhur
16 në të shkuarën, dokumentet nuk janë diskutuar gjatë seancave
17 përgatitore me dëshmitarin, i cili ka pasur mundësi që të
18 rishikojë këto dy dokumente dhe të bëjë korrigjime në të.

19 Në fillim, Trupi Gjyqës vëren se rregulla 143(3) nuk
20 mbulon çështjen e pranueshmërisë së materialit të përdorur nga
21 pala e pyetjeve plotësuese, por fushëveprimin e pyetjeve të
22 lejueshme gjatë pyetjeve të Mbrojtjes.

23 Trupi Gjyqës vëren se Mbrojtja e Thaçit ka përdorur
24 dokumentin 1D00219 dhe 1D00220 gjatë pyetjeve të dëshmitarit
25 për sa i takon besueshmërisë së dëshmitarit. Lidhur me pjesën

1 e shënimeve të citat janë diskutuar me dëshmitarin si dhe
2 komentet që ai ka dhënë lidhur me këto pjesë, këto janë në
3 procesverbal dhe do të shqyrtohen siç duhet nga Trupi Gjykses
4 kur të bëjë vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit në
5 kuadër të tërësisë së provave.

6 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses është i mendimit që pranimi
7 në prova i shënimit dhe korrigjimeve nuk duhet të lejohet në
8 këtë fazë.

9 Në këtë kuadër, Trupi Gjykses nuk e pranon dokumentin
10 1D00219 dhe 1D00221 në prova pa paragjykim.

11 Kjo përfundon urdhrin e katërt gojor.

12 Trupi Gjykses tani do të nxjerrë një urdhër gojor që do
13 të pranojë pjesë të caktuara të provës me numër provizor prove
14 P01883 dhe P01884.

15 ZPS-ja ka kërkuar që të pranohen në prova gjyqësore
16 dokumente që tani kanë numër provizor prove P01883 dhe 10884,
17 pasi i kanë treguar një faqe për secilin prej dy dokumenteve
18 Dëshmitarit 04401 gjatë pyetjeve plotësuese për këtë
19 dëshmitar. Trupi Gjykses vëren se dokumenti përbëhet nga një
20 kapitull i një libri që përmban një intervistë me Rexhep
21 Selimin dhe një intervistë me Sylejman Selimin.

22 ZPS-ja ka kërkuar pranueshmërinë e të dyja intervistave
23 të plota, duke parashtruar se të dyja janë relevante dhe kanë
24 vlerë provuese dhe duhet që të kuptohen në tërësinë e tyre.

25 Mbrojtja e Veselit dhe Selimit kërkuar që vetëm ato faqe

1 që ju treguan dëshmitarit të pranohen dhe të gjitha, të dyja
2 intervistat.

3 Trupi Gjykues vëren se intervistat janë voluminoze, duke
4 marrë parasysh faktin që ZPS-ja ka përdorur vetëm një faqe të
5 secilës prej këtyre për pyetje plotësuese të dëshmitarit.

6 Për rrjedhojë, në këtë logjikë, Trupi Gjykues pajtohet me
7 argumentet e Mbrojtjes së Veselit dhe Selimit që pranimi në
8 tërësinë e vet të këtyre intervistave mbështetur në dëshminë e
9 dhënë nga dëshmitari, nuk është një proces i duhur në këtë
10 pikë. Kjo nuk cenon të drejtën e ZPS-së që të kërkoj pranimi e
11 të gjithë dokumenteve në tërësinë e tyre në të ardhmen duke
12 përfshirë dhe dëshmitarët përkatës ose përmes provave jo
13 gojore të tyre.

14 Trupi Gjykues është i bindur që pjesët e intervistave të
15 cilat ju treguan dëshmitarit janë relevante, kanë autenticitet
16 *prima facie* dhe kanë vlerë provuese, për rrjedhojë ato
17 përmbushin kriteret e rregullës 138(1) për pranim. Trupi
18 Gjykues vëren se Mbrojtja e Veselit dhe e Selimit nuk kanë
19 kundërshtuar pranimin e pjesëve të intervistës të cilët janë
20 diskutuar nga dëshmitari. Për rrjedhojë, Trupi Gjykues
21 konstaton vlerën provuese të pjesëve të tilla dhe mendon që
22 kjo vlerë provuese nuk zhbëhet nga asnjë efekt cenues.

23 Duke marrë parasysh sa më sipër, Trupi Gjykues pranon
24 faqen SPOE00131856 të provës P01883 dhe faqen 6D00078 të
25 provës P01884 në prova gjyqësore dhe udhëzon Zyrën

1 Administrative që të shtojë faqen e provuar nga prova P01884
2 në provën ekzistuese P01745.

3 Këtu përfundon urdhri i pesë gojor.

4 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
5 këshillohen]

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sa
7 për sqarim për procesverbal, a mund ta heq numrin P01884?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

9 Numri 01884 është i lirë tanimë sepse kemi bashkuar dy
10 dokumente bashkë dhe faqja është shtuar në një provë përkatëse
11 të mëparshme.

12 Trupi Gjykses tani do të nxjerrë një urdhër gojor që
13 lidhet me versionin e konsoliduar të pjesëve të pranuar të
14 librit të z. Krasniqi.

15 Trupi Gjykses vëren se në emailin e dërguar më datë 30
16 tetor 2024, ZPS-ja ka propozuar që për arsye reference një
17 version i konsoliduar i të gjitha pjesëve të pranuar të
18 librit të z. Krasniqi të krijohet duke shtuar faqet përkatëse
19 nga provat P00765 dhe P012777 në provën P00189 dhe të
20 vazhdohet më tej që të shtohen të gjitha pjesët e ofruara për
21 prova gjyqësore tek prova ekzistuese P00189.

22 Mbrojtja nuk iu përgjigj emailit të ZPS-së së dërguar më
23 datë 30 tetor 2024.

24 Trupi Gjykses e udhëzon Zyrën Administrative që të shtojë
25 faqet U015-8743, U015-8878, U015-8880 dhe U015-8879 nga prova

1 P00765 dhe përkthimet përkuese si edhe faqet U015-8828 deri në
2 U015-8841 nga prova P01277 dhe përkthimet përkatëse në provën
3 P00189, me versionin në anglisht që ka numrin P00189-ET. Trupi
4 Gjykues po ashtu udhëzon Zyrën Administrative që të
5 përditësojë fushën e komenteve të provës P00765, P01277 dhe
6 P00189 dhe përkthimet përkuese në sistemin Legal Workflow për
7 të pasqyruar faktin që faqet përkatëse që unë sapo përmenda
8 janë shtuar në provën P000189. Më tej Trupi Gjykues i udhëzon
9 palët dhe pjesëmarrësit që: Një, të përpiqen që të kufizohen
10 nga referimi i faqeve përkatëse të provës P00765 dhe provës
11 P01277 në lidhje me pjesët e pranuar të librit të z. Krasniqi
12 dhe; dy, të kërkojnë shtimin në provën P00189 të pjesëve të të
13 njëjtit libër që do të kërkoj që të shtohet në prova materiale
14 në të ardhmen.

15 Ky përfundon urdhrin e gjashtë gojor.

16 Së fundi, Trupi Gjykues vëren se në një email të dërguar
17 në datë 3 dhjetor 2024 për Trupi Gjykues dhe palët dhe
18 pjesëmarrësit Mbrojtja e Veselit ka komunikuar se ajo pajtohet
19 me propozimin e Mbrojtësit të Viktimave të datës 2 tetor 2024
20 sa i takon kronologjisë së paraqitjes së provave nga Mbrojtja
21 e Viktimave dhe kërkesa për zhdëmtim.

22 Trupi Gjykues rikujton se në pajtim me urdhrin e Trupit
23 Gjykues më datë 2 tetor 2024, kundërshtimet e lidhura me
24 propozimet e Mbrojtësit të Viktimave duhej që të ishin
25 dorëzuar deri më 2 dhjetor 2024.

1 Duke menduar që ZPS-ja dhe Ekipet e Mbrojtjes për z.
2 Thaçi, z. Selimi dhe z. Krasniqi nuk kanë dhënë ndonjë
3 kundërshtim me shkrim, Trupi Gjykses dëshiron që të konfirmojë
4 në procesverbal që palët dhe pjesëmarrësit pajtohen që
5 dëshmitarët e viktimave do të thërriten pasi të përfundojë
6 paraqitja e dëshmitarëve të ZPS-së dhe pasi të jenë bërë
7 parashtrimet, argumentet dhe pasi të jetë marrë një vendim sa
8 i takon rregullës 130 dhe përpara sesa të fillojë Mbrojtja me
9 dëshmitarët e vetë.

10 Trupi Gjykses gjithashtu dëshiron që të konfirmojë për
11 procesverbal për palët dhe pjesëmarrësit që të gjitha, pra,
12 palët pjesëmarrëse dhe Trupi Gjykses pajtohen që kërkesat për
13 sa i takon zhdëmtimeve duhet të depozitohen pasi të merret
14 vendimi për çështjen dhe pasi të jetë marrë një vendim sa i
15 takon pikave të aktakuzës.

16 A pajtohen të gjithë me këtë? Z. Prokuror?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e
19 Thaçit?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e
22 Veselit?

23 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po.

25 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] po.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
2 të gjithëve.

3 Pasi ka dëgjuar të gjitha palët dhe pjesëmarrësit, Trupi
4 Gjykes urdhëron sa më poshtë: Dëshmitarët e Mbrojtësit të
5 Viktimave do të thërriten pasi të përfundojnë dëshmitarët e
6 ZPS-së edhe pasi të jenë nxjerrë parashtrimet, argumentet dhe
7 vendimi që kanë të bëjnë me parashikimet e rregullës 130 dhe
8 përpara sesa të fillojnë dëshmitarët e Mbrojtjes. Çdo kërkesë
9 për zhdëmtime duhet që të dorëzohet pasi të bëhet vendimi për
10 të gjitha pikat e aktakuzës.

11 Keni ndonjë gjë për të kundërshtuar, z. Laws?

12 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo përfundon
14 urdhrin e shtatë gojor.

15 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua thjesht
17 të bëj një sqarim për procesverbal që ka të bëjë me urdhrin
18 gojor pesë. Është kjo faqja që ka të bëjë me intervistën e
19 Sylejman Selimit që është pranuar, megjithatë kjo nuk është
20 pasqyruar në transkript. Thjesht dua ta bëj të qartë për të
21 gjithë, është në faqen 6.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

23 Z. HALLING: [Përkthim] Faqja konkrete që u tregua për
24 dëshmitarin është 6D000795, mesa e kuptuam nga vendimi juaj
25 është pranuar përmes vendimeve gojore dhe duhet të shtohet në

1 provën P1745.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, dokumenti
3 6D00079 i provës P01884 që ka numër MFI, pra, P01884.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Po numri i fundit është 5.
5 Është 0785 dhe jo 84.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë kam 4.
7 Kam P01884. Po më vjen keq. Keni të drejtë. Në fakt, duhet të
8 kisha thënë ndryshe dhe faqja që mbetet është ajo P01745.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që të më
10 sqaroni diçka lidhur me urdhrin e parë. Mbase do ishte mirë që
11 të kalojmë në seancë private në mënyrë që ta shtjellojmë, po
12 do i bie shumë shkurt. E kam fjalën për urdhrin -- një çast.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
2 Dëshmitar.

3 Mirëmëngjes, avokat.

4 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj
6 ndjesë për vonesën. Por dua t'ju siguroj, që të gjithë këtu
7 ishim në orën 9.00, por na duhej që të trajtonim disa çështje
8 tjera dhe prandaj u vonuam.

9 Dëshmitar, përpara sesa të fillojmë dua t'ju rikujtoj se
10 duhet që t'i përgjigjeni pyetjeve qartë, me fjali të shkurtra.
11 Në qoftë se nuk e kuptoni një pyetje, lirisht mund t'i kërkon
12 avokatit që t'ua përsërisë pyetjen ose mund t'i thoni që nuk e
13 kuptoni pyetjen dhe avokati përkatës do jua sqarojë pyetjen.
14 Po ashtu ju lutem thoni se cila është baza e njohurive,
15 fakteve dhe rrethanave për të cilat do të pyeteni.

16 Po ashtu, ju lutem, flisni pranë mikrofonit, bëni një
17 pauzë prej pesë sekondash përpara se t'i përgjigjeni një
18 pyetjeje dhe më pas flisni me ritëm të ngadaltë për hir të
19 përkthyesve.

20 Nëse e shikoni të nevojshme që duhet të bëni një pushim,
21 na e thoni këtë gjë dhe ne do bëjmë organizimet përkatëse.

22 Ju rikujtojmë që jeni nën detyrimin për të thënë të
23 vërtetën siç e keni deklaruar në betimin solemn. Ju kujtoj
24 gjithashtu që garancitë e dhëna nga Trupi Gjykes përpara një
25 jave, janë ende të zbatueshme për ju dhe refuzimi i

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 19

1 përgjigjeve mund të sanksionohet me një gjobë.

2 DËSHMITARI: SOKOL BASHOTA [Vijon]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të
4 vazhdojmë me disa pyetje nga Prokuroria.

5 Z. Halling, e keni ju fjalën.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

7 Pyetje vijuese nga z. Halling: [Vazhdim]

8 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Kam edhe disa tema, pak tema të
9 tjera që dua të diskutoj me juve sot paradite. Tema e parë ka
10 të bëjë me dëshminë që keni dhënë lidhur me lirimimin e z. Desku
11 dhe z. Kastrati si dhe të dy gazetarëve serbë.

12 Ju u pyetët lidhur me këtë nga Mbrojtja e Thaçit dhe në
13 pyetjet e Mbrojtjes së Thaçit, u përfshi gjithashtu edhe një
14 paragraf i Shënimeve të hetuesve të Ekipit të Thaçit që mban
15 datën, që është bërë në vitin 2022.

16 Tani le të shkojmë dhe të kthehemi prapë tek data e
17 lirimimit të këtyre personave. A jeni takuar me William Walker
18 për herë të parë ditën kur është liruar Desku dhe Kastrati?

19 PË. Për herë të parë me Walker? Nuk më kujtohet nëse ka qenë
20 hera e parë. Kam përshtypjen se jam taku më -- kam përshtypjen
21 se jam taku edhe më herët. Mund të jetë hera e parë. Nuk e di.

22 PY. Mesa kuptoj unë, William Walker dhe Shaun Byrnes kanë
23 qenë të dy të pranishëm gjatë lirimimit, saktë?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. Ka pasur ndonjë person tjetër nga ana e UÇK-së që ka

1 folur atë ditë me Walker dhe Byrnes përveç jush?

2 PË. Në prezencën time dhe para mediave, jo, s'e besoj.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni një
4 çast.

5 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
6 këshillohen]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kërkoj
8 ndjesë. Vazhdoni.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

10 I lutem Sekretarisë së seancës të vendosë në ekran
11 materialin që mban numrin 123941 deri në 123949 dhe më
12 konkretisht faqen 123947

13 PY. Dëshmitar, ky do të jetë një material në anglisht, ky që
14 do të shohim në ekran, por është një intervistë që është bërë
15 me William Walker në fillim të viteve 2000, dua t'ju bëj disa
16 pyetje lidhur me gjërat që ka thënë ai në këtë intervistë.

17 Ai thotë se ka folur me një udhëheqës lokal të UÇK-së që
18 ia ka prezantuar Shaun Byrnes. Dhe në krye të faqes ai thotë:

19 "... u thashë që do të ishte shumë mirë sikur të m'i
20 dorëzonin mua këta persona, ndonëse kishin thënë që do ta
21 bënë. Tha që sidoqoftë duhet të shkoja të flisja me disa
22 persona të tjerë. Shkova -- shkoi ky personi, foli me telefon,
23 u kthye dhe tha mirë do t'i dorëzojmë dhe do të vijmë për disa
24 minuta."

25 Dëshmitar, unë kam këtë pyetje për ju: Ditën e lirimit ju

1 a keni kryer një bisedë me William Walker??

2 PË. Me Walker nuk më kujtohet që kam pas naj diskutim para se
3 me shku në takim. Shaun më ka thirr për çështjen dhe prezencën
4 e gazetarëve serbë me marrë pjesë për me xhiru momentin e
5 dorëzimit të gazetarëve tjerë.

6 PY. Keni ndonjë arsye për ta kontestuar këtë që thotë Walker
7 që sipas tij ai ka pasur një bisedë me ju atë ditë?

8 PË. Me mu personalisht? Nuk e di. Nuk e di. Po ditën e
9 ngjarjeve në qoftë se është, më ka thirr vetëm për procedurën
10 edhe vendin se më duket s'e kam të qartë këtë. Nuk më kujtohet
11 saktë. Vetëm nëse është thirr për çështje teknike të asaj
12 ceremonie, për ndryshe nuk kemi pas diçka saktë për të.

13 PY. Më poshtë në faqe, Walker flet për dy gazetarët serbë,
14 për faktin që u liruan, pra, këta dy gazetarë dhe thotë:

15 "Kur shkova për t'i marrë vura re që në pjesën mbrapa të
16 automjetit ishin ulur dy persona me duar dhe sytë e lidhur."

17 Dëshmitar, a ju kujtohet nëse z. Desku dhe z. Kastrati i
18 kanë pasur sytë dhe duar e lidhura përpara lirimit të tyre?

19 PË. Jo, unë ata nuk i kam pa në veturë. Unë kam qenë tek
20 pjesa e gazetarëve në kohën kur ka ardh vetura me ta.

21 PY. Keni ndonjë arsye për ta kontestuar përshkrimin e z.
22 Walker lidhur me atë që thotë ai se ka parë atë ditë?

23 PË. Jo, nuk mund ta kontestoj. Me siguri se ai ka pasqyru atë
24 që ka pa. Por nuk -- me mu s'e besoj që me mu s'e ka bisedu
25 këtë.

1 PY. Më pas Walker thotë si në vijim:

2 "Po vrisja mendjen kush ishin, por kur pashë udhëheqësin
3 e UÇK-së pas një minute, unë e pyeta, 'Po ata dy të tjerët?
4 Ata kush janë?'. Ai m'u përgjigj, 'Mos u shqetëso për ata. Ata
5 janë tradhtarë shqiptarë të cilët kanë dhënë informata për ne
6 dhe ata i kemi gjykuar dhe i kemi shpallur fajtorë. Mos u
7 shqetësoni, do t'i çojmë në fshatrat e tyre dhe do t'i lirojmë
8 edhe ata, po ata nuk do të sillen më keq, siç u sollën më
9 përpara'."

10 Dëshmitar, në 2022-n ju i keni thënë Mbrojtjes së Thaçit
11 dhe e konfirmuat dhe dje, se z. Walker dhe z. Byrnes nuk lanë
12 gurë pa lëvizur për të zbuluar çfarë i kishte ndodhur Deskut
13 dhe Kastratit. Tani në këto përpjekje që kanë bërë z. Walker
14 dhe z. Byrnes a ju pyetën, ndër përpjekjet e tyre, a ju pyetën
15 dhe ju kush janë këta persona, siç thuhet në pjesën që unë
16 sapo ju lexova nga intervista e tij?

17 PË. Jo, me mu jo.

18 PY. Keni ndonjë arsye për ta vënë në dyshim përshtkrimin e z.
19 Walker sa i takon asaj që është thënë për z. Desku dhe
20 Kastrati ditën e lirimit të tyre?

21 PË. Për këtë që ka thënë s'po muj me qit në dyshim fjalën e
22 z. Walker, por muj me konstatu atë se personalisht me mua këtu
23 këtë bisedë nuk e ka pas. Në atë ceremoni të ndërrimit, të
24 dorëzimit të dy gazetarëve dhe të Cen Deskun me Jakup
25 Kastratin, ka pas dhjetëra ushtarë të cilët kanë qenë prezent

1 në atë takim.

2 PY. Dëshmitar, z. Walker thotë që ka folur me drejtuesin e
3 UÇK-së këtu. Atëherë në qoftë se nuk keni qenë ju ky drejtuesi
4 i UÇK-së, kush paska qenë?

5 PË. Unë nuk muj me paragjyku nëse me kën ka fol ai, por
6 realisht po të them me mu këtë bisedë Walker nuk e ka bë.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të hiqet dokumenti nga
8 ekрани. Ju lutem tani vendosni në ekran materialin
9 SPOE00357143 deri në SPOE00137154-ET faqja SPOE00357147. Mund
10 ta vendosni në të gjithë ekranin. Versioni origjinal në fakt
11 është gjermanisht, kështu që do të thotë ne nuk na shërben,
12 nuk besoj se i shërben dëshmitarit.

13 PY. Ndërkohë që presim dokumentin të dalë në ekran,
14 Dëshmitar, ju bëri disa pyetje Mbrojtja e Thaçit lidhur me
15 dëshminë që dhatë ju për kolaboracionistët dhe u mbështetë në
16 shënimin e hetuesit të 2022.

17 Në ekran tani është një artikull i Sabri Kiçmarit i 1999-
18 s, marsit të 1999-s. Fillimisht do t'ju bëj këtë pyetje bazë:
19 A e njihni Sabri Kiçmarin?

20 PË. Sabri Kiçmarin e njoh. Domethënë, e kam taku mbas luftës.
21 Ka qenë pjesë e partisë të cilës i kam takuar edhe unë.

22 PY. Çfarë roli ka pasur Sabri Kiçmari në LPK, në qoftë se e
23 dini?

24 PË. Nuk e di.

25 PY. Në rregull.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Ai në fakt përmendet në dokumentin
2 historik që është pranuar tashmë si provë gjyqësore P1874.

3 PY. Kiçmari këtu flet për UÇK-në në këtë pjesë të intervistës
4 së tij dhe unë do ju lexoj pjesën përkatëse. Ai thotë:

5 "Duke marrë parasysh përpjekjet për infiltrim që kishte
6 kryer shërbimi informativ serb, UÇK-ja nuk duhet të luftonte
7 vetëm kundër policisë serbe dhe ushtrisë, por duhet të
8 luftonte edhe kundër shqiptarëve që bashkëpunonin me serbët.
9 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së fillimisht hetoi veprimtaritë e
10 këtyre bashkëpunëtorëve dhe më pas si doli në -- pasi doli në
11 përfundimin se ishin fajtorë, dha urdhër që të kryheshin sulme
12 kundër tyre."

13 I bëhet pyetje intervistuesit:

14 "Në 1996-n, kjo solli vrasjen e më shumë se 20 personave
15 ..."

16 Kiçmari përgjigjet:

17 "Po, por për çdo rast ndiqej një proces. Vendimi kryhej,
18 ekzekutohej më saktë vetëm pasi të merrte vendim Shtabi i
19 Përgjithshëm."

20 Dëshmitar, Kiçmari këtu përshkruan qasjen që ka pasur
21 UÇK-ja ndaj bashkëpunëtorëve dhe ka thënë këtu që procedura
22 ndiqej nga Shtabi i Përgjithshëm, pra, ishte një procedurë që
23 e kryente Shtabi i Përgjithshëm dhe kjo solli vrasjen e më
24 shumë se 20 personave në 1996.

25 Pra, ju gjatë seancës përgatitore a thatë që vërtetë ka

1 ekzistuar kjo procedura, ky procesi që përshkruan Kiçmari por
2 që këta kolaboracionistët që shënjestroheshin në fakt ishin
3 luftëtarët? A keni thënë këtë gjatë seancës përgatitore?

4 PË. Unë po i referohem ma së pari z. Kiçmari që ai në luftë,
5 gjatë luftës në Kosovë s'ka qenë asnjëherë dhe nuk e di sa i
6 ka mujt me fol për këto çështje për kohën e luftës. Nëse ato
7 që i kam thënë në seancat përgatitore unë i qëndroj asaj.

8 PY. Po. Që të jemi të qartë, unë nuk po ju flas tani ju këtu
9 për besueshmërinë e z. Kiçmari. Por për procedurën që
10 përshkruan ai. Dhe në fakt dhe ju gjatë seancës përgatitore
11 keni thënë që ekzistonte një procedurë, por kolaboracionistët
12 që shënjestroheshin ishin luftëtarë?

13 PË. Pikërisht ata të cilët kanë qenë si polici lokale e
14 uniformuar nga ushtria dhe policia serbe dhe armatosur. Dhe
15 pikërisht dhe për këta e kam thënë dhe në seancën përgatitore,
16 gjithmonë fjala ka qenë kur ata kanë qenë në vazhden e punëve
17 tyre, domethënë, kur ata realisht ia kanë kthy pushkën
18 luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këtë
19 kontekst e kam pas gjithmonë dhe gjithnjë fjalën për këto
20 kategori.

21 PY. Faleminderit. Në këtë sallë gjyqi ju keni thënë në
22 paragrafët 39 dhe 43, pra - më falni - keni thënë se
23 paragrafët 39 dhe 43 të deklaratës së nënshkruar të TPNJ-së
24 ishin kryesisht çështje hipotetike dhe keni thënë diçka të
25 ngjashme në shënimet hetuese të 2022 që ua lexoj Mbrojtja e

1 Thaçit.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal bëhet fjalë për
3 materialin me numër 23100, 23101.

4 PY. Do t'ju lexoj disa pjesë nga paragrafët përkatës të
5 deklaratës suaj. Po filloj me paragrafin 39. Ju keni thënë:

6 "Kur dikush identifikohet si bashkëpunëtor me serbët në
7 zonën operative, merreshin masa ndëshkimore kundër tyre brenda
8 zonës. Në rastet kur kapeshin në flagrancë në kohën që po
9 kryenin veprimtarinë, personi në fjalë do të vritej. Shtabi i
10 Përgjithshëm njoftohet lidhur me masat konkrete ndëshkimore që
11 merreshin ndaj personit."

12 Kjo që keni thënë këtu ju ka qenë thjesht një situatë
13 hipotetike?

14 PË. Po, për arsye se --

15 PY. Hipotetike - më falni.

16 PË. Po, për arsye se s'kemi pas një informacion që ka ndodh
17 dikun nga komandantët e zonave apo nga vetë zona për një rast
18 të tillë.

19 PY. Në paragrafin 43 keni thënë:

20 "Sa i përket bashkëpunëtorëve me serbët, komandantët e
21 zonave operative vepronin në bazë të raportimeve që jua jepnin
22 ushtarët që kishin nën komandën e tyre. Pasi paralajmërohej
23 personi në fjalë dhe Shtabi i Përgjithshëm bindej se ishte
24 bashkëpunëtor i serbëve, ky bashkëpunëtor mund të vritej nga
25 struktura komanduese e UÇK-së nëse vijonte me veprimtaritë e

1 veta.”

2 Edhe kjo që keni thënë ju këtu ishte hipotetike?

3 PË. Po, se nuk kemi pas një ngjarje të pasqyruar kuartë
4 kështu që ka ndodhë në atë kohë. Por thjesht është ka
5 hipotetike dhe përgjigja. Domethënë, pyetja ka qenë hipotetike
6 dhe përgjigje ka qenë e tillë.

7 PY. Dëshmitar, këto paragrafë të janë lexuar fjalë për fjalë
8 në fund të intervistës së 2006 nga TPNJ-ja. Pse nuk keni thënë
9 ju në ato momente që këto ishin thjesht hamendësime apo
10 thjesht situata hipotetike, para se ta nënshkruanit
11 deklaratën?

12 PË. Po ajo, ne e kemi përsërit edhe gjatë seancave
13 përgatitore, ju e dini se në atë presionin që e kam pas dhe
14 numrin e madh të dokumenteve të cilat i kemi shfletuar atë
15 ditë gjatë tërë ditës dhe duke mos i njoft mirë natyrën e
16 procedurave të drejtësisë. Realisht, duke mos pas edhe një
17 avokat prezent, nuk kam mujt me i dhënë një fokus të kuartë
18 kësaj çështje në atë kohë dhe në atë gjendje.

19 PY. Po. Dëshmitar, ju gjatë seancës përgatitore thatë që
20 TPNJ-së i keni treguar të vërtetën edhe të gjitha korrigjimet
21 që bëtë gjatë seancës përgatitore i bëtë vullnetarisht dhe
22 gjithçka është zbardhur apo incizuar. Dhe ju thatë që nuk
23 kishit asnjë korrigjim për deklaratat përmbledhëse, përveç
24 atyre që i bëtë transkriptove të TPNJ-së. Pse nuk thatë ju kur
25 patët mundësinë që këto paragrafë ishin thjesht hipotetike?

1 PË. Thjesht nuk i kam kushtu ndonjë rëndësi. Se ndoshta ka
2 shumë çka tjetër që u dashtë me e bë, po thjesht nuk kam mujt
3 me qit fokusin pikërisht tek kjo

4 PY. Kur filluat dëshminë këtu në këtë sallë gjyqi, pse nuk
5 thatë që deklarata - më falni - pse thatë ju që deklarata e
6 TPNJ-së pasqyronte pikërisht atë që do të thonit përsëri në
7 këtë sallë gjyqi kur këto paragrafë paskan qenë thjesht
8 situata hipotetike?

9 PË. Thashë nuk i njoh natyrën edhe terminologjitë as shumë,
10 shumë këtu juridike dhe në ça momente duhet të përdoren këto,
11 po realisht, thjesht ju kam përgjigj saktë se ka pas situata
12 hipotetike gjatë kësaj deklarate që i kam dhënë për tribunalin
13 atëherë.

14 PY. Pse nuk thatë gjatë pesë orëve që ju bëra unë pyetje dhe
15 ju bëra dhe shumë pyetje për dëshminë që keni dhënë për TPNJ-
16 në për bashkëpunëtorët në kohën që unë ju bëra pyetje, pse nuk
17 thatë që situatat janë thjesht hipotetike?

18 PË. Por nuk kanë qenë të gjitha situatat hipotetike në atë
19 deklaratë. Po pjesë të asaj të pyetjeve dhe të përgjigjeve
20 kanë qenë hipotetike. Po nuk ma parashtruat atë pyetje nëse
21 kanë qenë apo jo gjatë atyre pesë orëve, prandaj edhe unë ka
22 mundësi që nuk më ka shku ndër mend që duhet, që muj me thënë
23 atë.

24 PY. Pse nuk ia keni përmendur Prokurorisë këtu se keni folur
25 me Mbrojtjen e Thaçit për aspekte që mbulohen në dëshminë

1 tuaj?

2 PË. S'më ka pyet kërrkush për këtë çështje.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem atëherë të përdorim

4 Shënimin Përgatitor 2, paragrafi 63.

5 PY. Dëshmitar, në shënimin përgatitor ju keni thënë që nuk e

6 keni diskutuar dëshminë tuaj me askënd përveç familjarëve të

7 ngushtë dhe askush nuk ju ka pyetur për dëshminë tuaj, kështu

8 keni thënë?

9 PË. Po.

10 PY. A është kjo e vërtetë?

11 PË. Po.

12 PY. Ajo që i keni Mbrojtjes së Thaçit në 2022 për situatën

13 për bashkëpunëtorët që ishte thjesht hipotetike, a mos ishte

14 kjo diçka që z. Thaçi donte që ju t'ia thonit ekipit të tij të

15 Mbrojtjes?

16 PË. I nderuar, unë ekipin e Mbrojtjes së z. Thaçi e kuptoj si

17 pjesë përbërëse e kësaj Gjykate. Dhe nuk më ka -- nuk kam

18 mendu se duhet me e tregu se vërtetë kam diskutu dhe me ta.

19 Unë ja kam bërë një pyetje mbrojtësve të z. Thaçi nëse, kur më

20 kanë ftu, nëse kjo është brenda kuadrit ligjor të kësaj

21 Gjykate dhe nëse "unë mundem me ju përgjigj juve ma thoni ju

22 si avokatë dhe si profesionalistë". Ata më kanë dhënë garancat

23 se, "po, mundesh me fol për ato çka realisht ti din dhe për

24 neve është gjithçka okej". Nuk kam biseduar me askënd për këtë

25 çështje për të z. Thaçi, por thjesht drejtpërdrejt intervista

1 është bë në një lokal ku ata, në një zyrë ku ata e kanë pas
2 dhe e kam kry aty.

3 PY. Dëshmitar, e kuptojmë atë që po thoni dhe unë nuk po
4 përpiqem të them që ka gabuar Mbrojtja e Thaçit, por sidoqoftë
5 nuk i dhatë përgjigje pyetjes sime.

6 Ajo që i keni thënë Mbrojtjes së Thaçit në 2022 lidhur me
7 bashkëpunëtorët, pra, që situatat e bashkëpunëtorëve ishin
8 thjesht situata hipotetike, a ishte kjo diçka që ju e keni
9 thënë sepse donte z. Thaçi që t'ia thoshit ekipit të tij të
10 Mbrojtjes?

11 PË. Jo, nuk është e vërtetë kjo.

12 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkoj të
13 kalojmë në seancë private.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për mbrojtjen
15 e çfarë?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Për mbrojtjen e dokumentit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
18 seancë private.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje vijuese nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 32

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thashë që do

16 t'ju jepja mundësi që të përgjigjeshit nëse kishit nevojë. Po
17 vetëm lidhur me këtë material do t'jua jap mundësinë.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] As unë s'dua të rri shumë gjatë në
19 këmbë, por erdhi ora 10.00 që mund të bëjmë pushimin edhe mua
20 vërtetë do më nevojiteshin dhjetë minuta kohë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

22 Dëshmitar, do të bëjmë dhjetë minuta pushim dhe do të
23 keni disa pyetje të tjera. Mos flisni me askënd për dëshminë
24 ju lutem.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë
2 minuta pushim.

3 --- Seanca ndërpritet në orën 09.59

4 --- Seanca rifillon në orën 10.09

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Asistente, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

7 Dëshiron që të vazhdojmë në seancë private z. Misetic?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo. Do fillojmë një herë pyetjet
9 me Walker pastaj do vazhdojmë më tej.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,

13 Dëshmitar. Tani z. Misetic do vazhdojë me disa pyetje të tjera
14 për ju.

15 Z. Misetic: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

16 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic:

17 Z. MISETIC: [Përkthim]

18 PY. Mirëmengjes dhe një herë, Dëshmitar. Do t'ju bëj disa
19 pyetje plotësuese që rrjedhin nga pyetjet e Prokurorit. Së
20 pari pyetja ka të bëjë me intervistën e William Walker.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares për këtë
22 arsye që të paraqesë në ekran dokumentin 123941-123949 në
23 faqen 123947. Mendoj që është paragrafi i parafundit, dy
24 paragrafë përpara fundit.

25 PY. Në mes të paragrafit që keni këtu përpara këtu në ekran,

1 do ju lexoj diçka që ju treguam. Atëherë, së pari, do shikojmë
2 se çfarë ka thënë z. Walker në këtë intervistë. Walker ka
3 thënë që:

4 "Kur shkova për t'i marrë ata", dhe këtu e ka fjalën për
5 dy personat e ndaluar, "unë pashë që në pjesën e pasme të
6 automjetit kishte dhe dy persona të tjerë që ishin ulur atje
7 me sy të mbyllur dhe i kishin gjithashtu edhe duart e
8 mbyllura. Po vrisja mendjen lidhur me këtyre [Sipas
9 përkthimit] dhe pastaj pashë një udhëheqës të UÇK-së një
10 minutë më pas dhe thashë 'Po këta dy personat e tjerë? Kush
11 janë këta dy persona?'. Dhe ai më tha, 'Mos u shqetëso lidhur
12 me ta ...'."

13 Atëherë, tani dua që të t'ju tregoj lidhur me çfarë ka
14 thënë z. Walker. Do shikojmë videon e ngjarjes që ka ndodhur
15 dhe pastaj do t'ju pyes në qoftë se ajo çfarë kujton z. Walker
16 përkon me atë çfarë do shikojmë në video.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë arsye do i kërkoja
18 Sekretares që të paraqesë në ekran dokumentin 061427, që ka
19 numrin e provës P93. Do ju lutesha që të fillojmë në 05:26.
20 PY. Pra, ju kujtohet që nga sa lexova z. Walker tha që të
21 gjithë këta persona ishin në të njëjtin automjet. Domethënë,
22 dy gazetarët serb plus z. Desku dhe z. Kastrati.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë sepse
24 është material i madh dhe kërkon pak kohë për t'u shfaqur.

25 Z. Misetiç: [Përkthim] Për aq kohë sa s'është faji ynë,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 36

1 nuk ka problem.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, transmetojeni nga 05:26
3 deri në 05:39 dhe pastaj ndaloni.

4 [Luhet videoincizimi]

5 Z. MISETIC: [Përkthim]

6 PY. Dëshmitar, a është kjo në përputhje me atë çfarë ju
7 kujtohet ju, në qoftë se do mendoni atë çfarë është thënë më
8 përpara, që dy gazetarët serbë ishin të ulur në pjesën e pasme
9 të automjetit? A përkon kjo me çfarë ju kujtohet juve?

10 PË. Unë nuk i kam pa unë as në çfarë veture kanë qenë, as në
11 ku kanë qenë ulur.

12 PY. A keni qenë ju në vendin e ngjarjes në kohën kur janë
13 liruar ata?

14 PË. Po.

15 PY. Kur kanë dalë nga automjeti, nga vetura keni qenë aty?

16 PË. Nuk e di po kam qenë në pjesën, një pjesë ma larg, ma
17 afër prej skenës ku kanë qenë gazetarët.

18 PY. Jo gazetarët serbë ë. E keni fjalën për gazetarët që po
19 raportnin për ngjarjen, për këtë e keni?

20 PË. Po, po, ka qenë një numër i madh i gazetarëve. Dhe kam
21 qenë në pjesën e majtë prej pjesës a kon [E pakuptueshme].

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Vazhdojmë më tej të transmetohen
23 disa sekonda më tej. Domethënë nga 05.39 deri në 05:49.

24 PY. Na thoni ju lutem në qoftë se do shikoni z. Walker ose z.
25 Byrnes.

- 1 [Luhet videoincizimi]
- 2 Z. MISETIC: [Përkthim] Vazhdojmë e transmetojmë më tej
- 3 deri në 06:20. Përfundojmë këtu për një çast.
- 4 PY. A e shikoni William Walker këtu, Dëshmitar?
- 5 PË. Jo.
- 6 Z. MISETIC: [Përkthim] Vazhdojmë më tej me videon.
- 7 [Luhet videoincizimi]
- 8 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndaloni këtu, Sekretare.
- 9 PY. Po tani e shikoni William Walker?
- 10 PË. Po.
- 11 PY. Po veten tuaj e shikoni këtu?
- 12 PË. Jo.
- 13 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Vazhdojmë më tej.
- 14 [Luhet videoincizimi]
- 15 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndaloni këtu dhe një herë.
- 16 PY. Deri tani a shikoni, a i shikoni z. Desku dhe z.
- 17 Kastrati, z. Dëshmitar?
- 18 PË. Jo.
- 19 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Mund të vazhdoni më
- 20 tej, Sekretare.
- 21 [Luhet videoincizimi]
- 22 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndalojmë këtu dhe shkojmë tek
- 23 12:03.
- 24 [Luhet videoincizimi]
- 25 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndaloni këtu, ju lutem.

1 PY. Së pari, a e shihni z. Desku dhe z. Kastrati këtu?

2 PË. Po.

3 PY. A e njihni personin që është me flokë të thinjura këtu në
4 ekran?

5 PË. Po.

6 PY. Kush është ky person?

7 PË. Shaun Byrnes.

8 PY. A e keni parë në qoftë se z. Desku dhe z. Kastrati kanë
9 mbërritur me të njëjtën veturë si gazetarët serbë apo me
10 veturë tjetër?

11 PË. Nuk e di, nuk e di. S'i kam kushtu vëmendje.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë do të transmetojmë disa
13 sekonda të tjera dhe të shohim në qoftë se do shikoni z.
14 Walker në video.

15 [Luhet videoincizimi]

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndaloni këtu, ju lutem.

17 PY. A e shihni veten në ndonjë vend këtu? A e keni parë veten
18 deri tani?

19 PË. Jo.

20 PY. Faleminderit. Dëshmitar, a pajtoheni me mua se ajo çfarë
21 thotë z. Walker këtu, të paktën në këto pjesët që u
22 transmetuan është e pasaktë në kuptimin që ka parë z. Desku
23 dhe Kastrati në një makinë dhe që ju ka pyetur juve lidhur me
24 ta? A pajtoheni që ky është informacion i pasaktë, Dëshmitar?

25 PË. Unë nuk e pashë në atë paraqitjen e mëherët që e

1 prezantoi dhe Prokurori këtu se Walker ka folur mua.
2 Domethënë, nuk e ka përmend emrin tim. Andaj as po muj me --
3 nuk muj me paragjy tash nëse vërtetë ka fol me dikën tjetër,
4 por me mu personalisht Walker nuk ka fol në këtë rast. Për atë
5 jam shumë i bindur. Dhe nëse ai ka thënë kanë qenë në të
6 njëjtën veturë, prapë s'muj ta -- s'i kushtova vëmendjen nëse
7 vërtetë ishte vetura e njëjta apo jo. Por nëse s'ka qenë e
8 njëjta, domethënë tregon se ka qenë i pasaktë.
9 PY. Në rregull. Ndoshta duhet të flasim me z. Walker lidhur
10 me këtë, apo jo? pajtoheni me mua?

11 PË. Patjetër.

12 PY. Në rregull. Tani të kalojmë tek tema e përgjigjeve
13 hipotetike. Pyetjeve hipotetike.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja për këtë Sekretares
15 të paraqesë në ekran dokumentin P1870.3 në faqen 18 në
16 anglisht dhe në faqen 18 dhe në shqip. Duke filluar nga
17 rreshti 3 në anglisht dhe rreshtin 2 në shqip.

18 PY. Do t'ju lexoj pyetjen. Më dëgjoni, Dëshmitar. Pra, është
19 pyetje dhe përgjigje. Përsëri dua që t'ja u lexoj dhe do ju
20 bëj një pyetje sa i takon pyetjeve dhe përgjigjeve hipotetike.
21 Pyetja që ju bëhet ju është kjo:

22 "A po thoni ..."

23 Atëherë dhe një herë t'ja u sqaroj, Dëshmitar. Ky -- kjo
24 është ajo çfarë i keni thënë TPNJ-së në 2006-n. Është
25 deklarata juaj për TPNJ-në në 2006-n. Pyetja që ju bëhet është

1 kjo:

2 "A po thoni se nëse komandanti i zonës pasi bënte hetimet
3 e veta në terren me ndihmën e ushtarëve të vet në terren, nëse
4 kishte përcaktuar se dikush sipas mendimit të tij ishte
5 bashkëpunëtor me serbët, a mundej ai dhe ky person nuk kishte
6 dhënë informacion, ai do ta mohonte këtë fakt, por komandanti
7 i zonës kishte bërë hetimet e tij dhe ishte krejtësisht i
8 qartë në vetvete se ky person bashkëpunon me serbët? A mund ta
9 merrte ai vendimin vetë për ta vrarë këtë person?"

10 Përgjigja që keni dhënë është kjo:

11 "Le të kemi parasysh një gjë. Mesa di unë, asnjë
12 bashkëpunëtorë për sa i përket mundësisë për të komunikuar
13 asnjë bashkëpunëtor nuk është vrarë për shkak të faktit se ai
14 ishte bashkëpunëtor."

15 A besoni ju që keni qenë i qartë për TPNJ-në se ju nuk
16 kishit asnjë informacion që askush nuk ishte vrarë për shkak
17 të faktit që kishte qenë bashkëpunëtor?

18 PË. Po.

19 PY. Në rregull. Pasi jepni këtë përgjigje --

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe tani le të kalojmë tek pyetja
21 tjetër, kalojmë pak më poshtë në faqe.

22 PY. Ju bëhet pyetja e radhës:

23 "Për t'iu kthyer përsëri pyetjes time të mëparshme, a do
24 të kishte pra, nëse kjo do të kishte ndodhur siç e shpjegova
25 unë më sipër, nëse do të kishte ndodhur në këtë mënyrë që e

1 shpjegova fillimisht ose më herët, a mund të merrnin ata
2 vendimin që ta vrisnin këtë person?"

3 Si e keni kuptuar ju këtë pyetje? Domethënë, pyetja po ju
4 bëhej lidhur me një fakt apo ishte pyetje hipotetike?

5 PË. Jo kjo taman është hipotetike, për arsye se është
6 paragjyku si pyetje "nëse". A do t'i kishte [E pakuptueshme].

7 PY. Në asnjë moment pasi ju jepni përgjigjet këtu, a kam të
8 drejtë unë që në asnjë moment hetuesit e TPNJ-së nuk ju kanë
9 bërë pyetje konkrete të tilla si për shembull, kush, çfarë,
10 pse? Domethënë nuk ju kanë bërë asnjë pyetje të tillë në
11 mënyrë të tillë që të identifikoheshin raste konkrete kur
12 dikush mbase mund të ishte vrarë për shkak të faktit që ishte
13 bashkëpunëtor. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

14 PË. Po, e saktë është.

15 PY. Në seancën përgatitore Prokurori nuk ju bëri asnjë pyetje
16 konkrete për të identifikuar askënd që ishte vrarë mbështetur
17 në dëshminë që kishit dhënë në 2006-n. A është e saktë kjo?

18 Pra, Prokurori nuk ju ka bërë asnjë lloj pyetje lidhur me këtë
19 temë që e keni cekur në 2006-n, kështu Dëshmitar?

20 PË. Kujtoj kështu është.

21 PY. Ai nuk ju ka kërkuar asnjëherë që ju të identifikoni një
22 viktimë, një person që ishte vrarë si bashkëpunëtor në pajtim
23 me politikat e bashkëpunëtorëve ose kundër bashkëpunëtorëve. A
24 është e saktë kjo, Dëshmitar?

25 PË. Tash kemi bisedu në një ditë të tërë, nuk më kujtohet që

1 më është [E pakuptueshme] diçka e tillë.

2 PY. Prokurori nuk ju ka kërkuar asnjëherë që të identifikoni
3 një person brenda Shtabit të Përgjithshëm që ka autorizuar ose
4 ka lejuar vrasjen e një bashkëpunëtori. A është e saktë kjo,
5 Dëshmitar?

6 PË. Po, kjo është e saktë.

7 PY. Ai nuk ju ka pyetur ju asnjëherë se kur ka ndodhur një
8 rast i tillë, po të kishte ndodhur?

9 PË. Po.

10 PY. Pra, tani që ju bën pyetje Prokurori që pse nuk keni bërë
11 shpjegimet ose korigjimet përkatëse, Prokurori në fakt nuk
12 është se ju ka kërkuar asnjë lloj hollësie në seancës
13 përgatitore në qoftë se vërtetë e besonte që kjo ishte një
14 dëshmi që i shkonte për shkak politike që pretendohet që të
15 jetë ndjekur nga Prokuroria. A është kështu, Dëshmitar?

16 PË. Po, ashtu është.

17 PY. Përpara pak minutash Prokurori ju tregoi paragrafin 41 të
18 deklaratës së TPNJ-së. Ja u lexoi Prokurori, do t'ja u lexoj
19 edhe unë përsëri. Në këtë paragraf thuhet si më poshtë:

20 "Sa i takon bashkëpunëtorëve serbë, komandantët e zonave
21 operative kanë vepruar mbi bazën e raporteve që atyre u
22 jepeshin nga ushtarët që ishin nën komandën e tyre. Pasi
23 personi paralajmërohej dhe Shtabi i Përgjithshëm ishte i
24 bindur që personi në fjalë ishte bashkëpunëtor serb,
25 bashkëpunëtori mund të vritej nga struktura komanduese e UÇK-

1 së në qoftë se personi do të vazhdonte me veprimtarinë e
2 veta.”

3 “Mund të vritej”, thoni ju. Pra, keni dashur të thoni që
4 “dikush është vrarë”, apo thjesht thoni që “mund të vritej”
5 dhe prapë këtë e keni në nivel hipotetik?

6 PË. Jo, kjo është në nivel hipotetik se nuk ka pas një rast
7 të tillë. As nuk kemi pas as edhe një raport se ka ndodh diçka
8 e tillë. Të paktën unë personalisht nuk e kam pas kurrë.

9 PY. Në rregull.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, do ju kërkoja të
11 kalojmë në seancë private.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
13 në seancë private.

14 [Seancë private]

15 [Seancë private teksti i fshirë]

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15 [Seancë e hapur]

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
17 jemi në seancë publike.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar.

19 Faleminderit, Kryegjykatës. Nuk kam pyetje të tjera.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
21 ekip tjetër që do të vazhdojë me pyetje plotësuese?

22 Z. DIXON: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës, kam pak
23 pyetje plotësuese për dëshmitarin.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 Z. DIXON: [Përkthim] Pyetjet mund të bëhen në seancë

1 publike.

2 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon:

3 Z. DIXON: [Përkthim]

4 PY. Z. Bashota, mirëmëngjes dhe një herë. Kam disa pyetje për
5 ju tani. Ju e dëgjuat sot paradite atë çfarë tha z. Halling
6 lidhur me ju, pra në fund të pyetjeve të veta. Mbase pozicioni
7 i tij nuk ishte shumë i qartë, por në thelb ajo çfarë tha z.
8 Halling, është që si dëshmitar i Prokurorisë ju jeni dëshmitar
9 i anshëm. Domethënë me fjalë të tjera që jeni dëshmitar i
10 pabesueshëm dhe në mënyrë që të jem i drejtë me ju, unë dua
11 t'ju jap mundësinë që t'i përgjigjeni këtij supozimi ose këtij
12 pretendimi që u bë lidhur me ju.

13 A keni ardhur këtu në Gjykatë, Dëshmitar, për të qenë
14 dëshmitar i anshëm dhe për të dhënë dëshmi në favor të ndonjë
15 prej të akuzuarve pavarësisht se si ka qenë e vërteta?

16 PË. I nderuar avokat, unë jam shumë i vetëdijshëm për
17 përgjegjësitë e mia edhe juridike dhe penale që kam këtu dhe
18 absolut nuk kam ardhur këtu për të mbrojt asnjë kauzë përsos
19 të vërtetës dhe të vërtetës konform betimit që e kam dhënë.

20 Le të më falin nëse mbamendja tek unë nuk është e atij
21 niveli që me e mbaj mend gjithçka për arsye se kurrë nuk jam
22 ardh për këtë pjesën e luftës mbas lufte. Realisht këtu vij me
23 thon për atë që e di, për atë që e kam pa, dhe për atë që e
24 mbaj mend.

25 PY. A është e drejtë, apo jo, domethënë kjo është pyetje për

1 ju për t'ju përgjigjur përpara Trupit Gjykses, Dëshmitar, a
2 mund të thuhet që ju keni thënë të vërtetën për të gjitha
3 pyetjet që ju janë bërë me aq sa dini dhe sa ju kujtohet? A
4 është e saktë kjo?

5 PË. Po. Po.

6 PY. Kam edhe një temë tjetër që lidhet me pyetjet që ju janë
7 bërë ju në seancën përgatitore nga z. Halling. A ju ka
8 sugjeruar ndonjëherë z. Halling në këto seanca apo a ju ka
9 thënë gjatë këtyre seancave që ju jeni dëshmitar i anshëm?

10 PË. Jo.

11 PY. Pra, asnjëherë nuk ju është sugjeruar në asnjë mënyrë që
12 ju po mundoheni që të mbuloni ndonjë nga të akuzuarit ose të
13 favorizonit ndonjë prej të akuzuarve?

14 PË. Jo, s'ma ka thanë.

15 PY. A ju ka treguar ai ndonjëherë ndonjë kopje të aktakuzës
16 në këtë lëndë gjyqësore me të gjitha akuzat dhe me të gjitha
17 rastet dhe a ju është shpjeguar ndonjëherë prej tij se çfarë
18 përmban aktakuza në vetvete?

19 PË. Jo.

20 PY. Pra ai nuk ju ka treguar asnjëherë rastet konkrete për të
21 cilët akuzohen të akuzuarit dhe nuk është se ju ka përmendur
22 ndonjë rast të të ashtuquajturve bashkëpunëtorë ose
23 kolaboracionistë dhe nuk është se dhe nuk është se ju ka
24 pyetur në qoftë se ju keni pas dijeni apo jo për ndonjë prej
25 këtyre rasteve, apo jo, Dëshmitar?

1 PË. Saktë.

2 PY. Faleminderit, z. Bashota.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
5 z. Dixon.

6 Ndonjë prej ekipeve të tjera? Jo, mesa shoh.

7 Gjykatësi Barthe ka disa pyetje tani.

8 Po përpara se të filloni, Gjykatësi Barthe, do veprojmë
9 njësoj si dje. Nëse keni diçka për të ngritur gjatë pyetjeve
10 të Gjykatësve për natyrën e pyetjeve të Gjykatësve na vini në
11 dijeni paraprakisht, në mënyrë që të largojmë dëshmitarin nga
12 salla dhe të vijojmë me parashtrimet përkatëse.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
14 Smith.

15 Pyetje nga Trupi Gjykses:

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëmëngjesi, z. Bashota.

17 PË. Mirëmëngjesi.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Trupi Gjykses ka disa pyetje
19 të mëtutjeshme për ju që besojmë se janë të nevojshme që ne të
20 kuptojmë sa më mirë dëshminë tuaj dhe të sqarojmë disa aspekte
21 që për ne kanë nevojë për më shumë sqarim.

22 Dhe unë do të doja të filloja me atë që keni thënë gjatë
23 seancës përgatitore me ZPS-në dhe që ju është zbardhur në
24 paragrafin 36 të Shënimit Përgatitor numër 2. 36 dhe 37. Pra
25 është Shënimi Përgatitor 2, paragrafi 36:

1 "Anëtarët e parë kryesorë të asaj që u bë më pas Shtabi
2 Qendror ishin: Azem Syla, Xheladin Gashi, Nait Hasani, Xhavit
3 Haliti, dhe Dëshmitari W044401", që jeni ju, z. Bashota.
4 "Fillimisht nuk kanë qenë një 'shtab' po një grup shokësh që u
5 takuan për të konsoliduar aktivitetet në terren. Shtabi
6 Qendror më pas doli me emër në një komunikatë - por në atë
7 kohë ka pasur vetëm grupe të vogla në Kosovë, dhe Dëshmitari
8 W04401 kur komunikata i referohej grupit si pjesë e 'ushtrisë'
9 çlirimtare."

10 Paragrafi 37:

11 "Pas arrestimit të Nait Hasanit dhe vrasjes së Zahir
12 Pajazitit, grupi u shpërbë dhe Xheladin Gashi shkoi në
13 Shqipëri. W04401 ishte në Shqipëri për dy muaj dhe më pas ka
14 qëndruar në Cerovik në 1997. Shtabi i Qendror ende lëshonte
15 komunikata në '97-n, por W04401 nuk ishte pjesë e tij. 04401
16 nuk e di kush i lëshonte këto komunikata, por përpara
17 arrestimit të Nait Hasanit dhe Xheladin Gashit komunikatat
18 shkruheshin prej tyre."

19 Z. Bashota, ju kujtohet që ja keni thënë këtë
20 Prokurorisë? Dhe mjafton një përgjigje me "po" ose "jo"?
21 PË. Po.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Javën e kaluar
23 Prokurori ju tregoi dy dokumente. Konkretisht komunikata 28
24 dhe 29.

25 I lutem Sekretarisë të vendosë në ekran provën materiale

1 P273 dhe në shqip dhe në anglisht. Faleminderit.

2 Z. Bashota, unë e di që ju thatë se nuk e keni parë më
3 përpara këtë komunikatë por sidoqoftë do ju lutesha të lexonit
4 fjalinë e parë ku thuhet:

5 "Më 26 dhjetor 1996 dhe më 9 janar 1997, në zonën
6 operative numër 1, njësitë tona të armatosura kryen dy
7 atentate kundër bashkëpunëtorëve të okupatorit serb në
8 Kosovë."

9 Pyetja ime e parë është kjo tani: Kush ka qenë zona
10 operative numër 1? Çfarë ka qenë dhe ku ka qenë kjo zonë?
11 PË. Unë, siç e thashë dhe ma herët, e kam potencu atë, ju
12 vetë z. Gjyqëtar, këtë komunikatë nuk e kam pa, dhe nuk është
13 lëshu nga -- se besoj që është lëshu nga na kjo komunikatë.
14 Dhe mu nuk më kujtohet se ka pas si zonë operative numër 1. Në
15 atë kohë kryesisht është marrë Xheladin Gashi dhe Met Hasani
16 me zonat -- me nënzonat, me zonat operative që janë qujt
17 atëhere, po nuk e di a është fjala këtu tash për zonën
18 operative në Drenicë apo në Llap, nuk e di saktë. Nuk e kam
19 pas një organigramë të Shtabit Qendror atëherë me drejtoritë
20 operative se si janë nda ato.

21 Unë mendoj se kjo është veç një komunikatë veç për
22 opinion, ma tepër me glorifiku sesa që ka diçka të vërtetë.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Bashota. Ne
24 kemi informacione që fillimisht, pra në vitet përpara fillimit
25 të luftës, deri nga fundi i '98-s ka pasur, kanë ekzistuar

1 nënzona nën varësinë e një zone më të madhe e cila mbulonte të
2 gjithë Kosovën. Dhe më pas terminologjia ndryshoi dhe këto
3 nënzona u transformuan në zona. Keni dëgjuar ju për këtë
4 proces?

5 PË. Në letër edhe kanë mujt me ekzistuar, por po them në atë
6 kohën për kur në vitet 1996 dhe 1997, kanë qenë krejt tre
7 grupe, katër në Kosovë, s'e besoj se kanë qenë më shumë, të
8 cilat janë organizuar për vetëmbrojtje dhe nuk kanë qenë mirë
9 të konsoliduara mes vete.

10 Zonat ndoshta janë bo vetëm për qëllime se si duhet të
11 vazhdojë organizimi në të ardhmen, me idenë se kanë me u rrit
12 numri i luftëtarëve, kanë me u rrit numri i ushtarëve të UÇK-
13 së dhe thjesht të jenë kështu si skica parapërgatitore për
14 mbarëvajtjen e luftës.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Z. Bashota. Që
16 të jemi të qartë, unë e kam fjalën kryesisht për ndryshimin e
17 terminologjisë. Ju përmendët zonën e Drenicës. Tani do t'ju
18 bëj një pyetje për këtë. A ka mundësi që zona operative 1, në
19 fakt, të jetë një referencë për gjithë Kosovën, t'i referohet
20 të gjithë Kosovës?

21 PË. Zona operative 1, unë mendoj se në atë kohë është qujt
22 zona -- Kosova është qujt si zona operative.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për shembull, zona operative
24 e Drenicës asokohe, të paktën nga pikëpamja e terminologjisë,
25 a mund të ketë qenë nënzona, konsiderohej nënzona?

1 PË. Nënzonë.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Bashota, keni dëgjuar për
3 një person që quhet Faik Bellopoja që përmendet këtu në
4 paragrafin 2 të komunikatës?

5 PË. Jo, i nderuar Gjykatës.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni dijeni nëse është
7 bërë ndonjë sulm në Podujevë në dhjetor 1996 një personi?

8 PË. Nuk e mbaj mend.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni ku keni
10 qenë ju në dhjetor 1996?

11 PË. Në dhjetor 1996 kam qenë në fshatin tim të lindjes.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Na e thoni për procesverbal,
13 ju lutem, kush është fshati juaj i lindjes.

14 PË. Caravik. Atëherë më ka lind djali i parë, me 1 dhjetor,
15 dhe kam qenë në Disak quhet, Caravik.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini nëse është sulmuar
17 një druvar nga UÇK-ja në dhjetor 1996?

18 PË. Jo.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni dëgjuar të jetë vrarë
20 një person në Prishtinë në lagje -- tek lagja e spitalit? Keni
21 dëgjuar, pra, për këtë?

22 PË. Jo.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dhe gjatë
24 pyetjeve që ju bëri Mbrojtja e Krasniqi, ekipi i Mbrojtjes ju
25 tregoi një artikull gazete që ishte një artikull -- ishte një

1 intervistë me një person që quhej Fatmir Sheholli.

2 Do ju lutesha që të rishfaqej në ekran. Faleminderit.
3 shohim pak më poshtë te kjo komunikatë.

4 Z. Bashota, a ju kujtohet ju që ju treguan një artikull
5 gazete. Ishte intervista me një person që quhet Fatmir
6 Sheholli. Ua tregoi avokatja e z. Krasniqi dje. Ju kujtohet?
7 PË. Po.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për procesverbal kjo është
9 tashmë pranuar si provë gjyqësore 4D0089.

10 Tani do ja t'ju pyesja, a e njihni personin e dytë që
11 përmendet në Komunikatën 28 me emrin Maliq Sheholli, i cili
12 ishte deputet i PS-së -- PSS-së?

13 PË. Jo.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni dijeni çfarë i ka
15 ndodhur këtij personi? A është vrarë vërtetë dhe kush e ka
16 vrarë?

17 PË. Nuk e di. Nuk kam njohuri.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Bashota.
19 Ditën e enjte javën e kaluar - në faqen 22987 dhe 22988 të
20 transkriptit - ju thatë se komunikatat përdorëshin për të
21 informuar popullsinë shqiptare në Kosovë dhe jashtë vendit,
22 por edhe për të paralajmëruar personat që bashkëpunonin me
23 armikun. Kështu?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni dijeni si i jepeshin

1 komunikatat mediave përpara se të botoheshin? Për shembull,
2 UÇK-ja i dërgonte me faksimile tek media? Si ja dorëzonte
3 komunikatat?
4 PË. Me thonë të drejtën unë e thashë edhe këtu, unë asnjë
5 komunikatë shkru s'e kam, dhe nuk e di formën sesi janë
6 transmetu ato. Vetëm ato që e kemi mujt gjatë kohës së luftës,
7 për aq sa na kanë leju rrethanat dhe mundësitë me u iformu në
8 atë kohë, për arsye se më të shumtën e raste s'kemi pas qasje
9 mediat, qofshin ato elektronike, qofshin ato të shkruara, por
10 nuk e di.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në paragrafin
12 37 dhe 59 të Shënimit Përgatitor 2, por edhe në sallën e
13 gjyqit keni përmendur një person me emrin Zahir Pajaziti. Ju
14 kujtohet?

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Personi në fjalë, pra Zahir
17 Pajaziti, a ka qenë anëtar i UÇK-së?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Pajaziti, ka pasur ndonjë
20 pseudonim?

21 PË. Nuk më kujtohet.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund ta ketë pasur nofkën
23 Ujku, *wolf* i thonë në anglisht?

24 PË. S'e kam, s'e besoj, s'e kam dëgju kurrë.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini se ku vepronte z.

1 Pajaziti?

2 PË. Z. Pajaziti prejardhjen e ka prej Podujeve, dhe me siguri
3 në atë pjesë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

5 I lutem Sekretares së seancës të vendosë në ekran
6 materialin P275 në anglisht dhe në shqip. Faleminderit.

7 Z. Bashota, e shihni komunikatën që ka dalë në ekran?

8 Është Komunikata numër 30.

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e shihni këtu që përmendet
11 Zahir Pajaziti?

12 E zmadhojmë pak shqipen, ju lutem. E zvogëlojmë, më
13 falni. Në të majtë. Shkojmë në të majtën e ekranit. Edhe më
14 majtas, ju lutem.

15 Këtu shohim që ka dhe një fotografi të këtij personi edhe
16 në kllapa është vendosur viti 1962-1997. E shihni z. Bashota?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Personi në fotografi në të
19 majtë të ekranit a është personi që ju e njihnit si Zahir
20 Pajaziti?

21 PË. Po duhet se është i njëjti. Nuk po muj shumë me e
22 identifiku kuart foton, po duket se është i njëjti.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

24 Ju lutem ta vendosim komunikatën në shqip. Domethënë ta
25 zmadhojmë që të kemi mundësi ta lexojmë. Faleminderit.

1 Z. Bashota, në paragrafin e parë kjo komunikatë thotë si
2 në vijim:

3 "Më 31 janar 1997, në orët e vona të pasdites, tre
4 pjesëtarë të njësave tona ushtarake, Hakif Zejnullahu, Zahir
5 Pajaziti dhe Edmond Hoxha rrugës për në detyrë të karakterit
6 të veçantë u ndeshëm ballë për ballë me forca të shumta të
7 policisë okupatore serbe. Pas një qëndrese heroike, në betejë
8 të pabarabartë dhanë jetën për çlirimin e vendit."

9 Z. Bashota, përshkrimi a përkon me atë që dini dhe ju
10 lidhur me atë që i ka ndodhur Zahir Pajazitit në janar 1997?
11 PË. E di që janë vrarë në pritë, por në çfarë detyrash që
12 thotë këtu janë kon duke shkuar, nuk e di këtë, por që janë
13 vrarë në pritë, po.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kjo do të kishte qenë pyetja
15 ime e radhës në fakt. Pra, ju nuk e dini se çfarë detyre e
16 karakterit të veçantë ka qenë kjo, ku po shkonin z. Pajaziti
17 dhe bashkëluftëtarët? Pra, nuk e dini?

18 PË. Jo, këtë nuk e dit as atëhere.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Bashota,
20 keni dëgjuar për ceremoninë mortore të një personi me emrin
21 Milos Nikolic, që pretendohet se është ekzekutuar më 25 tetor
22 1996?

23 PË. S'më kujtohet.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] I lutem Sekretares së seancë
25 të vendosë në ekran edhe një herë provën P273 vetëm në shqip.

1 E shohim pak më qartë, ju lutem, Komunikatën 28, djathtas.

2 Z. Bashota, të enjten e shkuar ju thatë se kjo komunikatë
3 është lëshuar jashtë Kosovës. Tani unë dëshiroj t'ju pyes pse
4 e thoni këtë? Sepse ju po ashtu javën e kaluar thatë që këtë
5 komunikatë e keni parë për herë të parë këtu në këtë sallë
6 gjyqi. Atëherë, nga e dini ju që kjo komunikatë është lëshuar
7 jashtë Kosovës, sepse në komunikatë poshtë djathtas thuhet që
8 kjo deklaratë është shkruar ose të paktën është lëshuar nga
9 Shtabi i Përgjithshëm në Prishtinë më 12 janar 1997?

10 PË. Këtu, i nderuar Gjyqtar, i jam referu gazetës Zërit të
11 Kosovës e cila është botuar në perëndim. Ndërsa ky paragrafi
12 këtu që është lëshuar në Prishtinë, këtë nuk e di që -- nuk e
13 mbaj mend që është lëshuar në Prishtinë. Por, gazeta është një
14 gazetë që ekskluzivisht është botuar në Zvicër, më duket, dhe
15 iu kam referu pikërisht kësaj.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A është e saktë atëherë të
17 themi që në të vërtetë ju nuk e dini ku është shkruar kjo
18 komunikatë? A është shkruar në Prishtinë apo jashtë Kosovë apo
19 gjetkë në Kosovë?

20 PË. E saktë. Saktë nuk e di.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

22 I lutem Sekretares së seancës të vendosë në ekran provën
23 materiale P274 dhe në anglisht dhe në shqip. Faleminderit. Kjo
24 është.

25 Z. Bashota, hidhini një sy të shpejtë dokumentit dhe na

1 thoni a e njihni një person me emrin Fazli Hasani nga
2 Braboniqi i Mitrovicës. E shihni? E njihni këtë person?

3 PË. Jo, nuk e njoh, i nderuar Gjyqtar.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini nëse është vrarë
5 vërtetë ky person në janar 1997?

6 PË. Jo, nuk e di.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni dëgjuar - të shohim
8 paragrafin tretë dhe anglishtja dhe shqipja duhet të jenë
9 njësoj - keni dëgjuar për ekzekutimin ose tentativën,
10 ekzekutimin të mbetur në tentativë të rektorit të
11 universitetit serb në Prishtinë, Radivoje Papovic kur u plagos
12 dhe shoferi i tij Nikola Lalic?

13 PË. Po, për këtë e kam dëgjuar përmes medias se kjo i është
14 dhënë një popullaritet i madh atëherë nga mediat në Kosovë. E
15 kam dëgjuar për të si rast.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam edhe dy, tri pyetje
17 përpara se të bëjmë pushimin. A mund të na thoni çfarë keni
18 dëgjuar? Pra, sipas asaj që keni dëgjuar ju, çfarë i ka
19 ndodhur z. Popovic dhe vozitësit të tij?

20 PË. Është thënë në atë kohë se nga një mjet shpërthyes është
21 plagosur rektori i atëherë Popovic në Kosovë, nga një
22 shpërthim në Prishtinë.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni dëgjuar kush ka qenë
24 përgjegjës për këtë shpërthim?

25 PË. Jo.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini çfarë e shkaktoi
2 këtë shpërthim?

3 PË. Nuk e di.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mbase mund t'ju ndihmoj.
5 Keni dëgjuar ju që shpërthimi u shkaktoi me karbon [Sipas
6 përkthimit] në distancë, të kontrolluar në distancë. Më falni,
7 karbon -- bombë e kontrolluar në distancë?

8 PË. Po, kështu është thon edhe atëherë. Është paraqitur si
9 një atentat që është bërë në rektorin Papovic me mjete
10 shpërthyes nga distanca.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni dijeni nëse z. Papovi
12 dhe shoferi i tij i mbijetuan sulmit?

13 PË. Me sa mbaj mend unë, po.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja fundit përpara
15 pushimit. Shikoni ju lutem paragrafin e katërt. Dhe shqipja
16 dhe anglishtja janë njësoj. A e njihni një person me emrin Xum
17 Dervishi nga Skënderaj?

18 PË. Jo, nuk e njoh.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni dijeni në qoftë se ky
20 person është plagosur dhe është vrarë në janar 1997?

21 PË. Jo, i nderuar Gjyqtar, nuk e di. S'më kujtohet.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Është koha për
23 pushimin.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
25 gjysmë ore pushim, Dëshmitar, tani. Do rikthehemi në orën

1 11.30 në sallën e gjyqit. Mund të dilni nga salla tani me
2 Sekretaren e seancës.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
5 deri në orën 11.30.

6 --- Pauza fillon në orën 11.02

7 --- Seanca rifillon në orën 11.30

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
9 sillni dëshmitarin në sallë.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Bashota,
12 do të vazhdojmë tani me pyetje të Trupit Gjykses. Do të
13 vazhdojë me pyetjet e veta Gjykatësi Barthe.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

15 Dhe mirë se u kthyet, z. Bashota.

16 PË. Faleminderit.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Bashota, gjatë dëshmisë
18 këtu përpara nesh, po gjithashtu edhe në seancë përgatitore -
19 dhe këtu e kam fjalën për Shënimin Përgatitor numër 2,
20 paragrafi 37 - ju keni përmendur një person me emrin Nait
21 Hasani si anëtar i Shtabit Qendror, na keni thënë që ai është
22 arrestuar. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni konfirmuar të hënën, në
25 faqen 123134 të transkriptit, në përgjigje të një pyetjeje nga

1 Mbrojtja e z. Thaçi që Nait Hasanaj ishte arrestuar në janar
2 të 1997-s. A është e saktë kjo mesa dini ju?

3 PË. Po. Mesa di unë në janar.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. A mund të na
5 thoni se kush e ka arrestuar Nait Hasanin dhe pse është
6 arrestuar Nait Hasani?

7 PË. Arsyet pse saktë nuk i di, se nuk e kam pa më vonë
8 aktakuzën e tina, po e di se është arrestuar nga policia e
9 Serbisë apo nga shërbimi sekret i Serbisë në Kosovë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po nuk e dini arsyen pse
11 është arrestuar, kështu?

12 PË. Jo.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Thatë gjithashtu që Xheladin
14 Gashi shkoi në Shqipëri, a është e saktë kjo?

15 PË. Po. Një kohë ka qëndruar në Prekaz te komandanti
16 legjendar Adem Jashari, më vonë ka shku për Shqipëri.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni
18 konkretisht se kur z. Gashi është larguar dhe ka ikur për në
19 Shqipëri? Edhe kjo ka ndodhur në janar ose në shkurt të 1997?

20 PË. Jo, mendoj, mendoj më vonë. Nuk e di. S'jam shumë i
21 sigurtë këtu.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Prapë bëhet fjalë për 1997-
23 n, apo jo, Dëshmitar?

24 PË. Po, në 1997. Po.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini arsyen se pse z.

1 Gashi është larguar prej Kosove?

2 PË. Po e thashë se me burgosjen e Naitit, vrasjen e Zahirit,
3 e burgosjen e Bislam Zogajt, ne, faktikisht u shkapërderdhëm
4 dhe të qënurit në Kosovë me siguri i është dukur e pamundur.
5 Dhe ka shku për në Shqipëri. Po është ndonjë arsye tjetër, unë
6 nuk kam -- nuk e di.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, nga përgjigja që sapo
8 dhatë pasi ju bëra unë pyetjen, të paktën nga pikëpamja juaj,
9 a është e mundur që z. Gashi të jetë larguar prej Kosove dhe
10 z. Hasani është arrestuar për shkak ose në lidhje me
11 veprimtaritë e tyre si anëtarë të Shtabit Qendror, a është e
12 mundur kjo?

13 PË. Ka mundësi.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë, me fjalë të
15 tjera, nuk kishte të bënte asgjë me arrestimin e z. Hasani ose
16 me veprimtari të tjera kriminale si, për shembull, trafikim
17 droge ose vepra të tjera penale, mesa dini ju, kështu?

18 PË. Nga natyra sa unë Nait Hasanin e kam njoftun në studime,
19 nuk ka qenë person i cili është marrë me ndonjë veprimtari
20 tjetër. Për arsye se ai ka qenë një djalë i cili është -- ka
21 qenë i burgosur edhe më herët, ka qenë i burgosur politik edhe
22 më herët, mesa kujtoj dhe përpos veprimtarisë tina patriotike
23 nuk ka pas asnjë arsye tjetër burgosja e tij.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Më tej keni
25 deklaruar të enjten e javës së shkuar në faqen 23002 të

1 transkriptit dhe po ashtu edhe më herët gjatë kësaj jave, se
2 koha e shtabit -- në kohën e Shtabit Qendror është thënë që
3 komunikatat janë shkruar jashtë shteti dhe se Xheladin Gashi
4 dhe Nait Hasani ishin personat që kryesisht janë marrë me to,
5 pra, me komunikatat. A ju kujtohet ta keni thënë këtë,
6 Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dua të di kush e ka thënë
9 këtë gjë? Se ju keni thënë që thuhej që komunikatat ishin
10 shkruar jashtë shteti? Domethënë, kush e ka thënë këtë ose nga
11 e keni mësuar ju këtë gjë?

12 PË. Kur është fol për komunikatat që kemi diskutu me Nait
13 Hasanin, Naiti ka thënë "Kjo është çështje e imja dhe e
14 Plakut, domethënë, Xheladin Gashit" dhe pej tij e kam të
15 ndëgjuar.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur ka ndodhur kjo përpara
17 apo pasi të arrestohej ai?

18 PË. Jo, përpara.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet përafërsisht
20 kur ka qenë në 1996 apo jo?

21 PË. Jo, ka mundësi ma herët. Ka mundësi edhe më herët.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të përpigëni që të
23 jeni pak më preciz pak më i saktë?

24 PË. Po ndoshta ose ka ose 1994 ose dhe aty 1994, 1995. S'jam
25 i sigurtë. Si kam kushtu fort rëndësi kësaj, z. Gjyqtar.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Nuk është
2 problem.

3 Po ashtu keni deklaruar se keni deklaruar këtu se
4 Xheladin Gashi dhe Nait Hasani janë persona të cilët kryesisht
5 janë marrë me komunikatat. Pyetja që rrjedhë prej kësaj
6 përgjigje tuajës është që kush tjetër përveç tyre është marrë
7 me komunikatat nga Shtabi Qendror përveç z. Gashi dhe z.
8 Hasani, se keni thënë "kryesisht" janë marrë këta të dy, po
9 përveç këtyre kush është marrë tjetër?

10 PË. Po këtë ma ka thënë Nait Hasani se komunikatat po dalin
11 dhe nga "jashtë". Nga jashtë Kosovës është fjala.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ai nuk ju ka përmendur asnjë
13 emër, domethënë, se kush ka qenë përgjegjës për sa i takon
14 lëshimit të komunikatave nga jashtë shteti, domethënë, nga
15 jashtë Kosove, s'ju ka përmendur asnjë emër?

16 PË. Jo.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka thënë ai më konkretisht
18 se nga cili vend vinin komunikatat ose nga ku lëshoheshin
19 komunikatat prej cilit vend?

20 PË. Jo, s'ma ka përmend.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Bashota, e keni
22 konfirmuar përpara një jave, pra, në faqen 23001 të
23 transkriptit, që ju keni qenë pjesë e Shtabit Qendror në
24 dhjetor të 1996-s dhe në janar të 1997-s. Pyetja që kam për ju
25 është kjo: Kush tjetër ka qenë anëtar i Shtabit Qendror në atë

1 kohë? Ju keni folur në Shënimin Përgatitor 2 në paragrafin 36
2 rreth anëtarëve kryesorë të parë të cilët u bënë anëtarë të
3 Shtabit të Përgjithshëm prej Shtabit Qendror. Ndërkohë që
4 pyetja që kam tani për juve është që në periudhën që unë
5 citova më sipër, kush ka qenë tjetër anëtar i Shtabit Qendror
6 përveç jush, besoj, z. Hasani, z. Gashi, Xheladin Gashit
7 domethënë, në dhjetor të 1996-s ose janar të 1997-s, kush
8 tjetër ka qenë anëtar i Shtabit Qendror, Dëshmitar?
9 PË. Ka qenë Azem Syla, Xheladin Gashi, Nait Hasani, unë, Ali
10 Ahmeti, nëse janë gjashtë persona. Nëse i thashë të gjithë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni thënë pesë. Po i
12 gjashtë kush është? A mund të mundoheni që t'i numëroni dhe
13 një herë dhe të siguroheni --

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] -- që janë gjashtë veta, që
16 çfarë thatë është e saktë?

17 PË. Azem Syla, Xhavit Haliti, Ali Ahmeti, unë, Nait Hasani
18 dhe Xheladin Gashi.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Gjashtë. Në rregull.
20 Faleminderit.

21 Z. Bashota, të hënën gjatë pyetjeve të Mbrojtjes së
22 Thaçi, juve thatë që z. Thaçi nuk ka qenë anëtar i Shtabit
23 Qendror në 1996-n dhe 1997-n, por është bërë anëtar i Shtabit
24 të Përgjithshëm në nëntor të vitit 1998. A është e saktë kjo,
25 Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Gjithashtu thatë, në
3 përgjigje të një pyetjeje që ju bëri Mbrojtja e Veselit dje,
4 se z. Veseli po ashtu nuk ka qenë anëtar i Shtabit Qendror. A
5 është e saktë kjo?

6 PË. Po, e saktë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jakup Krasniqi as ai nuk ka
8 qenë anëtar i Shtabit Qendror në 1997-n?

9 PË. Saktë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për të qenë të qartë, i
11 vetmi i akuzuar sipas deklaratës tuaj që në të vërtetë ka qenë
12 anëtar i Shtabit Qendror në vitin 1997, është z. Rexhep
13 Selimi, a është e saktë kjo?

14 PË. E kam thënë aty në deklaratë se kur ka shku për Shqipëri
15 z. Xheladin Gashi, ma ka përmend se duhet të jetë dhe Rexhep
16 Selimi dhe Lahi Brahimi si anëtar i Shtabit Qendror. Por
17 realisht ne deri në përpjekjen e parë që kemi bë nuk ka mujt
18 as me i kontaktu z. Selimi dhe as me e funksionalizu këtë si
19 përpjekje të Shtabit Qendror apo Shtabit të Përgjithshëm më
20 vonë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në të vërtetë, z. Bashota,
22 sipas Shënimit Përgatitor numër 1, paragrafi 5, ju i keni
23 thënë Prokurorisë si më poshtë dhe këtu citoj:

24 "Kur Xheladin Gashi u largua për në Shqipëri, u vendos që
25 Rexhep Selimi dhe Lahi Brahima j duhet që të bëheshin pjesë e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 66

1 Shtabit Qendror sepse një pjesë e mirë e shtabit ishin larguar
2 nga Kosova dhe këta të dy ishin në Kosovë. Dëshmitari 04401",
3 që jeni ju, z. Bashota, "nuk beson se Rexhep Selimi ka pas
4 mundësi të bëjë asgjë në Shtabin Qendror në vitin 1997".

5 A mund të na thoni se pse Rexhep Selimi nuk ka pas
6 mundësi që të bëjë asgjë në Shtabin Qendror në 1997,
7 Dëshmitar?

8 PË. Për shkak se s'kemi qenë të konsoliduar si grup.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të enjten e javës së shkuar
10 në përgjigje të një pyetjeje t ngjashme të bërë nga Prokurori,
11 në faqen 22972 të transkriptit, ju thoni dhe këtu citoj:

12 "Sipas informacionit që kam unë, ne nuk jemi takuar shumë
13 shpesh në atë kohë. Nuk kemi kaluar kohë me njëri-tjetrin në
14 atë kohë."

15 Pyetja që kam tani për juve është kjo: Pse ju thoni që z.
16 Selimi nuk ka pasur mundësi të bëjë asgjë në Shtabin Qendror
17 në 1997-n? Domethënë, me fjalë të tjera, kush jua ka thënë
18 juve këtë gjë?

19 PË. Po të paktën nga pjesa e Shtabit Qendror që kishte mbetur
20 në Kosovë isha vetëm unë, për arsye se Xhavit Haliti, Ali
21 Ahmeti dhe Azem Syla ishin jashtë. Nuk e di a në Shqipëri apo
22 në Zvicër. Xheladin Gashi shkoi në Shqipëri. Nait Hasani u
23 burgos. Isha vetëm unë që kisha mbetur në Kosovë nga pjesa e
24 Shtabit Qendror. Faktikisht, ai ishte një shtab komplet, mund
25 të them, se ishte i shpërbërë sa i përket aktivitetit dhe

1 angazhimit të tij në Kosovë.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për të qenë të qartë, këtë
3 që ju po e thoni që ju dhe z. Selimi keni qenë të vetmit
4 anëtarë të Shtabit Qendror që keni qëndruar në Kosovë në atë
5 kohë, që kemi mbetur në Kosovë në atë kohë, prandaj e thoni?
6 PË. Po, në Kosovë. Po nuk është e zyrtarizu në një mbledhje
7 apo një takim saktë kyçja e Rexhep Selimit dhe Lahi Brahimit
8 në shtab. Thjesht ai, Plaku, ka thënë që duhet me hy, po
9 realisht me mu personalisht nuk ka bisedu, më tutje ka shku
10 për Shqipëri.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përsëri po kërkoj sqarime
12 prej jush. A do të thotë kjo që z. Selimi nuk ka qenë anëtar
13 i Shtabit Qendror në vitin 1997? Mendohej që do bëhej anëtar,
14 po nuk u bë anëtar sepse ju nuk u takuat ose nuk patët mundësi
15 që të takoheshit me anëtarë të tjerë të Shtabit Qendror për të
16 vendosur në qoftë se ai do bëhej anëtar, apo jo?

17 PË. Po, mesa unë e di kaq është. E saktë është.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përsëri, që ta kuptoj drejt.
19 A ishte e nevojshme, a ishte e domosdoshme që të merrej një
20 vendim në mënyrë të tillë që z. Selimi të mund të bëhej anëtar
21 i Shtabit Qendror, domethënë, do të duhej me patjetër që të
22 merrej një vendim kolegjal për këtë, e kam fjalën këtu nga
23 anëtarët e tjerë të Shtabit Qendror? Këtë po thoni?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mendoj që ju kuptoj tani.

1 Faleminderit për sqarimin e dhënë.

2 Z. Bashota, do ju bëj pyetjet e mëposhtme, është një
3 pyetje shumë e rëndësishme dhe do ju tregoj, do jua shpjegoj
4 se pse po e bëj dhe një herë pyetjen, nëse më lejoni. Ju
5 personalisht a keni qenë i përfshirë në shkrimin ose
6 publikimin e komunikatave pas arrestimit të Nait Hasanit në
7 janar 1997?

8 Do t'jua shpjegoj tani se pse po e bëj edhe një herë
9 pyetjen. Ne kemi dëgjuar nga Prokuroria - dhe kjo është në
10 faqen 23808 të transkriptit - që z. Selimi mesa duket ka
11 deklaruar që "ju keni qenë një ndër personat që është marrë me
12 komunikatat gjatë 1997-s".

13 Kështu që për këtë arsye po ju bëj dhe një herë këtë
14 pyetje, z. Bashota, edhe sot ju dëshminë e keni që nuk jeni
15 marrë fare me shkrimin ose me publikimin e komunikatave në
16 vitin 1997?

17 PË. Asnjë komunikatë nuk e kam shkru, i nderuar Gjyqtar.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Përsëri po kërkoj
19 sqarime. A keni ndonjë shpjegim se pse z. Selimi ka thënë që
20 ju keni qenë një prej personave që janë marrë me komunikatat
21 në 1997?

22 PË. Unë nuk e di se nëse çka ka thënë z. Selimi. Atë ditë në
23 këtë seancë Prokurori tha, mesa muj me mbajt mend, se "Z.
24 Selimi nuk ju ka thënë se ju kryesisht jeni marrë me këtë
25 punë", por a jeni marrë. Dhe faktikisht ai ka mujt ndoshta me

1 supozu. Por realisht unë nuk e kam shkru as edhe një
2 komunikatë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Bashota, e kontrollova
4 dhe një herë citimin. Ajo çfarë thuhet konkretisht në
5 transkript lidhur me atë se çfarë ka thënë z. Selimi dhe këtu
6 dua që të citoj atë çfarë ka thënë z. Selimi dhe që është
7 regjistruar në transkript që ju ishit, domethënë, Sokol
8 Bashota ishte "një prej personave që është marrë me
9 komunikatat gjatë 1997". Kjo është regjistruar në
10 procesverbal.

11 E di që ju sigurisht nuk keni qenë aty. As unë vetë nuk
12 kam qenë aty. Dhe për këtë arsye po ju bëj pyetjen a keni një
13 shpjegim lidhur me këtë, pse e ka thënë z. Selimi këtë? Cila
14 mund të jetë arsyeja?

15 PË. Unë arsyen pse e ka thënë këtë unë nuk muj me dit
16 realisht, po unë po e them me përgjegjësi që nuk e kam shkru
17 asnjë komunikatë, nuk kam shkru.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe gjithashtu ju nuk keni
19 publikuar apo nuk jeni marrë fare në asnjë mënyrë tjetër me
20 komunikatat, nuk është se keni dhënë informacion, keni marrë
21 informacion, i keni përcjellë informacion personave që kanë
22 shkruar komunikatat në 1997-n, sepse ju vetë nuk keni qenë në
23 Kosovë, kështu?

24 PË. Jo, në Kosovë në 1997 kam qenë.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ke qenë në Kosovë?

1 PË. Jo, kam qenë në Kosovë në 1997-n, por një pjesë kam qenë
2 në Shqipëri, një kohë kam qenë në Shqipëri. Por unë nuk i kam
3 -- komunikata nuk kam shkru.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju, sikurse e thashë edhe më
5 herët, nuk keni dhënë informacion për askënd për të shkruar
6 ose që për të publikuar komunikata lidhur me ngjarjet në
7 Kosovë ose çfarë ndodhte në Kosovë *underground* ndërkohë që ju
8 keni qenë vetë në Kosovë, kështu?

9 PË. Jo, nuk më kujtohet që ka mujt me i thënë dikujna ose me
10 sugjeru diçka dikënd.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Mesa dini ju,
12 a ka qenë i përfshirë ndonjë prej të akuzuarve në shkrimin dhe
13 publikimin e komunikatave në vitin 1997? E kam fjalën për të
14 akuzuarit në këtë sallë gjyqi?

15 PË. Jo, s'e besoj.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni që pse
17 s'e besoni këtë gjë, pse nuk e besoni se një prej të akuzuarve
18 mund të ketë qenë i përfshirë në shkrimin dhe publikimin e
19 komunikatave në 1997-n? Po flas vetëm për 1997-n këtu.

20 PË. Po për arsye se nuk kanë pas përgjegjësi në atë kohë
21 asnjëri prej tyre me bë një gjë të tillë.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përsëri që të jem i qartë
23 lidhur me këtë, me këtë pikë. Të supozojmë që komunikatat nuk
24 janë shkruar në Kosovë, po që janë shkruar jashtë shtetit,
25 sikurse keni thënë ju, si mund të jeni ju të sigurtë që ato

1 nuk janë shkruar ose nuk janë publikuar nga të akuzuarit të
2 cilët, për shembull, nuk kanë qenë në Kosovë gjatë asaj
3 periudhe, sipas deklaratës tuaj, z. Thaçi ose z. Veseli nuk
4 kanë qenë në Kosovë, nuk kanë jetuar në Kosovë në atë kohë,
5 nga mund të jeni i sigurtë ju që nuk janë shkruar apo
6 publikuar komunikatat nga një prej të akuzuarve?

7 PË. Unë thashë që iu referova pozicioneve të tyre të cilët
8 nuk i kanë pas në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës për në atë
9 kohë. Unë nuk muj me paragjyku asnjërin nëse ka mujt apo s'ka
10 mujt me e shkru një komunikatë. Por që në pozicion për me fol
11 apo me shkru diçka për UÇK-në nuk kanë pas dhe nuk e di nëse
12 kanë mujt me shkru apo jo.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj që sipas deklaratës
14 tuaj nuk ishte përgjegjësi zyrtare për të shkruar apo për të
15 publikuar komunikata, megjithatë dëshiroj që di që kush e ka
16 pas autoritetin brenda Shtabit Qendror që të shkruante apo të
17 publikonte komunikata në 1996-n apo në 1997-n? Kush mund ta
18 bënte këtë gjë?

19 PË. Në 1996-n deri në burgosjen e Naitit e tregova atë pjesë
20 se Naiti ma herët më ka thënë se "ne merremi me këto". Dhe unë
21 e kam, si thojnë tek ne, e kam flejt mendjen për me hulumtuar
22 për gjenezën e këtyre shkrimit të komunikatave. Nuk e di nëse
23 e kanë bërë Azem Syla, Xhavit Haliti edhe Ali Ahmeti sa kanë
24 qenë në Shqipëri apo e ka bë dikush tjetër atje jashtë, këta
25 të Lëvizjes Popullore të Kosovës ku shumë komunikata janë

1 botuar në organin e tyre. Por unë nuk e di se kanë pas mundësi
2 këta, të akuzuarit me shkru komunikata në atë kohë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Hasani e kishte
4 kompetencën ose të paktën ai ka vepruar dhe ka lëshuar apo ka
5 botuar komunikata përpara se të arrestohej së bashku ndoshta
6 me z. Xheladin Gashin, sikurse e thatë ju. Po ju a kishit
7 kompetencë ose autoritet që të shkruanit apo të publikonit një
8 komunikatë në 1996-n apo 1997-n? Domethënë, në qoftë se donit
9 që ta bënit një gjë të tillë, a kishit të drejtë, a kishit
10 kompetencë për ta bërë këtë gjë?

11 PË. Jo, kompetencë nuk kam pas me shkru një komunikatë të
12 tillë.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund t'ju pyes pse, pse
14 nuk e keni pas një autoritet, një kompetencë të tillë? Se në
15 fund të ditës ju ishit anëtar i Shtabit Qendror dhe anëtarë të
16 tjerë të Shtabit Qendror si, për shembull, z. Hasani dhe z.
17 Gashi i kanë shkruar dhe i kanë publikuar komunikatat. Po ju
18 pse s'e kishit kompetencën ose autoritetin ta bënit një gjë të
19 tillë?

20 PË. Për shkak se Nait Hasani ka qenë atëherë përgjegjës i
21 Shtabit Qendror dhe unë nuk kam pas kompetenca dhe përgjegjësi
22 me e shkru. Po e përmend që është edhe Azem Syla komandant dhe
23 nuk e di sesa janë kanë të koordinuar mes veti për shkrimin e
24 këtyre komunikatave apo jo.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këtyre dy personave, z.

1 Hasanit dhe z. Gashi, kush ia ka dhënë kompetencën ose
2 autoritetin për të shkruar apo për të hartuar komunikatat? Ia
3 ka dhënë Azem Syla apo ndonjë person tjetër apo është vendosur
4 midis anëtarëve të Shtabit Qendror përpara sesa të arrestohej
5 z. Hasani --

6 PË. Me siguri --

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] -- dhe përpara sesa z. Gashi
8 të largohej prej vendit, kështu?

9 PË. Po. Me siguri duhet t'ia ketë dhënë Azem Syla. Ose i kanë
10 bashkërenduar ose i ka informuar por kryesisht kjo linjë,
11 sipas përshtypjeve të mia, është dashur dhe është të ndjekej.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për ju, z. Bashota, ishte në
13 rregull, domethënë që e keni pranuar që anëtarë të tjerë të
14 Shtabit Qendror, për shembull, z. Hasani dhe z. Gashi të mund
15 të lëshonin komunikata në emër të Shtabi të Përgjithshëm,
16 domethënë, për ju personalisht nuk është se kishte ndonjë
17 problem me këtë, apo jo?

18 PË. Jo, s'kemi pasur probleme.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. Bashota, Trupi Gjykses dëshiron që të mësojë prej jush
21 si më poshtë: Kush ka qenë përgjegjës për shkrimin dhe
22 publikimin e komunikatave qofshin ato politike ose deklarata
23 të llojeve të tjera të UÇK-së gjatë luftës në vitin 1998 dhe
24 1999?

25 PË. Personalisht kurrë s'jam interesuar me e dit dhe nuk e

1 di. Nuk jam marrë me to. E kam hjek herët ose atë mendjen për
2 shkrimin e atyre komunikatave. Nuk ka qenë punë dhe e imja që
3 muj e bëj. Dhe realisht kurrë nuk kam pyetur për to se kush po
4 i bën dhe kur po i bën, a po bëhen në Kosovë dhe a po bëhen
5 jashtë. Por unë informacion për këtë nuk kam. Nuk guxoj me e
6 marrë përgjegjësinë me ngarku dikënd për të cilën nuk e di.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A është dëshmia juaj ende
8 dhe tani që ju personalisht nuk keni pas njohuri se kush i ka
9 shkruar dhe kush i ka publikuar komunikatat nga shkurti i
10 1997-s deri në fund të luftës sikurse e keni konfirmuar në
11 pyetjet që ju bëri Mbrojtja e Thaçit? I qëndroni ende kësaj
12 dëshmie tuajës?

13 PË. Unë nuk kam -- mesa e kam kujtesën nuk më kujtohet që e
14 di që ka mujt me i shkru dikush brenda Shtabit të
15 Përgjithshëm.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini se kush i shkruante
17 apo lëshonte deklaratat politike për UÇK-në në atë kohë? Nuk e
18 kam fjalën për komunikatat tani. E kam fjalën për deklaratat
19 politike ose deklarata të tjera në emër të UÇK-së. Për të qenë
20 më i saktë në emër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

21 PË. Unë nuk e di saktë këtë, por ka pas kompetenca,
22 kompetenca, ka pas të drejtë me bë dhe deklarata dhe apo dhe
23 komunikata më duket edhe prej zyrës së z. Demaçi për çështje
24 të takimeve të ndryshme. Ndoshta ka mujt, po nuk e di. Nuk jam
25 i sigurtë këtu, si drejtor i drejtorisë politike z. Thaçi. Po

1 nuk e kam të saktë nëse ka mujt me shkru ndonjë me autorësi të
2 vetën apo jo. Këtë nuk e di.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Bashota, nëse më kujtohet
4 saktë, ju thatë që keni qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm
5 dhe për një periudhë të caktuar kohore keni qenë dhe
6 zëvendëskomandant i UÇK-së, më korrigjoni nëse e kam gabim, po
7 më duket se thatë se keni qenë edhe anëtarë i drejtorisë
8 politike? A keni qenë vërtetë anëtar i drejtorisë politike?
9 PË. Po.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Unë po ju pyes sepse kemi
11 dëgjuar nga dëshmitarë të tjerë se drejtorja politike ka pasur
12 shumë pak anëtarë dhe vazhdimisht nuk ka pasur numër të
13 mjaftueshëm personeli. Pajtoheni me këtë propozim?
14 PË. Po.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju po thoni që ka të
16 ngjarë që t'i ketë lëshuar zyra e z. Demaçi deklaratat
17 politike në emër të UÇK-së. Dhe po thoni që, po mund të ketë
18 ngjarë që edhe drejtorja politike - dhe në këtë rast z. Thaçi
19 - mund të kenë lëshuar deklaratat politike, por ju konkretisht
20 nuk e dini, saktë?
21 PË. Saktë.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, nëse drejtorja ka pasur
23 shumë pak punonjës, a mund të na e shpjegoni atëherë si ka
24 mundësi që nuk e dini çfarë bënin anëtarët e drejtorisë
25 politike? Nuk keni qenë ju i pranishëm kur punonin anëtarët e

1 tjerë?

2 PË. Ne në vijë, i nderuar Gjykatës, sesi po krijohet
3 përshtypja e këtyne forumeve qoftë Shtabit të Përgjithshëm,
4 qoftë drejtorisë politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
5 por ne nuk i kemi pas, përpos asaj selie që ka qenë në
6 Divjakë, nuk kemi pas, siç thojm, një staf të organizuar sikur
7 në kushtet e paqes. Ajo thjesht ka qenë luftë dhe takimet kanë
8 qenë shumë të rralla në atë kohë dhe në të shumtën e rasteve
9 nuk kanë mujt me kanë të gjithë.

10 Thashë se kemi takime aq të pakta që i kemi mbajtur, kemi
11 raportu gjithsecilit për takimet që i ka bë. Në qoftë se unë
12 kam bë një takim me Walker apo Shaun e kam raportu takimin se
13 çka është bisedu, mbasi Jakupi qashtu, Jakup Krasniqi, në
14 qoftë se e ka diskutuar me dikën prej ndërkombëtarëve dhe z.
15 Thaçi, kryesisht që ka pas takimet e nivelit ndoshta dhe më të
16 lartë siç është Petritsch dhe personalitete tjera
17 ndërkombëtare, ka mujt me sqaru vetëm angazhimin dhe punën që
18 kanë bë dhe takimet që kanë pas me këta.

19 Për komunikatat pastaj nuk e di ma vonë sesi janë bë.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Z. Bashota,
21 pyetjet e fundit që kam për ju lidhen me Shënimin Përgatitor
22 2, paragrafi 32 deri në 35, ku flisni për arrestimin dhe
23 ndalimin e dy gazetarëve serbë dhe veprimtarëve politikë Cen
24 Desku dhe Jakup Kastrati. Ju kujtohet kjo linjë pyetjesh?

25 PË. Po. Po.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Folët, keni folur për këtë
2 edhe gjatë seancës përgatitore po keni folur edhe në sallën e
3 gjyqit disa herë, ju kujtohet?

4 PË. [E padëgjueshme].

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Bashota, unë do ju pyes
6 drejtpërdrejt: A është ende dëshmia juaj që ju nuk e dini
7 kush e ka marrë vendimin për lirim të katër të burgosurve?

8 PË. Po, i nderuar Gjykatës.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju e keni thënë në fakt
10 gjatë seancës përgatitore - dhe kjo është pasqyruar në
11 paragrafin 35 të Shënimit Përgatitor 2 - pra, e keni thënë se
12 ju nuk e dinit, paktën sipas kësaj që është zbardhur në
13 shënimin përgatitor, që ju nuk e dini kush e ka marrë urdhrin
14 për lirim të këtyre dy personave dhe keni mësuar për këtë nga
15 Shaun Byrnes që Adem Demaçi kishte lëshuar një letër, kështu?

16 PË. Jo. Kështu, i nderuar Gjyqtar. Ka një ngatërresë në
17 përshkrimin tuaj. Letrën ma ka dërguar Demaçi përmes një
18 asistenti të tij apo shoferi i tij, nuk e di, ma ka dërgu mu.
19 Ndërsa ndërkohë ka thirrur dhe Shaun Byrnes dhe ka bërë, ka
20 tregu se ka bisedu për këtë çështje me z. Demaçi, por edhe se
21 e ka një kërkesë për mundësinë e ardhjes së dy gazetarëve
22 tjerë, domethënë, agjencisë serbe me qenë prezent gjatë kësaj
23 ceremonie.

24 Thjesht më ka njoftu se kanë me ardh dhe dy gazetarë në
25 mesin e gazetarëve të tjerë në këtë ceremoni.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni biseduar me ndokënd nga
2 Shtabi i Përgjithshëm se çfarë duhet të thoni, çfarë duhet të
3 bënit lidhur me këta të burgosur?
4 PË. Jo, me askënd. Unë thjesht atë ditë i pritsha me ardh një
5 delegacion amerikan, i KDOM-it amerikan, dikun pesë veta apo
6 shtete, nuk e di, në darkë te unë, në familjen time. Dhe ju
7 kam referu vetëm asaj letre. Atë letër e kam marrë e kam
8 përshkru në një fletore timen me të cilën -- se nuk e dijsa
9 sesi do bëhej ceremonia e dorëzimit të tyre. Por realisht nuk
10 -- jam mundu me e mësu përmendsh. Dhe shihet dhe në video aty,
11 se nuk më janë kujtuar të gjitha fjalët saktë çka mi ka thënë
12 Demaçi. Po jam mundu me i bë një përshkrim të atyre fjalëve që
13 i kisha mujt me i mbajt mend dhe i kam thënë aty. Dhe shihet
14 dhe belbëzimi që kam bë gjatë, gjatë asaj paraqitjeje për
15 arsye se ishte paraqitja ime e parë para, para, ndër të parat
16 kështu para mediave. Por një numër aq të madh gazetarëve, se
17 kisha pas para vete kurrë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Z. Bashota, ju dje
19 thatë se nuk ju kujtohet të keni marrë udhëzime nga z. Thaçi,
20 por ju kujtohet se keni marrë udhëzime nga z. Demaçi i cili ju
21 ka thënë në telefon që të përmendni sa më shumë demokracinë në
22 fjalimin që do të mbanit përpara shtypit? A është vërtetë
23 kështu? Keni pasur një telefonatë me z. Demaçi përpara se të
24 shkonit tek vendi ku u liruan të burgosurit?

25 PË. Po. Mbasi e kam marrë atë letrën kemi komunikuar me z.

1 Demaçi për këtë.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju sapo thatë "ne". Të
3 paktën sipas përkthimit doli në shumës ne. The:

4 "... ne komunikuar me z. Demaçi ..."

5 E keni fjalën ju dhe dikush tjetër apo vetëm ju
6 personalisht keni komunikuar me z. Demaçi?

7 PË. Jo, që e thashë "ne" e thashë gabim, pra, më lejoni ta
8 përmirësoj se "unë". Z. Gjyqtar, këto tre ditë, katër, i kam
9 pas aq shumë pyetje sa realisht mund të ngatërrohem. Më fal.
10 Unë kam fol me të.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk është aspak problem.
12 Prandaj dhe ju pyesim.

13 Pra, keni kryer një thirrje telefonike me z. Demaçi. Dhe
14 siç përshkruhet tek shënimi që pamë dje gjatë kundërpvetjeve
15 të Avokatit të z. Thaçi, pra, z. Demaçi ju këshilloi ose më
16 saktë ju rekomandoi të përmendni sa më shumë çështjen e
17 demokracisë.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj që e bëtë pyetjen gabim.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Thashë Thaçi? Ju kërkoj
20 ndjesë. Ju kërkoj ndjesë. Gabim, lapsus. Doja të thoja z.
21 Demaçi, jo z. Thaçi.

22 Po e përsëris dhe një herë pyetjen. A është e vërtetë --
23 se po mendoja për shënimin dhe mu ngatërruan gjërat. A është e
24 vërtetë që z. Demaçi ju tha në telefon që të përmendnit sa më
25 shumë çështjen e demokracisë kur të mbanit fjalim përpara

1 mediave?

2 PË. Po, kështu është.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E përmendët ju në të
4 vërtetë?

5 PË. Diçka demokratike kam thënë. Po s'e di sa më duket, më
6 duket që e kam përmend.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që të jemi të qartë për
8 këtë, në atë kohë z. Demaçi a ishte anëtar i Shtabit të
9 Përgjithshëm, kur them në atë kohë e kam për fundin e nëntorit
10 1998?

11 PË. Nuk mund të them që ka qenë pjesë e Shtabit të
12 Përgjithshëm kështu me ndonjë detyrë përpos detyrës që është
13 ngarku nga Shtabi i Përgjithshëm si përfaqësues politik i
14 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe si person adekuat për me i
15 bë institucionet e Kosovës në atë kohë. Po, ka qenë. Ka qenë,
16 kujtoj, ka qenë.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Të jemi të
18 qartë për një pikë tjetër. Se kemi dëgjuar pikëpamje të
19 ndryshme lidhur me përkufizimin e një instruksioni, këshille,
20 urdhri, rekomandimi. Ajo që ju ka thënë z. Demaçi në telefon,
21 nga mendimi, nga pikëpamja juaja, a ishte një udhëzim, a ishte
22 një urdhëresë, a ishte një urdhër ushtarak, një këshillë apo
23 rekomandim kur ju tha përmendeni sa më shumë demokracinë, në
24 pikëpamjen tuaj, çfarë ishte kjo?

25 PË. Jo s'e besoj që është dashtë me kanë një lloj urdhri për

1 këtë, por thjesht ndoshta rekomandim.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka qenë e mundur që z.

3 Demaçi ta ketë pasur autoritetin t'u jepte urdhra anëtarëve të
4 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në atë kohë, në nëntor të
5 1998-s por edhe më vonë?

6 PË. Unë s'mund t'i them nanji urdhër kështu klasik, në
7 kuptimin e veprimit, por ndikimin e ka pas, por edhe me -- dhe
8 autoritetin po ashtu. Thjesht, Adem Demaçi ka qenë një emblemë
9 dhe është, mbetet e tillë për të gjithë shqiptarët e Kosovës.
10 Prandaj dhe kurrë këtë s'kemi mujt me e nda tek vërtetë nëse
11 është urdhër apo është këshillë. Ka mjaftu me thënë z. Demaçi
12 një gjë dhe të shumtën e raste, përpos problematikën që e kemi
13 pas me të rreth shkuarjes së delegacionit në Rambuje, nuk kemi
14 pas asnjë përplasje tjetër me të, as në koncepte, as në
15 vizionin e tij.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju thatë që kishte
17 autoritet. Atëherë mendoni se ai e kishte dhe autoritetin t'ju
18 urdhëronte ju apo t'ju udhëzonte të hiqnit dorë nga pozita që
19 kishit ose dhe anëtarët e tjerë të Shtabit të Përgjithshëm? A
20 mund ta jepte ai këtë urdhër apo këtë udhëzim dhe të thoshte
21 që X person nga Shtabi i Përgjithshëm të zëvendësohet nga y
22 person?

23 PË. Këtë, këtë jo, por nëse e kish bë një kërkesë të tillë në
24 Shtabin e Përgjithshëm besoj se do të ishte, do të ishte
25 përfillë, në qoftë se do të ishin dhe argumentet e

1 mjaftueshme.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E di që kjo është
3 hipotetike, por sepse unë nuk mendoj që ai ju ka dhënë
4 ndonjëherë, ka dhënë ndonjëherë ndonjë udhëzim të tillë ose
5 ndonjë rekomandim të tillë. Por po them këtë që, në qoftë se
6 z. Demaçi do i kishte kërkuar Shtabit të Përgjithshëm që të
7 ndalonte lufta, ky udhëzim apo rekomandim apo urdhër i tij,
8 sido që ta quani a mendoni që do të ishte respektuar, do të
9 ishte ndjekur?

10 PË. Unë mendoj se në atë periudhë kohore të luftës edhe
11 Shtabi i Përgjithshëm me pas dhënë një urdhër të tillë nuk
12 besoj se do të ishte respektuar nga zonat. Ishte vullneti i
13 njerëzve dhe qytetarëve në atë kohë se lufta e Ushtrisë
14 Çlirimtare e Kosovës është një luftë vullnetare e qytetarëve
15 të saj dhe ideja për t'u çliruar tashmë kishte hyrë në çdo
16 familje, në çdo shtëpi, në çdo -- te çdo individ dhe më është
17 ndarë që thojmë ne shapi pej sheqerit. Thjesht gjithsecili
18 punonte dhe luftonte për t'u çliruar nga Serbia.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju po flisni për Shtabin e
20 Përgjithshëm, po ndërkohë unë po ju pyesja - sigurisht në
21 mënyrë hipotetike - në qoftë se do ishte dhënë një urdhër, një
22 udhëzim, rekomandim, pavarësisht sesi ia vini emrin,
23 domethënë, po në qoftë se do ishte kërkuar nga z. Demaçi që të
24 ndalohej lufta ky urdhër apo rekomandim a do merrej parasysh,
25 do respektohej në Shtabin e Përgjithshëm? Është diçka që

1 Shtabi i Përgjithshëm do ta respektonte këtë këshillë, këtë
2 rekomandim, këtë urdhër, këtë udhëzim sido që ta quani, do ta
3 kishte respektuar apo jo Shtabi i Përgjithshëm?

4 PË. Këtë, këtë të hjekeni një paralele sesa e rrezikshme do
5 të ishte një kërkesë e tillë për atë kohë, por nuk besoj se do
6 të respektohej kjo.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë ta lemë mënjanë
8 pjesën hipotetike dhe të kalojmë tek pjesa e fakteve. Kam dy
9 apo tre pyetje tjera unë. Atëherë sa i takon pyetjeve, atëherë
10 sa i takon shkëmbimit të burgosurve, dua t'ju pyes në qoftë se
11 ka pas ndonjë anëtar tjetër të Shtabit të Përgjithshëm aty të
12 pranishëm përveç jush. A ka pasur ndonjë anëtar tjetër të
13 Shtabit të Përgjithshëm kur janë liruar katër të burgosurit në
14 nëntor të vitin 1998, Dëshmitar?

15 PË. Present e ke fjalën apo?

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, po. Në vendin ku janë
17 liruar present kur ka ndodhur lirimi i të burgosurve.

18 PË. Mesa unë -- unë e kujtoj nuk ka pas, nuk ka qenë dikush.
19 Nuk muj me e ditë saktë kështu. Po s'e besoj se ka qenë
20 dikush.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Sigurisht që
22 ne pamë videon, pamë tek ajo video persona të maskuar me armë.
23 Por nga ajo çfarë dini ju, a mund të na thoni se kush ka qenë
24 aty i pranishëm nga UÇK-ja, ndonjë person nga UÇK-ja që ju e
25 njihni, që ka qenë i pranishëm aty?

1 PË. Nuk, nuk e di. Me thënë të drejtën nuk e kam përcaktu
2 dikën që muj me thënë tash me emër e mbiemër se ka qenë ky
3 person ose ai. Thjesht janë ngjarje që kanë kalu sa vite dhe
4 nuk kam mujt me i njoft, me i perceptu tash ato figura nëse
5 vërtetë e kam njoft ndonjërin prej tyre apo jo.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ka pasur ndonjë komandant
7 të zonës operative të pranishëm aty, ka qenë prezent ndonjëri
8 prej tyre?

9 PË. S'e besoj. S'e besoj.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Së fundi, dje,
11 z. Bashota ju na konfirmuat se i keni thënë Mbrojtjes së
12 Thaçit në një takim në prill të vitit 2022 - kjo jepet në
13 thonjëza këtu në transkripti tonë - domethënë, ju nuk keni
14 pasur mundësi asnjëherë që të gjeni se kush i kishte ndaluar
15 ose kush i kishte arrestuar dy aktivistët, dy veprimtarët e
16 LDK-së, duke ju referuar këtu Jakup Kastratit dhe Cen Deskut.
17 A është kështu? Domethënë, nuk e keni mësuar asnjëherë se kush
18 nga UÇK-ja mund t'i ketë ndaluar ata, kështu?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në prill të 2022-shit i keni
21 thënë Mbrojtjes së Thaçit që nuk e keni pasur mundësinë që të
22 gjeni se kush e ka marrë z. Kastrati dhe z. Deskun, kush i ka
23 ndaluar këta dy, kështu?

24 PË. Saktë.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni se çfarë

1 keni bërë ekzaktësisht për të zbuluar se çfarë i kishte
2 ndodhur z. Desku dhe z. Kastrati? A keni fol me persona të
3 tjerë apo çfarë keni bërë konkretisht për të zbuluar këtë gjë?
4 PË. Me thënë të drejtën unë personalisht nuk kam mujt me bë
5 diçka. Nuk muj me thënë që kam bë diçka. Kur janë kërkuar nga
6 ma herët nga ndërkombëtarët jam munduar me pyet se a din
7 dikush për fatin, për fatin e tyre dhe realisht nuk kam mujt
8 me marrë asnjë përgjigje nga ata që kam pyet. Jo që kam pyet
9 shumë, shumë vende. Nuk më kujtohet që saktë se kujt i kam
10 thënë, por nuk kemi dit asgjë deri në momentin kur ata, ata
11 janë liruar. Pastaj mbas lirimit të tyre ma unë nuk jam marrë
12 më me këtë çështje.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po jua bëj këtë pyetje
14 sepse, z. Bashota, ju thatë në lidhje me z. Desku, nëse nuk e
15 kam gabim, që ishte skandal që ky person ishte arrestuar dhe
16 ndaluar nga persona të tjerë. Për këtë arsye po jua bëj këtë
17 pyetje se çfarë keni bërë në këtë rast. Ju sa thatë që pas
18 lirimit të tyre ju nuk e keni menduar më këtë çështje.

19 Pra, a keni bërë ju ndonjë gjë pas lirimit të z. Desku
20 dhe z. Kastrati, për shembull, a keni folur me ndonjë prej të
21 akuzuarve, keni bërë ndonjë veprim tjetër, keni bërë ndonjë
22 gjë tjetër për të zbuluar çfarë kishte ndodhur?

23 PË. Jo, jo, se unë nuk kam mujt me fol me këta, se në fakt nuk
24 e di që kanë qenë përgjegjës për arrestimin e tyre asnjëri.

25 Por ju kam gëzu vetëm faktit se Cen Desku është liru dhe është

1 në mesin -- mesin e njerëzve e familjes dhe në mesin tonë. Ai
2 ka qenë vërtetë një njeri shumë i mirë, një veprimtar i
3 dalluar i çështjes kombëtare, një njeri që është rrahur dhe
4 maltratuuar nga regjimi serb në atë kohë si rezultat i
5 aktiviteteve patriotike të tina. Dhe thjesht për mua mbetet
6 gjithmonë një skandal nga kushdo qoftë që është marrë dhe
7 është ndalu ai.

8 Jakupi e kam njoft veç mbas luftës. Dhe të njëjtat
9 përshtypje nga takimi që kam pas me të në një nejt kështu
10 private, kam krijuar përshtypjet më të mira si njeri dhe si
11 personalitet.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Bashota.
13 Nuk kam pyetje tjera për ju.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
15 Mettraux.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
17 Smith.

18 Mirëdita, z. Bashota.

19 PË. Mirëdita.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A jeni ju në gjendje të
21 konfirmoni se ndonjëherë dikur në vitin 1999 ka pasur një
22 drejtor për marrëdhënie me jashtë dhe administratën civile
23 ose G5, dhe se është krijuar një drejtor e tillë në Shtabin e
24 Përgjithshëm të UÇK-së? Jeni në gjendje ta konfirmoni këtë?

25 PË. Kur u bë strukturimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me

1 skicimet që i ka bërë Zyrapi, e di që janë përmendur këtu me
2 G1, G2, G3. Me thënë të drejtën për mu kanë qenë shumë të
3 panjohura si organizim kështu ushtarak se nuk e kam njoft
4 metodat dhe format se si janë këto. Ka pas prej G1 deri në
5 shtatë a tetë. Nuk e di sa G kanë qenë. Po, realisht ka pas,
6 po nuk di saktë nëse vërtetë është kjo që ju po më pyetni.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju formuloj ndryshe
8 pyetjen. A e njihni Ramë Bujën?

9 PË. Po, e njoh.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të konfirmoni se në
11 nëntor të 1998-s ai ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm
12 të UÇK-së?

13 PË. Po.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në cilën drejtori bënte
15 pjesë ai ose me fjalë të tjera, drejtues ose shef i kujt
16 drejtorie ka qenë ai në atë kohë?

17 PË. Nuk e di saktë nëse u quajt drejtorja civile apo
18 drejtorja e pushtetit lokal. Nuk e di saktë. Po diçka e
19 ngjashme.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. A jeni në
21 gjendje të konfirmoni se nëse dhe kur Shtabi i Përgjithshëm ka
22 krijuar një drejtori? Shtabi i Përgjithshëm në të njëjtën kohë
23 ose pak kohë pas kësaj gjëje do ketë miratuar rregullore të
24 ndryshme në mënyrë të tillë që të rregullonte mënyrën sesi do
25 të funksiononin drejtoritë e ndryshme. A mund ta konfirmoni

1 këtë?

2 PË. Po, ka pas diçka të tillë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të konfirmoni
4 gjithashtu që në nivel të zonës nuk ka pasur struktura të
5 tilla si drejtori? A mund ta konfirmoni këtë që nuk ka pasur
6 drejtori në nivel zone?

7 PË. E ke fjalën për këtë drejtorinë civile apo dhe për të
8 gjitha drejtoritë siç ishin në Shtabin e Përgjithshëm, i
9 nderuar Gjyqtar?

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për të dyja, në fakt. Së
11 pari konfirmoni në qoftë se ka pasur drejtori mesa dini ju në
12 nivelin e zonave operative.

13 PË. Jo, s'e besoj.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po si rezultat i takon që
15 nuk ka pasur drejtori as në nivelin civil, apo jo, domethënë,
16 e thatë në mënyrë të tërthortë këtë, në nivel zone në nivelin
17 civil nuk ka pasur drejtori, kështu?

18 PË. Këtë s'e di. Kjo s'më kujtohet nëse ka mujt me pas një
19 shtrirje lokale. Po nuk e di. Ka mundësi. Ka mundësi po nuk e
20 di tërë punën e z. Buja për arsye se ka shkurti, ju e dini, se
21 unë faktikisht unë kam dhënë dorëheqje. Vlatet [Fonetikisht]
22 janë ka qysh nga janari kur kam marrë vesh për qëndrimin e
23 komandantëve të zonave po firmën e kam dhënë në fillim të
24 shkurtit. Po nuk e di saktë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk ka problem. Do t'ju

1 pyes lidhur me disa gjëra që ju thatë për procesin
2 vendimmarrës brenda Shtabit të Përgjithshëm.

3 Përpara një jave, në përgjigje të pyetjeve që ju bëri
4 Prokurori, unë ju kuptova sikur ju u pajtuat me propozimin e
5 bërë që procesi vendimmarrës në Shtab të Përgjithshëm ishte
6 kolektiv në natyrë. Për procesverbal këtë e keni thënë në
7 faqen 229877. A e kam kuptuar drejt këtë, Dëshmitar?
8 PË. Po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtë javë i thatë z.
10 Misetic, Misetic është Avokati i z. Thaçi, se ka pasur raste
11 kur vendimet e Shtabit të Përgjithshëm merreshin pa konsultime
12 të gjithë anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm. A e kam
13 kuptuar drejt këtë, Dëshmitar?

14 PË. Po. Për arsye se nuk është knë shumë relevante për
15 Shtabin e Përgjithshëm në qoftë se dikush mund të mungon për
16 një arsye ose një arsye tjetër në atë takim, me e prit edhe
17 një ditë tjetër me u taku për me marrë një vendim
18 gjithëpërfshirës për arsye se kanë qenë kushte lufte. Dhe
19 realisht kanë mujt me marrë vendime.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Që ta dini se çdo ju pyes
21 po ju them që do ju propozoj disa propozime të cilat janë bërë
22 nga disa persona të caktuar dhe pastaj do ju kërkoj që të
23 komentoni lidhur me këto propozime.

24 Gjëja e parë që dua t'ju pyes është kjo: Në një
25 intervistë të dhënë - dhe do jua jap referencën për një çast -

1 po në një intervistë të dhënë nga z. Rexhep Selimi u përshkrua
2 udhëheqja e Shtabit të Përgjithshëm si "udhëheqje kolektive".
3 Kjo është pjesë e provës P761.5. Pjesa 5, faqja 12.

4 A pajtoheni ju me këtë përshkrim lidhur me mënyrën se si
5 e keni kuptuar që ka funksionuar Shtabi i Përgjithshëm?

6 PË. Kjo s'e besoj se ka mujt me kanë kështu. Tash nuk e kam
7 të shkruar, domethënë, intervistën nuk e kam përpara, i
8 nderuar Gjyqtar, për ato që ka thanë Rexhep Selimi që me u
9 kujtu saktë formën se si e ka përcaktuar.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në këtë rast do i kërkoja
11 Sekretares që të na ndihmojë që të paraqesë provën P761.5, në
12 faqen 12.

13 Në anglisht do të fillojë tek rreshti 10. Hetuesi e pyet
14 Rexhep Selimin si më poshtë:

15 "A ka pasur ndonjë rast kur, për shembull, dikush mund të
16 dilte vullnetar dhe të thoshte 'Unë do kujdesem për këtë?'. A
17 ka thënë Krasniqi, për shembull, 'Do sigurojmë që komandantët
18 e zonës do ta bënë këtë gjë'? Ju lutem më shpjegoni
19 mekanikisht sesi merreshin vendimet për ta trajtuar këtë."

20 Dhe z. Selimi sipas këtij dokumenti thotë si më poshtë:

21 "Në qoftë se nuk keni marrë një panoramë të saktë nga
22 shpjegimi im, do të thotë që jo çdo gjë ka qenë perfekte
23 brenda punës së Shtabit të Përgjithshëm. Nuk duhet të harrojmë
24 që unë përmenda në fillim që udhëheqja jonë ka qenë një
25 udhëheqje kolektive dhe jo udhëheqje e një personi të vetëm."

1 Tani që e keni kontekstin më të plotë, po jua bëj përsëri
2 pyetjen, Dëshmitar. A pajtoheni me përshkrimin e Rexhep
3 Selimit të udhëheqjes së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së si
4 udhëheqje kolektive?

5 PË. I nderuar Gjyqtar, unë nuk e pata në ekran këtë që ma
6 lexuat ju. Unë s'po e shoh dikund.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se
8 mund t'ju ndihmoj, bëhet fjalë për faqen tjetër në versionin
9 në shqip.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, z. Halling.

11 Po tani e shikoni? E gjeni atë pjesën që unë sapo ju
12 lexova? Besoj që është diku nga mesi i faqes, Dëshmitar.

13 PË. Po, tani po e pashë.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni me këtë
15 sugjerim të z. Selimi?

16 PË. Pajtojna me këtë pjesën ku vërtetë në atë periudhë nuk ka
17 qenë gjithçka perfekt në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, por
18 që mundësinë e vendosjes për çështje të caktuara kanë mujt me
19 e marrë edhe ata persona të cilët kanë qenë prezent në një
20 takim, pa marrë parasysh numrit, numrit të anëtarëve të
21 Shtabit të Përgjithshëm sa janë prezent. Gjithsesi në atë kohë
22 janë arsyetuar mungesat për shkak të vështirësive që i kemi
23 pasur për të lëvizur në territorin ku në të shumtën e rasteve
24 kanë qenë të kontrolluara nga forcat serbe.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk besoj se ju përgjigjët

1 pyetjes. Po jua bëj pyetjen për herë të tretë, Dëshmitar. A
2 pajtoheni me atë çfarë ka thënë z. Selimi apo me sugjerimin e
3 z. Selimi se lidershipi ose udhëheqja jua në UÇK ka qenë
4 kolektive, domethënë, udhëheqja ka qenë kolektive? A pajtoheni
5 apo jo me këtë propozim të z. Selimi?

6 PË. Po them, i nderuar Gjyqtar, u mundova me dhënë
7 shpjegimin. Kur thuhet "kolektive", unë jam munduar me sqaru
8 se kolektive e kuptoj edhe me atë sesa pjesëmarrës kanë qenë
9 në takim. Kështu që kështu ka qenë. Por edhe brenda takimit në
10 qoftë se Shtabi i Përgjithshëm, do të thotë, ajo pjesë e
11 shtabit që ka qenë ka pas mundësi me u taku nuk janë kanë të
12 gjithë për një vendimi, shumica ka vendosë për këtë. Dhe
13 shumica dhe ajo pjesa e cila nuk ka kanë për një vendimi të
14 tillë, nuk e ka kontestuar pastaj, nuk ka kundërshtuar.
15 Thjesht është marrë vendim kështu.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptojmë. Të kalojmë tek
17 faqja 15, 1-5 e të njëjtit dokument. Duhet të jetë faqja 15 në
18 versionin në shqip. A mund të kalojmë pak më lart në versionin
19 në anglisht.

20 Z. Bashota, a mund të përpigjeni të gjeni një pyetje në
21 këtë faqe që bëhet nga hetuesi, ku thuhet:

22 "Nuk ka rëndësi në qoftë se një anëtar i Shtabit të
23 Përgjithshëm urdhëron një anëtar tjetër të Shtabit të
24 Përgjithshëm ..."

25 A e gjetët këtë pjesë në shqip?

1 PË. Jo, nuk e kam në monitor.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të kalojmë pak më
3 poshtë në faqe në versionin në shqip?

4 Po tani a e shikoni, Dëshmitar? Dhe në qoftë se nuk e
5 shihni mund të kalojmë tek faqja tjetër, të përpigemi ta
6 gjejmë aty.

7 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, besoj
8 që është në rreshtin 13, të faqes 16.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

10 Atëherë kalojmë tek faqja 16.

11 A e shikoni, lexoni një pyetje ku thuhet që:

12 "Nuk ka rëndësi në qoftë se një anëtar i Shtabit të
13 Përgjithshëm urdhëron një anëtar tjetër të Shtabit të
14 Përgjithshëm që të bëjë një gjë të veçantë, një gjë të caktuar
15 ..."

16 E gjetët? Diku nga mesi i faqes, Dëshmitar.

17 PË. Po, në numër 16 nuk është. Veç pak.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Rreshti 12, 13, Dëshmitar.

19 PË. Ah, 12, 13.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem lexojeni dhe kur
21 të arrini në fund të faqes na e thoni.

22 Të kalojmë pak më në fund të faqes që ta lexojë z.

23 Bashota.

24 PË. Kjo është pyetje po. Kjo është pyetje po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju lexoj versionin në

1 anglisht dhe pastaj do të kërkoj që të kalohet tek faqja
2 tjetër në shqip. Hetuesi thotë që:

3 "Nuk ka rëndësi në qoftë se një anëtar i Shtabit të
4 Përgjithshëm urdhëron një anëtar tjetër të Shtabit të
5 Përgjithshëm të bëjnë një gjë apo është një diskutim kolektiv
6 ndërmjet gjithë personave që janë të barabartë me njëri-
7 tjetrin dhe se si të vijohet. Dhe kjo është ajo mënyrë që ne
8 jemi përpjekur që të kuptojmë. Pra, në qoftë se ka ndryshuar
9 nga një takim në një tjetër ose nga çështje në një tjetër në
10 rregull. Po ndofta ka ndodhur e njëjta gjë edhe më herët."

11 Dhe z. Selimi vazhdon dhe thotë këtë që unë sapo e lexova
12 që:

13 "Ka ndryshuar ndoshta nga një takim te tjetri, nga një
14 çështje tek tjetra. Por do dua të them dhe një herë që vendimi
15 i Shtabit të Përgjithshëm ka qenë vetëm ai vendim i cili është
16 marrë me dakordimin e të gjithëve. Këtë unë e quaj vendim të
17 Shtabit të Përgjithshëm."

18 A e lexoni këtë pjesën këtu, Dëshmitar?

19 PË. Po, po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni me këtë që ka
21 thënë z. Selimi?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mendoj se e thatë
24 megjithatë me fjalët tuaja, a do të thotë kjo që një vendim i
25 Shtabit të Përgjithshëm ka pasqyruar pikëpamjet e të gjithë

1 anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm?

2 PË. Po, patjetër, nëse është marrë si vendim.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju bëj të njëjtën
4 pyetje po në mënyrë tjetër: A ka ndonjë vendim të Shtabit të
5 Përgjithshëm të UÇK-së ose të Shtabit Qendror të UÇK-së që
6 është marrë me të cilin ju nuk pajtoheshit dhe nuk pajtoheni
7 sot, për shembull?

8 PË. Veç është kohë e gjatë dhe nuk muj me e dit saktë nëse ka
9 pas vërtetë naj çështje të caktuar të cilën, të cilën unë
10 personalisht jam nda kështu ose i pakënaqur ose -- se e kam
11 pas mundësinë nëse kam qenë prezent e kam pas mundësinë me i
12 dhënë vërejtjet e mia për çështje të caktuar. Por në qoftë se
13 vërtetë ka vendosë shumica për mu ka qenë e akseptueshme
14 pastaj si vendim. Por që të më kujtohet një rast nuk e di. Nuk
15 e di. Mund të ketë. Mund të ketë, por është distancë kohore që
16 nuk mund të kujtohen këto detale.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dua t'ju bëj një
18 pyetje lidhur me atë çfarë ka thënë Jakup Krasniqi. Do përdor
19 fjalët e tij dhe të njëjtën gjë do ta bëj, pra, do ju bëj të
20 njëjtën pyetje në qoftë se ju pajtoheni me atë çfarë ka thënë
21 ai. Dhe për një moment do ju jap referencën.

22 Atëherë sa i takon Shtabit të Përgjithshëm ose duke folur
23 për Shtabin e Përgjithshëm për punën e tij Jakup Krasniqi e
24 përshkruan punën brenda Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe
25 citoj këtu, si "punë kolektive". Gjithashtu ai flet për një

1 komandë kolektive brenda UÇK-së, pra, Shtabit të Përgjithshëm
2 të UÇK-së.

3 Për procesverbal, kjo jepet në dokumentin U015-8743 që
4 është në faqen 8775 të librit të z. Krasniqi dhe deklaratën që
5 është dhënë për të njëjtën qëllim në provën P1091 dhe P1138 në
6 faqen 9.

7 A pajtoheni me këtë përshkrim të bërë prej z. Krasniqi,
8 përshkrim të cilin ai e ka bërë lidhur me punën e Shtabit të
9 Përgjithshëm si punë kolektive dhe mënyrën e funksionimit të
10 Shtabit të Përgjithshëm si një komandë kolektive? A pajtoheni
11 me këtë, Dëshmitar?

12 PË. I nderuar Gjyqtar, në të vërtetë kemi bërë punë kolektive
13 aty, se gjithsecili me angazhimin e vet, domethënë, detyrat që
14 i ka pas në shtab i ka pas sqaruar aty. Po ka pas autonominë
15 gjithsecili për punën që e ka bërë në angazhimin që e ka pas.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptova. Dua të përpiqem
17 të kuptoj gjithashtu saktësisht se si ka funksionuar kjo
18 praktikë kolektive. Na është thënë këtu - dhe do jap dhe
19 referencën - se mënyra se si funksiononte Shtabi i
20 Përgjithshëm dhe se si komunikoni me njëri-tjetrin ju si
21 kolegë të Shtabit të Përgjithshëm ka qenë horizontale, çka do
22 të thotë ju nuk i jepnit urdhra njëri-tjetrit. Pajtoheni me
23 këtë?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për procesverbal kjo është

1 thënë në materialin që mban numrin SPOE0053380 në faqen 385.

2 Dhe është e z. Selimi.

3 Ju po ashtu keni thënë, besoj dhe më korrigjoni nëse e
4 kam gabim, ju keni thënë se kur ishte e mundur, kur e lejonin
5 rrethanat, dhe e kuptojmë që ka pasur raste përjashtimore,
6 bëhej një konsultim mes anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm
7 përpara se të merrej një vendim i Shtabit të Përgjithshëm,
8 saktë?

9 PË. Po. Do të thotë, për çdo temë që është ngrit janë bërë
10 diskutimet dhe pastaj ka pasu një vendim nëse është ka e
11 nevojshme që të ketë vendimmarrje.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua të shihni një tekst
13 dhe më pas të komentoni. Kjo është diçka që e ka thënë z.
14 Bislum Zyrapi. Referenca për këtë është IT-05087.1 P00427. Që
15 ta kuptoni për çfarë bëhet fjalë.

16 Z. Bashota, është një deklaratë që ka dhënë z. Bislum
17 Zyrapi TPNJ-së.

18 Besoj se shqipja ka të njëjtin numër ERN.

19 E keni në ekran?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen 9 në të
22 dyja gjuhët.

23 Ju lutem lexoni paragrafin 37. Ndërkohë që ju po e shihni
24 unë po lexoj anglishten. Thuhet:

25 "Vendimet lidhur" -- më falni, fillimisht këtu po flet

1 për vitin 1999.

2 Pra, ai ka thënë:

3 "Vendimet lidhur me operacionet do të merreshin pas
4 konsultimeve në një takim sy më sy brenda Shtabit të
5 Përgjithshëm dhe komandantit relevant të zonës."

6 Pastaj ai ka thënë:

7 "Pas marsit", marsi 1999, "u bë e vështirë nëse jo dhe e
8 pamundshme për të pasur takime me komandantët e zonave sy më
9 sy, kështu që diskutimet do të bëheshin përmes telefonit apo
10 përmes komunikimit me radio. Kur ky lloj komunikimi nuk ishte
11 i mundshëm, komandantët e zonave do të kishin autoritet të
12 vepronin duke përdorur diskrecionin e tyre duke informuar
13 Shtabin e Përgjithshëm sa më parë që të ishte e mundshme."

14 Ne e kuptojmë që në një moment në vitin 1999 ju dhatë
15 dorëheqjen dhe u larguat nga Shtabi i Përgjithshëm, po
16 përshkrimi që ka dhënë z. Zyrapi lidhur me procesin e
17 konsultimeve a përkon me përvojën tuaj lidhur me këtë çështje
18 gjatë kohës që keni qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm?
19 PË. Unë nuk e di nëse e kam pas ndonjë përvojë të tillë. Por
20 në rrethana të luftës, Bislam Zyrapi, si shef i shtabit për
21 nevoja të komandantëve të zonave apo për një betejë dikund ka
22 mundur të konsultohet me cilindo prej anëtarëve të Shtabit të
23 Përgjithshëm.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë a po përpigëni të
25 thoni ju që nuk e kontestoni dëshminë e z. Zyrapi lidhur me

1 këtë proces? A duhet ta kuptoj në këtë formë?

2 PË. Po, po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dua t'ju pyes lidhur
4 me procesin e raportimit brenda Shtabit të Përgjithshëm.

5 I lutem Sekretarisë të vendosë në ekran provën materiale
6 me numër P761 dhe Pjesën 4 të kësaj prove.

7 Dëshmitar, për t'ju dhënë kontekstin që ta kuptoni për
8 çfarë bëhet fjalë, kjo është një pjesë e një interviste e z.
9 Rexhep Selimi të cilën ja ka dhënë Prokurorisë këtu në fund të
10 dhjetorit - më falni - në nëntor të 2019-s.

11 Shkojmë ju lutem në faqen 7. Shkojmë më poshtë tek
12 anglishtja, ju lutem. Më lart tek anglishtja, ju lutem. Faqja
13 pararendëse.

14 Në anglisht fillon në rreshtin 21. Besoj që dhe shqipja
15 duhet të jetë tek faqja 6.

16 Ju lutem, z. Dëshmitar, gjeni në shqip një pyetje të
17 hetuesit që thotë:

18 "Dhe supozoj që nëse komandanti i përgjithshëm do të
19 ishte i pranishëm në mbledhje, shefat e drejtorive të ndryshme
20 raportnin ngjarjet brenda drejtorive të tyre."

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thatë po. E keni fjalën që
23 e gjetët në shqip?

24 PË. Që po e shoh. Po, e shof.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë po lexoj anglishten

1 dhe do t'ju bëj pyetje lidhur me këtë. I bëhet pyetje z.
2 Selimi këtu për punën e brendshme të Shtabit të Përgjithshëm
3 dhe se si funksiononte raportimi brenda Shtabit të
4 Përgjithshëm. I është bërë pyetja:

5 "Dhe supozoj nëse komandanti i përgjithshëm ishte i
6 pranishëm në takim, atëherë drejtoritë e drejtorive të
7 ndryshme raportonin ngjarje që binin në kuadrin apo në
8 fushëveprimin e drejtorive të tyre?"

9 Sipas tekstit z. Selimi ka thënë:

10 "Ka shkuar në këtë formë: Në mungesë të komandantit të
11 përgjithshëm dhe për shkak të problematikave praktike ne
12 raportonim" - kalojmë në faqen tjetër - "ne raportonim në
13 mbledhjet e Shtabit të Përgjithshëm. Secili prej nesh
14 raportonte në mbledhjet e Shtabit të Përgjithshëm çfarëdo që
15 gjykonim se duhet të raportonim. Natyra e punës për secilin
16 nga drejtoritë ka qenë e ndryshme. Edhe, sigurisht, që dhe
17 raportimi dallonte nga raportimi i dikujt tjetër.

18 "Nuk ishin thjesht raporte. Ka pasur dhe analiza. Edhe po
19 ashtu vendime të rëndësishme. Kishte analiza dhe informacione.
20 Kishte dhe takime të përbashkëta me komandantët e zonave.
21 Prandaj nuk mund ta specifikoj se cila ka qenë natyra tipike e
22 takimeve të Shtabit të Përgjithshëm.

23 "Sidoqoftë", vazhdon më poshtë, "sidoqoftë drejtorët e
24 drejtorive operative duke qenë këta oficerë nuk mund të jepnin
25 urdhra dhe nuk mund të pranonin urdhra. Në takimet e Shtabit

1 të Përgjithshëm, merreshin vendime të rëndësishme që tashmë i
2 njeh dhe opinionin publik. Përmenda një syresh më herët, më
3 konkretisht emërimin e z. Demaçi si përfaqësues të UÇK-së në
4 Prishtinë dhe vendimi për të marrë pjesë në Konferencën e
5 Rambujesë, marrëveshja për emërimin e komandantëve të zonave
6 dhe marrëveshja mbi emërimin e kryeministrit të Qeverisë së
7 Përkohshme. Këto ishin disa nga vendimet e rëndësishme që ka
8 marrë Shtabi i Përgjithshëm.”

9 Më tej vijon dhe thotë -- z. Bashota, nuk e di e keni
10 gjetur shqipen?

11 Dhe thotë:

12 “Ka pasur debate, diskutime lidhur me vendimet. Dhe
13 natyrisht, kishte mendime të ndryshme. Por në fund respektohej
14 opinionin i përgjithshëm. Kështu ka funksionuar Shtabi i
15 Përgjithshëm si një organ. Shumica e vendimeve ishin vendime
16 kolegjiale.”

17 Z. Bashota, a pajtoheni ju me përshkrimin që ka bërë z.
18 Rexhep Selimi lidhur me punimet e brendshme të Shtabit të
19 Përgjithshëm, me aq sa keni ju dijeni?

20 PË. Po, për afërsisht kështu është. Ky e ka potencuar për disa
21 vendime të cilat janë marrë në gjenerale, si mbledhja e
22 Rambujesë, takimi i delegacionit, përcaktimit të delegacionit
23 për në Rambuje. Po kështu është.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju bëj një propozim të
25 përgjithshëm dhe mund të flasim dhe për hollësitë pas një

1 çasti. A pajtoheni ju me propozimin tim që për një organizatë
2 ushtarake, raportimet nga terreni ose në rastin tuaj nga zona,
3 ishin një aspekt shumë i rëndësishëm i procesit vendimmarrës
4 sepse për të marrë një vendim ju duhet të dinit dhe të
5 kuptonit çfarë po ndodh në terren? Pajtoheni me propozimin
6 tim?

7 PË. Po kjo, po, kështu mund të themi. Por shumë vendime janë,
8 i kanë marrë edhe vetë komandantët e zonave në terren të cilët
9 kanë pas autonominë e veprimit të tyre. Por nëse diçka
10 specifike ka pas, kemi mujt me e bartë atëherë kur kemi pas
11 mundësi me shku. Dhe pse takimet, thashë, e Shtabit të
12 Përgjithshëm kanë qenë shumë të rralla. Dhe jo të gjithë kanë
13 qenë prezent në ato takime për shkak të specifikave dhe të
14 natyrës së rrezikut që kanë mujt, kemi mundur të kemi hasur në
15 terren.

16 Por, nëse është marrë një vendim, me pjesën dërrmuese të
17 këtyre vendimeve është dashtë që edhe nëse s'jemi pajtu
18 thjesht ke mujt me -- shumica ka vendosë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj këtë. Do ta bëj
20 pyetjen në një formë tjetër. A ka pasur raste në dijeni në
21 tuaj kur Shtabi i Përgjithshëm ka marrë një vendim pa u
22 informuar një herë vetë fillimisht sesi ishte situata në
23 terren?

24 PË. S'më kujtohet kjo.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,

1 erdhi ora për pushimin e drekës. Do të largoheni për një orë e
2 gjysëm nga salla. Do rikthehemi në orën 2.30 në sallën e
3 gjyqit. Mos flisni me askënd jashtë sallës së gjyqit për
4 dëshminë tuaj, mund të dilni nga salla.

5 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

6 Z. HALLING: [Përkthim] Kam një pyetje lidhur me
7 dëshmitarin rezervë. Dëshmitari rezervë është në Hagë. Ne
8 mendojmë që dëshmitari do të fillojë e do të përfundoj nesër.
9 Ju gjykoni se dëshmitari rezervë mund të vijë për seancën e
10 tretë dhe të jetë këtu në gatishmëri?

11 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të jetë
13 këtu për çdo rast.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
16 deri në 2.30.

17 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

18 --- Seanca rifillon në orën 14.30

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan,
20 kishit diçka për të thënë?

21 Z. Dixon, më falni.

22 Jo, ti ulu atëherë.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Në fakt dua të bëj një kundërshtim.
24 E ndoqa këshillën tuaj që të mos i bëjmë kundërshtimet në
25 prani të dëshmitarit. Kundërshtimin e kam në lidhje me pistën

1 aktuale të pyetjeve që po bëni, që sipas nesh ju po përpigëni
2 të dilni me përfundimin se Shtabi i Përgjithshëm ka pasur
3 përgjegjësi kolektive, të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë
4 në Shtabin e Përgjithshëm. Që kjo është e ngjashme me
5 qëndrimin që po mban Prokuroria kur flet për ndërmarrjen e
6 përbashkët kriminale. Kjo është një nga arsyet pse
7 kundërshtojmë ne. Pikërisht, mënyra se si po i bëjmë pyetjet.
8 Pyetjet janë sugestionuese, orientuese.

9 Kështu që ju lutem, nëse doni të shtjelloni këto aspekte,
10 edhe sigurisht keni të drejtën tuaj të bëni pyetjet tuaja
11 lidhur me këtë çështje, ju lutem mos i bëni në këtë formë,
12 sepse duket sikur keni dalë me një qëndrim.

13 Dhe për të qenë të drejtë me Mbrojtjen. Nëse përgjegjësia
14 kolektive nuk është në thelb -- më fal, është thelbi i
15 pyetjeve të tuaja, atëherë duhet të përcaktohet kush ka qenë i
16 përfshirë në këto vendime, cili nga të akuzuarit ka qenë i
17 pranishëm, cili nuk ka qenë i pranishëm, në mënyrë që ta
18 sqarojmë çfarë është çështja e përgjegjësive.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e ka
20 ngritur Trupi Gjygues për herë të parë çështjen e
21 vendimmarrjeve kolektive. E kanë ngritur dhe palët e tjera,
22 dhe thjesht po e shtjellojmë më tej, po e eksplorojmë më tej.
23 E rrëzojmë kundërshtimin tuaj.

24 Sillni dëshmitarin.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, z.

2 Bashota, do vazhdojmë me pyetjet e Gjykatësit Mettraux.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëdita, z. Bashota.

4 PË. Mirëdita.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet që përpara

6 se të bënim pushimin, po diskutonim mënyrën e raportimit në

7 Shtabin e Përgjithshëm. Unë ju tregova një fragment të një

8 deklaratë të z. Rexhep Selimi lidhur me këtë.

9 A është e vërtetë që drejtoritë e Shtabit të Përgjithshëm

10 i raportonin Shtabit të Përgjithshëm lidhur me veprimtaritë e

11 tyre?

12 PË. Po, ka pas raste që kanë raportuar, nëse e kanë

13 perceptuar si të nevojshme.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa i takon procesit, si

15 kryhej kjo? Ishte drejtori i drejtorisë që raportonte, apo

16 raportonte ndonjë prej vartësve, apo mund të ndodhte dhe

17 drejtori dhe vartësi? Si ishte procesi?

18 PË. Po në qoftë se drejtori apo ndonjë vartës i drejtorit ka

19 qenë edhe ai anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, varet prej

20 natyrën së punës që ata kanë kry, kanë raportu.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kuptoj. Për shembull, te

22 G2. Shërbimi informativ i raportonte Shtabit të Përgjithshëm,

23 apo jo?

24 PË. Shërbimi informativ nuk e di, se nuk e mbaj mend që ka

25 pas mundësi me qenë në ndonjë mbledhje të Shtabit të

1 Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për shkak të
2 angazhimit dhe lëvizjes që ka ba jashtë Kosovës shefi i
3 shërbimit informativ.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, do t'ju them
5 diçka dhe do t'ju kërkoj të komentoni. Do t'ju tregoj diçka,
6 më saktë. Dhe më pas do t'ju kërkoj të komentoni lidhur me
7 atë. Në anglisht, numri është SPOE000543380, SPOE00053393-ET.
8 Edhe shqipja e ka ndryshe në fakt ERN-në, SPOE00053377.

9 Që ta kuptoni për çfarë bëhet fjalë, ky është një libër
10 me intervista të dhëna, që ia ka dhënë Rexhep Selimi një
11 gazetari me emrin Adriatik Kelmendi. Fillimisht, keni dëgjuar
12 për këtë libër?

13 PË. Jo, i nderuar.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim faqen SPOE00053392,
15 anglishtja. Shqipja më duket se është me numër 16 tek PDF-ja.
16 Faqja 16 nga mesi.

17 E gjeni dot fjalinë që fillon me fjalën:

18 "SHIK-u u krijua nga Qeveria e Përkohshme", "SHIK-u u
19 krijua nga -- ",

20 E gjetët në shqip?

21 PË. Po. Po.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kjo është ajo që ka pyetur
23 z. Kelmendi.

24 Z. Kelmendi: "Në këtë kohë, pasiqë ishte dhe temë e
25 ditëve të fundit, është formuar dhe shërbimi informativ i

1 Kosovës, SHIK-u.”

2 Z. Selimi: “Jo. Një gjë duhet të kemi parasysh. Në këtë
3 kohë nuk ka pasur shërbim informativ, UÇK-ja nuk ka pasur
4 SHIK. UÇK-ja ka pasur departamentin e vet, G2-shin.
5 Departament për inteligjencë ushtarake me detyrat e saj të
6 përcaktuara si në secilën ushtri. Ashtu siç ka secila ushtri
7 drejtorinë e saj të inteligjencës edhe UÇK-ja e ka pasur
8 drejtorinë e saj të inteligjencës.”

9 Po ndaloj këtu për një sekondë. A është e saktë deri në
10 këtë pikë ajo që ka thënë z. Selimi?

11 PË. Unë e di se ka qenë shef i shërbimit informativ, por nuk
12 e kam të kjartë nëse vërtet ka qenë shef i G2. Thashë, këto
13 emërtimet që i bëmë G1, G2, s’i kam pas të njohura dhe nuk i
14 kam dit detyrat, përshkrimin e detyrave të tyre, por kjo po më
15 duket që është një, është një paqartësi rreth saj. Aq sa unë,
16 me aq sa më kujtohet mu.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Çfarë është paqartësi,
18 cila është paqartësia këtu?

19 PË. Nuk e di -- se nuk e di nëse Kadri Veseli ka qenë shefi i
20 G2.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] S’kam shkuar ende aty. Do
22 t’ju lexoj pjesën tjetër më vonë. Por, për pjesën që ju lexova
23 deri tani, a ka ndonjë aspekt me të cilin nuk pajtoheni?

24 PË. Për pjesën që është deri tani, në këtë paragraf, mund të
25 jetë kështu. Mund të jetë kështu.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Vijon më tej intervista.

2 Z. Kelmendi pyet: "Kush e ka udhëhequr Drejtorinë?"

3 Rexhep Selimi: "E ka udhëhequr Kadri Veseli që nga
4 momenti, që nga themelimi i kësaj strukture, deri me
5 themelimin e SHIK-ut, ku është transferuar si shef i SHIK-ut.
6 Por po flas për atë se UÇK-ja nuk ka pasur SHIK. Ajo ka pasur
7 G2, ka pas drejtori për informim, drejtori të inteligjencës
8 ashtu siç e ka secila ushtri në botë."

9 Tani, nga sa kuptova unë nga përgjigjja juaj, ju nuk keni
10 ditur nëse vërtet ka qenë Kadri Veseli drejtori i G2, saktë?
11 PË. Saktë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më tej vijon.

13 Z. Kelmendi: "Kujt i ka dhënë informata ky shërbim?"

14 Z. Rexhep Selimi përgjigjet si në vijim:

15 "Ashtu siç ndodh në çdo strukturë komanduese, edhe
16 drejtorja e inteligjencës së UÇK-së e kodifikuar si G2 (në çdo
17 ushtri kështu është ...) i raportonte drejtpërdrejt Shtabit
18 të Përgjithshëm të UÇK-së ose unë do ta quaj këtë trup
19 udhëheqës."

20 A mund ta konfirmoni apo e kontestoni këtë që ka dhënë z.
21 Selimi për raportimin e drejtorisë së inteligjencës pranë
22 Shtabit të Përgjithshëm ku keni qenë dhe ju anëtar?

23 PË. Kjo vetë nëse ka ndodh domethënë mbas, mbas largimit tim
24 prej Shtabit të Përgjithshëm, se nuk e di a janë, a janë
25 strukturu prapë këto drejtori. Nuk e di ma a është, çfarë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 109

1 është bo me to, por gjatë kohës time unë nuk i di që G2, ka
2 raportu në Shtabin e Përgjithshëm e s'më kujtohet nëse vërtet
3 ka qenë edhe Kadri Veseli ai i cili ka mujt me raportu në
4 Shtab të Përgjithshëm. Se po e ndërlihd me z. Veseli.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, kur merrnit vendime,
6 vendime operative, kush ua jepte ju informatat lidhur me
7 situatën në terren. E në veçanti, ku ishin të pozicionuar
8 trupat serbë?

9 PË. Po kryesisht bëhej përmes raporteve që kishte krijuar
10 Bislir Zyrapi me komandantët e zonave. Ai u informonte nga
11 ata, dhe merrte një pasqyrë ma reale rreth pozicionimit të
12 forcave serbe.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju sot në dëshminë
14 tuaj po thoni që të paktën kur keni qenë ju i pranishëm me
15 anëtarët e tjerë të Shtabit të Përgjithshëm, nuk keni marrë
16 informata prej drejtorisë së inteligjencës, saktë?

17 PË. Informata, raporte nuk kemi pas me Shtab të Përgjithshëm,
18 me aq, kur jam kanë unë. S'e besoj, nuk më kujtohet që vërtetë
19 të ketë qenë një raport i tillë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani, dua të të pyes për
21 kronologjinë e përfshirjes suaj në UÇK dhe në Shtabin e
22 Përgjithshëm sepse nuk jam tërësisht i qartë për këtë, dhe dua
23 t'ju jap mundësinë ta sqaroni për ne.

24 Kur thatë që fillimisht jeni -- pra, më falni. Kur jeni
25 kyçur fillimisht në UÇK ju?

1 PË. Unë personalisht jam kyçur në UÇK që nga fillimi i
2 përpjekjeve tona të para, domethënë, në kohën kur kanë qenë
3 grupet, disa grupe të organizuara në, për vetëmbrojtjen në
4 Kosovë. Një prej atyre që kam qenë i përndjekur nga regjimi
5 serb kam qenë edhe unë, edhe realisht nga aty më, jam
6 armatosur dhe nuk kam pranuar që të bi i gjallë në duart e
7 policisë dhe, në atë kohë policia serbe.

8 Në kohën kur kemi qenë në studime, kemi qenë në, u
9 organizonte shkollimi paralel, jo më në objektet shkollore,
10 por nëpër objektet e improvizuara, ne në Prishtinë, dhe aty
11 jemi takuar dhe kemi --

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju ndaloj një çast,
13 z. Bashota. Nuk e bëra unë pyetjen siç duhet në fakt. E doja
14 të dija në fakt në cilin vit jeni përfshirë për herë të parë
15 me UÇK-në?

16 PË. 1994.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nga 1994, 1995, 1996,
18 1997, ju jeni përfshirë në një sërë operacionesh dhe
19 veprimtarish në emër të UÇK-së, apo jo?

20 PË. Ne në atë kohë kemi pas për detyrë që të merremi
21 kryesisht me unifikimin e grupeve, të cilat ishin të shtrira
22 në Kosovë. Me krijimin e logjistikës për ta kjo ka qenë edhe
23 pjesë dhe detyrë e imja, me krijimin e mundësive për të ardh
24 deri tek armatosja, zakonisht u organizojshim në atë kohë
25 rrugëtime për Shqipëri. Kjo ka qenë detyra ime.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju po ashtu keni
2 organizuar edhe udhëtime drejt Maqedonisë për të marrë armë,
3 apo jo?

4 PË. Nji herë kemi qenë në, kujtoj, në Maqedoni.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kjo ka qenë ai udhëtimi me
6 Nait Hasanin dhe Rexhep Selimin?

7 PË. Nuk e di nëse ka qenë Rexhep Selimi me neve, por, po,
8 mund të jetë. Mund të jetë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ky rast ka qenë në 1996-n?

10 PË. Nuk e di, nuk e di vitin saktë, por nuk ka qenë nji
11 udhëtim që, nuk jemi hi në territorin e Maqedonisë realisht.
12 Armët na i kanë qit ma herët dikush të cilin emrin e tij nuk e
13 di.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me sa kam kuptuar unë, dhe
15 më korrigjoni, ju lutem, nëse e kam kuptuar gabim, ju keni
16 thënë që jeni një, keni qenë një nga personat e parë që jeni
17 kyçur në Shtabin Qendror të UÇK-së. E kam kuptuar saktë?

18 PË. Ndër të parët, jo i pari.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, një nga personat e
20 parë, ndër të parët. E kujtoj këtë. Të tjerët që kujtoni ju
21 janë pesë personat që përmendët sot më herët.

22 PË. Po, saktë

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj se ju e shpjeguat
24 kur e keni dhënë intervistën, deklaratën tuaj TPNJ-së në atë
25 kohë, gjithmonë më korrigjoni nëse nuk e kam kuptuar në saktë,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 112

1 por keni thënë që një nga gjërat -- një nga gjërat e para që
2 keni bërë me këtë grup personash, është të zgjidhnit
3 komandantin tuaj, Azem Sylën, saktë?

4 PË. Po, saktë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kam kuptuar unë saktë,
6 pra, që në atë kohë ju keni qenë anëtar i Drejtorisë Politike
7 të UÇK-së?

8 PË. Jo, në atë kohë nuk ka pas drejtori politike të UÇK-së.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj se sot në mëngjes ju
10 thatë se kyçja juaj në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, me aq
11 sa ju kujtohet ju, ka ndodhur nga fundi i 1996 dhe fillimi i
12 1997, kështu? Apo ka ndodhur edhe më përpara?

13 PË. Jo, jo. Hyrja ime në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës është
14 si Shtab Qendror në 1994.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë,
16 faleminderit.

17 Do t'ju tregoj diçka që besoj se ua treguan dje. Është
18 prova materiale me numër P847.

19 A ju kujtohet që ju treguan këtë intervistë të Azem
20 Sylës? Ju kujtohet që ua treguan këtë intervistë në një nga
21 pyetjet e palëve?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë dua të shohim bashkë
24 të njëjtën pjesë që ju treguan gjatë pyetjeve. Është faqja
25 SITF00243001. Më duket se në anglisht është faqja tjetër,

1 pavarësisht se ka të njëjtin numër ERN-je.

2 Dëshmitar, ju lutem, gjeni në artikull pyetjen:

3 "Kur krijohet Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dhe cilët
4 kanë qenë anëtarët e parë të tij?"

5 Dhe është kolona e parë e ekranit tuaj. Kolona e parë në
6 të majtë të ekranit, është pyetja:

7 "Kur krijohet Shtabi i Përgjithshëm dhe cilët kanë qenë
8 anëtarët e parë të tij?"

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtë pjesë ua treguan një
11 herë, por unë do ta lexoj sërish.

12 "Ata që vendosën shpalljen, ata ishin dhe Shtabi i
13 Përgjithshëm i UÇK-së. Ai përbëhej nga Azem Syla, Sokol
14 Bashota, Kadri Veseli, Xheladin Gashi, Ali Ahmeti, Xhavit
15 Haliti, Hashim Thaçi, Rexhep Selimi, Lahi Ibrahimimi, dhe një
16 shok tjetër."

17 Kam disa pyetje për këtë tani. A pajtoheni ju se sipas
18 kësaj që thotë z. Azem Syla, komandanti juaj, ish-komandanti
19 juaj, kanë qenë dhjetë anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm:
20 nëntë i thotë me emra, dhe personin e dhjetë nuk -- personit
21 të dhjetë nuk ia thotë emrin. Pajtoheni me këtë që thotë ai?

22 PË. Jo, nuk pajtohem i nderuar. Nëse, nëse përgjigjja e tij
23 ka qenë për krejt luftën e UÇK-së, mund të pajtohem. Për arsye
24 se këta kanë qenë anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm. Por në
25 qoftë se i referohet ndonjë periudhe të mahershme kohore, pos

1 atyre gjashtë personave që i përmenda ma herët, nuk ka pas të
2 tjerë. Pse e ka bërë këtë Azem Syla mbas luftës, unë nuk e di.
3 Nuk e di arsyet e tijna.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë do të vazhdoj me
5 pjesën tjetër të dokumentit. Këtu flitet dhe për vitin kur
6 bëhet fjalë. Por, e konfirmoni më së paku që këtu janë
7 përmendur nëntë emra, dhe një person i dhjetë të cilit nuk ia
8 ka thënë emrin. Pra, nëse i numëroni, a dalin nëntë plus një?
9 PË. Po, nëntë plus një.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nëse do krahasonim
11 tani listën tuaj të emrave me listën e tij, dy personat që nuk
12 rezultojnë janë Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, dhe personi,
13 apo kolegu që nuk ka emër. Pajtoheni?

14 PË. Po, kështu është.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj se ju është bërë --

16 PË. Nëse ban --

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Patjetër.

18 PË. Nëse merret si e mirëqenë ajo që porosia e Xheladin
19 Gashit që ka thanë për Rexhep Selimin dhe Lahi Brahimin, por
20 që realisht ata nuk kanë mujt me e ushtru, as me u taku për
21 këtë çështje komanduese në atë kohë, por thashë përbërja e
22 Shtabit Qendror në atë kohë, janë kanë gjashtë persona. Nuk e
23 di këtë Azem Syla, mendoj se do ta ketë një intervistë të
24 llojit të pasluftës, të cilat bëheshin me kohë, ma tepër për
25 të ekzagjeruar dhe për t'u munduar me paraqit protagonizëm,

1 mendoj, se sa diçka që është reale.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju pyes kështu,
3 atëherë: Kjo listë, a korrespondon me gjendjen e Shtabit të
4 Përgjithshëm në fund të 1996-s dhe në fillim të 1997-s, ose në
5 1997-n, në përgjithësi?

6 PË. Nuk mund ta them këtë për arsye se thashë Rexhep Selimi
7 dhe Lahi Brahimaj për ta nuk është marrë marrë një vendim i
8 saktë. Një vendim që të pranohen përpos porosisë apo udhëzimit
9 që ka bo Xheladin Gashi, të cilën s'kemi mujt me implementu.
10 Thashë, Shtabi i Përgjithshëm në atë periudhë kohore ka qenë i
11 shkapërderdhur. Nuk e di se sa ka funksionu në Shqipëri, për
12 arsye se pjesa dërrmuese që është këtu janë jashtë Kosove dhe
13 nuk e di sa ka funksionu atje, por në atë kohë luftimet e
14 mëdha --

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndalojmë këtu. Meqë
16 përmendët Rexhep Selimin, dhe unë po ju pyes për atë atëherë.
17 Sipas jush, në cilin vit është bërë anëtar i Shtabit të
18 Përgjithshëm ose Shtabit Qendror z. Rexhep Selimi?

19 PË. Përpjeka e parë ka qenë në takimin që kemi bë në fshatin
20 Negrovç, për t'u mobilizuar si shtab. Dhe --

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndaloni ju lutem. Që të
22 jem i qartë. Nëse do të thuhej se Rexhep Selimi është bërë
23 anëtar i Shtabit Qendror në një moment në 1997, ju e
24 kundërshtoni këtë?

25 PË. Po për mendimin tim, nuk mund të bëhet një anëtar i

1 Shtabit të Përgjithshëm me gjithë ato kompetenca me një porosi
2 goje për të cilën unë kam qenë edhe teknikisht i pamundur me
3 realizu. Për arsye se kam qenë veç unë në Kosovë në atë kohë,
4 dhe nuk ka pas njerëz të tjerë me të cilët të kem mujt me
5 diskutu këtë çështje për pranimin e tyre të Rexhepit, Rexhep
6 Selimit dhe Lahi Brahimajt në Shtabin e Përgjithshëm. Shtabi i
7 Përgjithshëm funksional po flas. Në qoftë se mund t'i
8 referohem vetëm kështu në letër, po.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Po Jakup
10 Krasniqi? Me sa keni ju dijeni, z. Krasniqi kur është bërë
11 anëtar i Shtabit Qendror?

12 PË. Jakup Krasniqi nuk ka qenë asnjherë anëtar i Shtabit
13 Qendror.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim në ekran provën
15 materiale me numër P793.

16 Kjo është për t'ju dhënë kontekstin, z. Bashota. Është
17 deklarata e TPNJ-së që ka dhënë z. Jakup Krasniqi, më 24 maj
18 2007.

19 Shkojmë në faqen tjetër. Të shohim paragrafin 4 në të
20 dyja versionet.

21 Kjo është ajo që ka thënë z. Jakup Krasniqi përpara TPNJ-
22 së, Prokurorit të TPNJ-së, më saktë. Në paragrafin 4.

23 "Pas lirimit nga burgu në 1991 u mora me aktivitete
24 politike. Isha pjesëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në
25 Drenoc, që ishte një lëvizje alternative demokratike. Iu

1 bashkëngjita UÇK-së në mars të 1993 dhe u bëra pjesëtar i
2 Shtabit të Përgjithshëm në fund të 1996-s. U caktova
3 zyrtarisht si zëdhënës i UÇK-së në 11 qershor 1998.”

4 Pas këtij paragrafi, vetë z. Krasniqi ka thënë se është
5 bërë pjesëtar i Shtabit të Përgjithshëm në fund të 1996-s. E
6 lexuat?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni ndonjë koment
9 lidhur me këtë?

10 PË. Unë nuk po muj me kuptu drejt saktë se për çfarë Shtabi
11 të Përgjithshëm e ka pas fjalën këtu Jakup Krasniqi. Por në
12 shtab ose në përbërjen që unë e di, në Kosovë atëherë nuk ka
13 pas mundësi kurrë në asnjë mbledhje, në asnjë takim, me kanë
14 z. Krasniqi si anëtar i Shtabit Qendror. Në qoftë se Jakup
15 Krasniqi është njohur se ka qenë në lidhje --

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ju ndaloj këtu,
17 Dëshmitar. Ju po kontestoni atë çfarë po thotë z. Krasniqi
18 këtu që ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm në fund të
19 1996-s, këtë po thoni?

20 PË. Deshta me sqaru pak në vazhdimin e fjalës sime, që u
21 ndërpreva. Z. Krasniqi ka mujt me u marrë me pjesë të luftës
22 dhe me njerëz të luftës, për arsye se njihen raportet e mira
23 që ka pas Jakup Krasniqi me komandantin legjendar Adem
24 Jashari. Dhe në qoftë se iu ka referu kësaj, kësaj periudhe,
25 kësaj pjese, është diçka tjetër. Unë personalisht nuk e di se

1 Jakup Krasniqi ka qenë anëtar i Shtabit Qendror në këtë
2 periudhë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares të
4 paraqesë në ekran provën P794.

5 Sa për informacionin tuaj, Dëshmitar, ky procesverbali i
6 dëshmisë së dhënë nga Jakup Krasniqi, ose një pjesë e
7 procesverbalit të dëshmisë së dhënë nga Jakup Krasniqi,
8 përpara TPNJ-së, ku ka dhënë dëshmi në çështjen Limaj dhe të
9 tjerët, më datë 10 shkurt 2005.

10 Do i kërkoja Sekretares të kalonim në faqen 3305 të
11 transkriptit.

12 Ju kërkoj ndjesë, Dëshmitar, se nuk kemi version në shqip
13 të këtij dokumenti.

14 Faleminderit. Kalojmë pak më poshtë në faqe.

15 Z. Krasniqi pyetet një pyetje sa i takon përfshirjes së
16 tij me UÇK-në:

17 "Tani", në rreshtin 12, atij i bëhet kjo pyetje, "a erdhi
18 një kohë, erdhi një moment që ju u bëtë anëtar i Shtabit të
19 Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

20 "PË. Po.

21 "PY. Kur ka ndodhur kjo?

22 "PË. Mund të ketë qenë në fund të vitit 1996 dhe
23 fillimin e vitit 1997."

24 A e kuptoni, Dëshmitar?

25 PË. Po, e kuptoj.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përsëri po ju pyes, a keni
2 ndonjë shpjegim se pse z. Krasniqi e ka pranuar vetë nën betim
3 se ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm në kohën kur ju
4 vetë keni qenë anëtar i atij grupi? Ende po na thoni që ju nuk
5 jeni në dijeni që ai ka qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm
6 në atë kohë, këtë po thoni?

7 PË. Po, këtë, i nderuar Gjyqtar.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Krasniqi ka dhënë
9 dëshmi gjithashtu në një tjetër çështje, prapë edhe në këtë
10 rast nuk kemi version në shqip të dokumentit, por do t'jua
11 lexoj. Ai thotë se në atë kohë, dhe për pak do ju jap
12 referencën. Pra, edhe një herë, ai thotë që në atë kohë ka
13 pasur pak a shumë ose për rreth dhjetë persona anëtarë të
14 Shtabit të Përgjithshëm, domethënë, kjo është e ngjashme me
15 atë çka ka thënë z. Syla. Bëhet fjalë për dëshminë e 30 majit
16 2007 në faqen 5426. Ai thotë, do ishte mirë që të lexohej i
17 gjithë citimi që ka thënë ai, në mënyrë të tillë që më pas të
18 komentoni. Ai thotë:

19 "... gjatë kësaj periudhe kohe Shtabi i Përgjithshëm
20 përbëhej mesatarisht nga dhjetë persona, por jo të gjithë ata
21 e njihnin njëri-tjetrin sepse disa prej tyre vepronin në
22 mënyrë të paligjshme, disa në mënyrë të ligjshme, disa prej
23 tyre ishin jashtë shteti."

24 Unë mbase do ishte mirë t'jua bëj kështu pyetjen: A është
25 e mundur, z. Bashota, që mund të ketë pasur anëtarë të Shtabit

1 të Përgjithshëm ose Shtabit Qendror, emër me të cilin njihej
2 Shtabi i Përgjithshëm në atë kohë, pra a mund të ketë pasur
3 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm për të cilët ju nuk keni
4 qenë në dijeni?

5 PË. Përderisa më drejtohet pyetja "a mund", unë nuk muj me
6 paragjyku këtë. Ka mundësi. Por unë, me dijeninë time unë nuk
7 e di që Jakup Krasniqi ka qenë anëtar i Shtabit Qendror në atë
8 kohë. Kjo ajo saktë sa unë e di.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni me propozimin,
10 ose sugjerimin se nëse dikush e dinte se kush ishin anëtarët e
11 Shtabit Qendror asokohe, këtë informacion do ta kishte pasur
12 Azem Syla, sepse Azem Syla ishte komandanti i atij grupi? A
13 pajtoheni me këtë parashtrim, me këtë qëndrim, Dëshmitar?

14 PË. Po, pajtohem.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjatë periudhës së kohës
16 nga 1995 deri në mars të 1998, ju keni dhënë dëshmi dhe keni
17 thënë që keni pasur kontakte me anëtarë të Shtabit Qendror. E
18 kam fjalën me anëtarë të tjerë të Shtabit Qendror. A është e
19 saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjatë kësaj periudhe keni
22 pasur disa kontakte ose takime gjithashtu edhe me Hashim
23 Thaçin, a është e saktë kjo?

24 PË. Edhe një herë për vitin, se nuk e mbajta mend, i nderuar
25 Gjykatës?

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në periudhën nga janari
2 1995 deri në mars të 1998-s. A ju kujtohet, keni pasur
3 kontakte me Hashim Thaçi gjatë kësaj periudhe?
4 PË. Po, në mars të 1998-s, e di, në q'atë periudhë kohore të
5 1998-s, e di se kanë hy në Kosovë Hashim Thaçi dhe Kadri
6 Veseli. Nuk e di a janë hi bashkë apo ndaras, por kujtoj se në
7 pranverën e vitit 1998, janë hyrë në Kosovë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përpara hyrjes së z. Thaçi
9 dhe z. Veseli, që dëgjuam që mund të ketë ndodhur dikur nga
10 marsi i 1998, në muajt dhe vitet përpara kësaj periudhe, a
11 keni pasur kontakt me z. Thaçi?

12 PË. Nuk më kujtohet saktë, nuk më kujtohet saktë, nuk e di a
13 ka qenë 1998, se z. Thaçi ka lëviz shpesh për Shqipëri. Por
14 mbaj mend se një herë, më ka ardh një herë, domethënë, me
15 armatim në Kosovë, dhe e kam takuar një herë më duket. Por nuk
16 jam i saktë se në cilin vit.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares të
18 paraqesë në ekran provën P739.6. Të kalojmë pak më poshtë në
19 faqen në versionin në anglisht?

20 Të vazhdojmë me faqen tjetër.

21 Thjesht sa për t'ju dhënë ca kontekst, Dëshmitar. Dua
22 t'ju them që kjo është një intervistë e cila është dhënë nga
23 z. Thaçi, është dhënë për Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

24 Në versionin në anglisht fillon në rreshtin 4, tek faqja
25 që kemi përpara, ndërkohë që në versionin në shqip fillon --

1 do t'jua lexoj fjalinë. Është një pyetje këtu që thotë që:

2 "Kjo më bën, më drejton në pyetjen tjetër, më ngre
3 pyetjen time të radhës. Që ka të bëjë me periudhën kur keni
4 qenë në Zvicër. A komunikoni ju me persona të tjerë të UÇK-së
5 gjatë kësaj periudhe kohe?"

6 A e shikoni këtë pyetje në versionin në shqip, Dëshmitar?
7 Mendoj që në shqip është, fillon nga rreshti 15.

8 Përgjigja që jep z. Thaçi është:

9 "Po.

10 "PY. Me kë keni komunikuar më rregullisht?

11 "PË. Kam komunikuar me Lahi Brahimaj. Kam komunikuar me
12 Sokol Bashotën. Kryesisht këta të dy.

13 "Si keni komunikuar?"

14 Ai thotë:

15 "Kanë ardh në Shqipëri, por edhe unë jam futur në Kosovë
16 në mënyrë të paligjshme.

17 "PY. Gjatë kësaj kohe ju keni qenë në Zvicër, apo jo?

18 "PË. Kam hy përmes bjeshkëve të Shqipërisë.

19 "PY. Sa shpesh komunikoni me z. Bashota ose Brahimaj
20 gjatë kohës që keni qenë në Zvicër?

21 "PË. Një herë ose dy në vit.

22 "PY. Një herë apo dy herë në vit?

23 "PË. Po, sepse me telefon s'kam komunikuar kurrë me ta."

24 Kjo është pjesë e dëshmisë së dhënë nga z. Thaçi. A po
25 përkon kjo me atë çka ju kujtohet ju lidhur me kontaktin që

1 keni pasur me të gjatë kësaj periudhe?

2 PË. Unë thashë më duket vetëm një herë e kam takuar kur është
3 ardh prej Shqipërie, thashë, me armatim. Dhe nuk e di se me
4 kënd tjetër ka qenë, por vetëm atëherë e kam taku në këtë
5 periudhë. Ma shumë nuk më kujtohet.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk ju kujtohet asgjë
7 tjetër atëherë? A ju kujtohet që keni pasur kontakte në 1996-n
8 edhe me Jakup Krasniqin? Ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

9 PË. Me z. Krasniqi prej ardhjes nga burgu jemi takuar me
10 dhjetëra herë, për arsye se ka qenë një personalitet i cili
11 jemi takuar për çështje të tjera politike, të kohës. Por ka
12 qenë një aktivist edhe i angazhuar në Lidhjen Demokratike të
13 Kosovës. Janë mbajtur shumë tribuna politike në atë kohë, shumë
14 takime të ndryshme, edhe shoqnore. Kam qenë në odën, në
15 shtëpinë e tij. Ka qenë në shtëpinë time. Dhe jemi takuar disa
16 herë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani do kaloj te diçka
18 tjetër të cilën në fakt e keni diskutuar, besoj, me të gjitha
19 palët, e keni diskutuar gjithashtu edhe me kolegun tim, me
20 Gjykatësin Barthe. Bëhet fjalë për komunikatat e Shtabit
21 Qendror të UÇK-së dhe më pas të Shtabit të Përgjithshëm të
22 UÇK-së. A ju kujtohen këto pyetje, Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një gjë që ju thatë
25 përpara një javë në përgjigje të një pyetjeje, dhe për

1 procesverbal kjo jepet në faqen 22975, është që këto
2 komunikata, dhe këtu e kishit fjalën për komunikatat nga
3 janari i 1997-s, për shembull komunikata e 28 dhe 29, ju keni
4 thënë që këto komunikata janë shkruar jashtë shtetit dhe
5 Xheladin Gashi dhe Nait Hasani ishin personat që kryesisht
6 janë marrë me to. A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?
7 PË. Po, besoj kështu ka qenë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mendoj se e thatë, dhe më
9 korrigjo në qoftë se s'e kam kuptuar drejt, mendoj se e thatë
10 që Xheladin Gashi ka qenë me ju në Kosovë në 1996-n dhe në
11 1997-n, deri në kohën kur Nait Hasani u arrestua kur Xheladin
12 Gashi pastaj shkoi për në Shqipëri. A e kam kuptuar drejt
13 këtë, Dëshmitar?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares
16 tani të shikojmë dokumentin SPOE -- kërkoj ndjesë, se kam
17 problem me mikrofonin.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do i kërkoja
19 përkthyesve që të lirojnë kanalën.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull tani. Do i
21 kërkoja Sekretarisë që të paraqesë në ekran dokumentin
22 SPOE00053380 deri në SPOE00053393.

23 Ajo çfarë keni këtu përpara, Dëshmitar, është e ngjashme
24 me dokumentin që pamë përpara pak kohe. Është një libër me
25 intervista të Rexhep Selimit me një gazetar që quhet Adriatik

1 Kelmendi.

2 Do i kërkoja Sekretares të kalojmë tani në faqen
3 SPOE00053383. Numri i faqes në shqip është i njëjti.

4 Dëshmitar, në shqip, në gjuhën tuaj, kjo është tek kolona
5 në të majtë, që është faqja 62. Aty është një pyetje:

6 "Kush ka marrë pjesë në sulme dhe kush e hartoi
7 komunikatën?"

8 E shikoni këtë pjesën, Dëshmitar, drejt fundit të faqes?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përgjigja ashtu siç është
11 regjistruar, pra, përgjigjja e Rexhep Selimit është kjo:

12 "Unë nuk kam pas fare lidhje me komunikatën."

13 Për kontekst, dua t'ju them që Rexhep Selimi po flet për
14 komunikatën e parë, për komunikatën 11 që ishte publikuar.

15 Ai thotë se:

16 "Me komunikatën nuk jam marrë, sepse ka qenë Nait Hasani
17 personi i cili është përzgjedhur prej nesh si personi i duhur,
18 kompetenti që të merrej me komunikatat e UÇK-së dhe
19 komunikimin me jashtë, me botën e jashtme, në kuptimin e
20 komunikimit me organizata të ndryshme jashtë vendit, siç kanë
21 qenë organizata të ndryshme përfshirë dhe ato politike ilegale
22 në atë kohë, siç kanë qenë Lëvizja Popullore e Kosovës dhe
23 organizma të tjerë dhe patriotët që kanë vepruar jashtë
24 Kosovës, të cilët me aktivitetet e veta kanë dëshmuar se
25 vërtet janë patriotë.

1 Sipas z. Selimi, këtu personi i cili është marrë me
2 komunikatat e Shtabit Qendror në atë kohë, ka qenë Nait
3 Hasani. Dhe kjo është në pajtim me atë çfarë ju na thatë neve.
4 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Na keni thënë që në janar
7 ose në shkurt të vitit 1997, Nait Hasani u arrestua. A është e
8 saktë kjo?

9 PË. Po, drejt.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ai është arrestuar në
11 Kosovë, apo jo?

12 PË. Po, patjetër. Në Prishtinë më duket.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po. Pra, kur ai kujdesej
14 ose merrej me komunikatat, Nait Hasani këtë gjë e bënte në
15 Kosovë, i takon, jo jashtë shtetit, kështu?

16 PË. Po, ai ka qenë prezent në Kosovë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një prej gjërave të tjera
18 që thotë z. Selimi në përgjigje të tij, dhe në goftë se është
19 e nevojshme të lexoni pjesën, jua tregoj, ai thotë se deri në
20 arrestimin e vet Nait Hasani ishte personi i cili mbante
21 kontakte me LPK-në nga Kosova.

22 A jeni në dijeni të kësaj, Dëshmitar?

23 PË. Me LPK-në nuk e di, por me Azem Sylën që ka mbajtur
24 kontakte, e di. Se ma ka thanë vetë. Më duket edhe me Ali
25 Ahmetin.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju pajtoheni apo jo, se në
2 qoftë se dikush i përgatit këto komunikata, për këtë person
3 është e rëndësishme që të jetë në kontakt me LPK-në sepse këto
4 janë deklarata të cilat janë publikuar në Zërin e Kosovës, që
5 ishte organi përfaqësues i LPK-së? Domethënë, që ekzistonte
6 nevoja për bashkërendim midis të dy këtyre anëve. A pajtoheni
7 me mua?

8 PË. Unë e kam potencu edhe këtu. Në kohën e LPK-së kam qenë
9 vetëm aktivist në nivel lokal në komunën e Klinës. Ndërsa nuk
10 e njoh, domethënë, përbërjen e kryesisë qendrore të LPK-së.
11 Por në qoftë se Azem Syla, Xhavit Haliti, ata kanë pas ndonjë
12 lidhje me LPK-në në atë kohë, apo ndonjë përgjegjësi, i bie
13 kjo çka po thoni ju.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pas kësaj date kur
15 arrestohet Nait Hasani në Prishtinë ose në afërsi të
16 Prishtinës në janar ose në shkurt të vitit 1997, sipas jush,
17 kush i ka marrë përgjegjësitë për trajtimin ose për marrjen me
18 komunikatat e Shtabit Qendror?

19 PË. Unë thashë nuk -- e ka marrë një vendim nga dikush. Por
20 kryesisht me këto në fillim thashë kanë qenë Naiti me Xheladin
21 Gashin, dhe me siguri ka vazhdu prapë Xheladin Gashi që të
22 merret me to. Nuk e di a e ka bo në komunikim, e bashkërendim
23 edhe me Azem Sylën, se ata kanë qenë edhe bashkë -- domethënë,
24 më duket janë shumë afër me vendbanim, apo çfarë forme. Por
25 kryesisht është marrë pastaj Xheladin Gashi. Domethënë që i ka

1 shkruar ai, por e ka ditun të paktën për burimin e tyre nëse
2 ato kanë qenë vërtet prej të dedikuara në emrat e Shtabit
3 Qendror.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndërkohë që Xheladin Gashi
5 vdiq, apo jo?

6 PË. Xheladin Gashi ka vdek pas luftës.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet kur ka
8 vdekur?

9 PË. Viti i saktë nuk e di, por dikund ndoshta rreth 2010, nuk
10 di. Di që ka vdek prej një sëmundje të kancerit.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të ketë ndodhur
12 edhe më herët se sa kaq, ndoshta në 2005, ka të ngjarë?

13 PË. Vitet po shkojnë shpejt, me thanë të drejtën, nuk, dhe
14 elementin kohë edhe po e humbim shpesh. Nuk muj me dit saktë,
15 por ajo dihet botërisht, se kur saktë, s'po e di.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Do i lutesha
17 Sekretares të paraqesë në ekran tani provën P761 në Pjesën 7
18 të saj.

19 Përsëri, në mënyrë të tillë që t'ju jap kontekst, dua
20 t'ju them që bëhet fjalë për procesverbalin e një interviste
21 që është dhënë nga z. Rexhep Selimi për Zyrën e Prokurorisë
22 këtu, për Prokurorin e Specializuar, më datë 13 nëntor të
23 vitit 2019. Do i kërkoja Sekretares që në versionin në
24 anglisht të kalojmë tek faqja 7. Në faqen 5, ju kërkoj ndjesë.
25 Në anglisht, në faqen 5. Ndërkohë që në shqip besoj që është

1 faqja 6.

2 Në versionin anglisht mund të fillojmë në rreshtin 7. Z.
3 Selimi i bëhet një pyetje, pra pyetja lidhet me komunikatën e
4 parë, komunikata 11 e Shtabit Qendror. A mund ta gjeni këtë në
5 versionin në shqip, Dëshmitar? Mendoj se është në faqen 6, në
6 versionin në shqip, diku nga fillimi i faqes, në mos gabohem.
7 PË. Kjo ka vetëm një përgjigje në pyetjet. S'e di është ma
8 poshtë apo jo.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të kalojmë tek një
10 faqe më përpara. Po këtu a e shikoni, domethënë, është një
11 pyetje që thotë:

12 "Le të fillojmë me komunikatën e parë ..."

13 Është në rreshtin 17, Dëshmitar.

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E shikon, e gjetët?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në versionin në anglisht
18 thuhet si më poshtë:

19 "PY. Të fillojmë me komunikatën e parë.

20 "PË. Ka qenë koha e formimit të UÇK-së. Komunikata e
21 parë ka përmendur për herë të parë emrin e UÇK-së. E di që
22 s'ka qenë numri si numri 1 as numri 2, por nuk më kujtohet
23 saktësisht se cili ka qenë numri i komunikatës."

24 Do ndaloj këtu për një moment. A ju kujtohet se
25 komunikata e parë e Shtabit Qendror të UÇK-së mbante numrin

1 11, ka qenë komunikata 11? Ju kujtohet kjo tani, Dëshmitar?

2 PË. Jo, nuk më kujtohet saktë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Z. Selimi
4 vazhdon më tej dhe thotë.

5 "Dhe që prej fillimit deri në kur ka qenë, kur ka shkuar,
6 kur ka rënë në burg, personi që është marrë me komunikatat ka
7 qenë një prej shokët tanë, Nait Hasani i cili është arrestuar
8 në vitin 1997, në janar, më saktësisht."

9 A e shikoni këtë, dhe a e konfirmoni që e gjetët, e
10 lexuat kështu, Dëshmitar?

11 PË. Po, po.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Vazhdon më tej:

13 "PY. Po pastaj?

14 "PË. Kujtoj që me komunikatat një prej personave që janë
15 marrë me komunikatat në vitin 1997 është Sokol Bashota. Por,
16 komunikatat janë hartuar kryesisht në një prej organeve të
17 Lëvizjes Popullore të Kosovës të quajtur Zëri i Kosovës. Në
18 prill të vitit 1998, ne kemi emëruar zyrtarisht zëdhënës i
19 cili është marrë më pas me komunikatat dhe me paraqitjen,
20 paraqitjet e para publike nëpër televizione, i cili ka qenë
21 Jakup Krasniqi."

22 Më tej, z. Selimi vazhdon:

23 "Ndërkohë i ndihmuar, i suportuar dhe nga Hashim Thaçi, i
24 cili ka pasur detyrë pak më vonë të komunikimit me opinionin.
25 E kështu ka vazhduar deri në fund për afërsisht", vazhdojmë tek

1 faja tjetër në anglisht. "Se cilën komunikatë e ka hartuar
2 njëri, dhe se cilën tjetri nuk mund ta them se nuk e di këtë
3 gjë."

4 "Besoj ta dhashë një pasqyrë reale të kësaj."

5 Përpara se sa t'ju bëj pyetjen, Dëshmitar, do kaloj tek
6 një tjetër pjesë e intervistës që kemi përpara, në faqen 17 në
7 versionin në anglisht. Ndërkohë versioni në shqip besoj se
8 duhet të jetë në faqen 18. 1-8.

9 Dëshmitar, a mund të gjeni një paragraf, një pjesë në
10 versionin në shqip, mendoj që duhet të jetë diku nga mesi i
11 tekstit. Duhet të jetë diku në rreshtin 7, ku z. Selimi thotë:

12 "Kam identifikuar periudhën kohore dhe personat të cilët
13 janë marrë me këto ..."

14 Nuk e di e gjeni në këtë paragraf këtë që sapo ju lexova?

15 PË. Po, po.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë, z. Selimi ka
17 thënë si më poshtë:

18 "Unë i identifikova periudhat kohore dhe njerëzit që janë
19 marrë me këtë, por dua të përsëris dhe një herë deri në rënien
20 e tij në burg, përgjegjës për këto komunikata nga brenda ka
21 qenë Nait Hasani. Atë e ka zëvendësuar Sokol Bashota gjatë
22 1997. Megjithatë, nga prill i vitit 1998, e pothuajse deri në
23 fund kanë qenë pastaj dy persona, ose dy burime, që janë marrë
24 drejtpërdrejt me këtë punë: zëdhënësi ose shefi i drejtorisë
25 së departamentit për informacion publik.

1 "PY. Ky ka qenë z. Krasniqi dhe z. Thaçi?

2 "PË. Po. Nuk më kujtohet askush tjetër që të jetë marrë
3 me komunikatat përveç këtyre dy personave."

4 Do filloj me sugjerimin që ka dhënë z. Selimi, që në
5 vitin 1997 keni qenë ju personalisht, Dëshmitar, personi që
6 është marrë me komunikatat. A keni një koment lidhur me këtë
7 propozim të tij ose pohim të tij me këtë qëndrim të tij?

8 PË. Po, patjetër, i nderuar gjyqtar. Unë prapë po e përsëris
9 se asnjë komunikatë unë nuk e kam shkruar. Unë nuk e di prej
10 nga kjo ide e z. Selimi për të përgjigjur kështu, por unë po
11 them dhe një herë, asnjëherë s'kam shkru asnjë komunikatë. Me
12 pas shkru ndonjë komunikatë për opinion unë e kisha pranuar
13 patjetër, për arsye se ato janë opinione të, komunikata, nuk
14 është asgjë që është kontestuse në këto komunikata, por
15 thjesht nuk kam shkru, nuk kam shkru.

16 Ishte hyrja aty pak si konfuz, një rresht thotë "është
17 marrë Sokol Bashota, më duket se është marrë", dhe në rreshtin
18 tjetër thotë që, "janë hartuar komunikatat në Zërin e
19 Kosovës". Unë nuk e di tash se cila është e vërteta. Por unë
20 nuk kam shkru komunikata. Nuk muj e marr atë rol --

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndaloni një çast, ju
22 lutem. Do t'jua bëj pyetjen në këtë formë, po ju jap
23 alternativa dhe ju mund të komentoni.

24 E lëmë mënjanë çështjen a i keni hartuar ju apo jo këto
25 komunikata. Në 1997, a keni pasur ndonjë farë roli, çdo lloj

1 roli, në përgatitjen, shpërndarjen, botimin e ndonjë prej
2 komunikatave të Shtabit të Përgjithshëm?

3 PË. Jo.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A propozoni ju -- më
5 falni, a pajtoheni ju me propozimin se në 1997-n, dhe na e
6 keni thënë dhe më përpara, ju dhe z. Rexhep Selimi, keni qenë
7 të vetmit anëtarë të Shtabit Qendror të pranishëm në Kosovë,
8 vetë në Kosovë, saktë?

9 PË. Por jo në një vend. Kemi qenë në vende të ndryshme.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni ndonjë arsye për të
11 besuar se z. Selimi do ta thoshte diçka që nuk do të ishte e
12 vërtetë? Me fjalë të tjera a keni ndonjë shpjegim pse e ka
13 thënë këtë z. Selimi?

14 PË. Po ndonjëherë po nis ajo nga vetja personalisht, që këtë
15 elementin e distancës kohore shpeshherë edhe mund të
16 ngatërrohem me këto, duke pasur informacione më, mbas luftës,
17 për periudhën e luftës, të informuar nga sektorë dhe elemente
18 të ndryshme kështu. Krijon përshtypjen se në ndërrijen e tij
19 është fut kjo. Sikurse po ndij qetash prej vetes time se shumë
20 raste nganjëherë ngatërrohem për tek këto elemente të caktuara
21 të cilat s'i kemi dhanë shumë randësi. Por elementi kohë,
22 përndryshe unë nuk, nuk e di ndonjë arsye tjetër.

23 Por unë po them edhe një herë po e citoj veten, se kurrë
24 nuk kam shkru komunikata të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të
25 cilat komunikata janë botuar pastaj në medime të ndryshme.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim provën materiale
2 P739, Pjesën 5. Në anglisht faqja 5, dhe në shqip besoj se
3 është faqja 7.

4 Dëshmitar, dokumenti që do të shohim në ekran është
5 procesverbal i një interviste apo teksti i një intervistës që
6 ka dhënë z. Hashim Thaçi për Zyrën e Prokurorit të
7 Specializuar, më 30 janar 2020. Në anglisht unë do të filloj
8 të lexoj në rreshtin 16. Ndërsa në shqip duhet të jetë faqja
9 7, drejt fundit të faqes.

10 Është një pyetje që i bëhet z. Thaçi. Unë po e lexoj:

11 "Sa u përket komunikatave të autorizuara, kush ka qenë
12 përgjegjës për këto në 1996?"

13 A e gjetët diçka të ngjashme tek shqipja?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja është kështu. Në
16 rreshtin 4.

17 "Në lidhje me komunikatat e autorizuara, të themi, kush
18 ka qenë përgjegjës për këto, të themi në 1996-n?"

19 "PË. Në 1996-n?"

20 "PY. Po.

21 "Jashar Salihu."

22 Kjo është përgjigja e z. Thaçi.

23 Fillimisht, a mund të na tregoni kush është Jashar

24 Salihu, nëse e dini, kuptohet.

25 PË. Për Jashar Salinë kam dëgjuar vetëm pas luftës. Më duket

1 se ka qenë, është, ka qenë në fondin e "Vendlindja Thërret" në
2 Perëndim, por nuk kam ndonjë informacion më të zgjeruar të
3 punëve, të angazhimit të tij.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Që ta kemi të qartë këtë
5 për procesverbal, dhe më korrigjoni në qoftë se e kam gabim,
6 Jashar Salihu ka qenë kryetar i fondit Vendlindja Thërret?
7 PË. Nuk e di këtë. S'e di si -- ka qenë i angazhuar. Kështu
8 është thanë.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja e
10 radhës që i bëhet z. Thaçi është kjo:

11 "A ka pas Nait Hasani ndonjë rol?

12 "PË. Po, se ka qenë përgjegjës. Ka qenë udhëheqës i
13 shtabit operativ në Kosovë.

14 "PY. Në 1996-n?

15 "PË. Po. Se është arrestuar në janar 1997."

16 Ndërkohë kalojmë tek faqja tek anglishtja.

17 "PY. Që i paraprin pyetjes sime të ardhshme. Pas
18 arrestimit të z. Hasani në janar të 1997-s, kush ishte
19 përgjegjës që të merrej me komunikatat?

20 "PË. Të them të drejtën, unë në atë kohë kam qenë në
21 Zvicër dhe saktësisht nuk e di. Por përgjegjësia ka mbetur në
22 atë kohë e angazhimeve operative të Sokol Bashotës, por me
23 theks, por me theks të theksuar Xheladin Gashi."

24 Z. Thaçi këtu thotë se nuk e di saktësisht, por thotë që
25 këto funksione i kanë ushtruar dy persona, ju dhe Xheladin

1 Gashi. Keni ndonjë koment në lidhje me këtë?

2 PË. Po në Kosovë mbas arrestimit të Naitit, [E padëgjueshme]
3 në një periudhë të shkurtër kemi qenë në Kosovë vetëm unë dhe
4 Xheladin Gashi. Por për komunikata unë nuk jam marrë me to. Po
5 e përsëris që të satën herë, kryesisht ka qenë Nait Hasani dhe
6 Xheladin Gashi.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A doni të na shpjegoni pse
8 dhe z. Rexhep Selimi dhe z. Thaçi kur u është bërë pyetje kanë
9 thënë se ju keni qenë një ndër personat përgjegjës për
10 komunikatat? Keni diçka për të thënë lidhur me këtë?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
12 të duhet të largoheni për një çast nga salla.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Më falni, mund të konsultohem një
14 çast me klientin dhe më pas do të doja të thoja diçka. Kam
15 nevojë të konsultohem dhe të them diçka.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Klienti dhe unë do të thonim të
18 njëjtën gjë në fakt. Është e drejtë që nëse ia bëjmë këtë
19 pyetje dëshmitarit, t'i tregohet shprehimisht ajo që është
20 thënë edhe t'i lexojmë komunikatën përkatëse. Në fund të faqes
21 i është bërë një pyetje konkrete, dhe thotë:

22 "Të supozoj", thotë, "nuk e di".

23 Tregojani të qartë të plotë transkriptin. Faleminderit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Silleni
25 sërish dëshmitarin.

1 [Dëshmitari vijon dëshminë]

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Bashota, do t'ua lexoj
3 dhe një pjesë tjetër të transkriptit që është në faqen e parë.
4 Nëse nuk e gjeni në gjuhën shqipe na thoni, por është në faqen
5 e duhur më duket. Është një paragraf këtu që nuk na, nuk mund
6 ta lexoj, nuk do ta lexoj, pastaj është një pyetje nga
7 hetuesi, rreshti 13:

8 "Të lëvizim një çikë më tutje më vonë, në 1997-n. Ju
9 përmendët, ju thatë që Sokol Bashota ka pasur të bëjë me
10 komunikatat?"

11 Përgjigja e z. Thaçi ka qenë:

12 "Supozoj. Por për Xheladin Gashin e di saktë."

13 Tani unë do t'ju bëj pyetjen. Do t'jua bëj pyetjen dhe
14 një herë tani. Pasi u lexova këtë pjesë, a keni ndonjë koment
15 apo diçka për të thënë, pse edhe z. Selimi -- pse dhe z.
16 Selimi ka thënë që ju keni qenë përgjegjës për komunikatat,
17 por edhe z. Thaçi beson -- beson që mund të jeni, mund të keni
18 qenë ju përgjegjës? A keni diçka për të thënë në lidhje me
19 këtë siç është shprehur këtu në tekst?

20 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Besojmë se ka një problem
22 përkthimi që mbase dëshmitari s'po e kupton, lidhur me
23 pozicionin e z. Thaçi. Besoj se ka një problem tek përkthimi
24 me shkrim.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po jua bëj pyetjen më të

1 përgjithshme atëherë. Atëherë po e bëj pyetjen unë në vija më
2 të përgjithshme, Dëshmitar.

3 A mund të keni një shpjegim ju pse persona që ishin pjesë
4 e udhëheqjes së UÇK-së ose kanë thënë ose kanë supozuar që ju
5 personalisht dhe mbase dhe Xheladin Gashi keni qenë përgjegjës
6 për komunikatat në 1997-n nga momenti i arrestimit të Nait
7 Hasanit e deri në emërimin e Jakup Krasniqit në prill të 1999
8 -- 1998, nga Shtabi i Përgjithshëm?

9 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

10 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po vazhdojmë.
12 Mund të bëni pyetje plotësuese ju vetë më vonë kur të keni
13 radhën.

14 Do ta përsërisim dhe një herë pyetjen, Dëshmitar. Po jua
15 bëj dhe një herë pyetjen në vija të përgjithshme, në terma të
16 përgjithshëm.

17 Unë thashë kështu: A keni një shpjegim pse persona që
18 ishin pjesë e udhëheqjes së UÇK-së ose kanë thënë ose kanë
19 supozuar që ju personalisht edhe Xheladin Gashi mund të keni
20 qenë përgjegjës, pra, keni qenë përgjegjës për komunikatat në
21 1997-n nga momenti i arrestimit të Nait Hasanit deri në
22 emërimin e Jakup Krasniqit në prill të 1998-s, nga Shtabi i
23 Përgjithshëm? Pra, pse ose e kanë thënë ose kanë supozuar?
24 PË. Tash, i nderuar Gjyqtar, mu po më kërkohet me hamendësu
25 se çfarë ka dashur me thanë këta, por unë mendoj se shumë

1 relevante është ato çka i them unë, në kuptimin se këtu është
2 fjala për vetën e parë njëjës, dhe për ato që ai di. Këto i
3 them edhe jam shumë i vetëdijshëm që po i them nën betim. Unë
4 nuk i kam shkru komunikatat as të parën dhe as të fundit. Deri
5 tek e fundit. Prandaj supozimet që kanë dhanë këta as nuk e di
6 arsyet, por një mund të jetë një arsye, për vetë faktin që kam
7 qenë në Kosovë, i vetmi prej anëtarëve të Shtabit Qendror që
8 ka mbet në Kosovë. Ndoshta iu kanë referu kësaj, referu
9 kësajna. Por që kam shkru unë komunikata, kjo s'është e
10 vërtetë kurrë.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Para një çasti ju bëra
12 pyetje për lidhjet që është thënë se ka pasur Nait Hasani me
13 LPK-në dhe nëse këto lidhje ishin relevante për lëshimin e
14 komunikatave. A ju kujtohen pyetjet që ju bëra në lidhje me
15 këtë?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjatë kohës suaj në
18 Kosovë, gjatë kohës që keni qëndruar në Kosovë, dhe keni qenë
19 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, ju personalisht a keni
20 mbajtur kontakte me LPK-në gjatë kohës që keni qenë në terren?
21 PË. Me LPK-në, jo. Në Kosovë s'ka pas LPK në atë kohë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Nuk isha
23 i qartë. Me LPK-në kur LPK-ja ishte jashtë, por ju vetë gjatë
24 kohës që ishit në Kosovë a keni mbajtur kontakte me anëtarë të
25 LPK-së që ishin në shtetet e tjera?

1 PË. Jo.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim materialin që ka
3 numër ERN 078019-TR-AT [Sipas përkthimit]. Na intereson Pjesa
4 3 e këtij materiali. Në anglisht është faqja 17. 1-7. Shqipja
5 është faqja 16. Besoj se është diku në krye të faqes.

6 Z. Halling, preferoni që ta bëj këtë pyetje në seancë të
7 mbyllur?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Në këto rrethana mund ta bëni
9 pyetjen në seancë të hapur.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

11 Atëherë, do t'ju jap kontekstin fillimisht, Dëshmitar. Ky
12 është teksti i një interviste që ka bërë Zyra e Prokurorit të
13 Specializuar, pra ZPS-ja shkurt, me Ali Ahmetin më 2 shtator
14 2020. E kuptuat për çfarë bëhet fjalë?

15 PË. Po.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Anglishtja është në
17 rreshtin 3, besoj. Në shqip duhet të jetë po ashtu në krye:

18 "Okej", fillon, "ajo që po përpigem të kuptoj është ky
19 stafi operativ qendror fillimisht përbëhej nga grupe të
20 ndryshme personash."

21 Është tek 5, tek rreshti i shqipes.

22 "Atëherë ky stafi i qendrës operative ka qenë i përbërë
23 nga grupe të ndryshme personash."

24 E gjetët?

25 PË. Po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ajo që ka thënë Ali
2 Ahmeti është si në vijim:

3 "Një grup ka qenë i përbërë nga komandantë që kanë qenë
4 në terren, këta janë personat emrat e të cilëve i përmenda.
5 Dhe grupi tjetër që kanë përbërë këtë staf kanë qenë grupi
6 Xheladin Gashin, Sokol Bashotën dhe Nait Hasanin. Që kanë pas
7 lidhje të drejtpërdrejtë me LPK-në jashtë vendit. A është e
8 saktë?

9 "A është e saktë?

10 "Është e saktë. Që ka pas lidhje. I kam takuar diku në
11 1993 ose 1994, i kam takuar në Shqipëri."

12 Tani do t'ju bëj unë pyetjen time. Në vitet e para, 1993,
13 1994, e në vijim, a keni pasur lidhje pra, me LPK-në?

14 PË. Unë nuk e di nëse Azem Syla, Xhavit Haliti edhe Ali
15 Ahmeti kanë pasur rol në kryesinë e Lëvizjes Popullore të
16 Kosovës. Në qoftë se ai iu ka referuar takimit që kemi pas me
17 ta, mund të themi se po. Por unë nuk i kam takuar ata si
18 anëtar i LPK-së, por thjesht si persona të cilët kemi dashur
19 që të bëjmë organizimin dhe unifikimin e grupeve të armatosura
20 në Kosovë. Unë nuk i di pozicionet e tyre në LPK. Edhe me
21 thanë të drejtën, si anëtarë të Lëvizjes Popullore të Kosovës
22 nuk kisha shku me i taku, me rreziku, me shku unë nëpër male e
23 me i taku ata në Shqipëri. Thjesht.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Selimi, z. Rexhep
25 Selimi, po ashtu ka thënë dhe do t'ju jap referencën, ka thënë

1 që:

2 "Sokol Bashota po ashtu ka pasur kontakte me LPK-në për
3 një periudhë kohore. Kontaktet me jashtë vendit nuk ishin
4 shumë të kushtueshme [Sipas përkthimit]."

5 Referenca për këtë është SITF00242993 në faqen 7, për ata
6 që duan ta shohin.

7 Pra, a ju kujtohet, pra, në këtë periudhë kohore, a mund
8 ta konfirmoni që në 1994, 1995, 1997, keni pasur kontakte me
9 anëtarët e LPK-së që ishin jashtë vendit?

10 PË. Vetëm nëse iu ka referu Azem Sylës e Xhavit Halitit, mund
11 të jetë kështu. Por jo si, se unë e kam dit për pozicionin e
12 tyre në LPK.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju po ashtu në këtë
14 periudhë kohore, po ju propozoj unë, po ju them unë, dhe do ju
15 tregoj dhe dokumentin nëse është nevoja. Pra, në këtë periudhë
16 kohore keni pasur kontakte dhe me Zërin e Kosovës, po apo jo?

17 PË. Për cilën kohore mendon? Me Zërin e Kosovës veç
18 intervistë kur kam dhanë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jam veçanërisht i
20 interesuar për vitin 1997. Në 1997-n, a keni pasur kontakte me
21 Zërin e Kosovës?

22 PË. Unë nuk kam pas kontakte, nuk kam pas të drejtpërdrejta,
23 kështu, por vetëm me një gazetar, apo një punëtor të kësaj
24 gazete i cili është interesuar me marrë një intervistë nga
25 unë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mbulonte kjo periudhën e
2 1997, zotëri?

3 PË. Ka mundësi.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për të qenë i drejtë me
5 ju, do t'ju tregoj deklaratën në fjalë dhe do t'ju kërkoj të
6 komentoni lidhur me të.

7 Ju lutem të vendosni në ekran provën me numër 761.10.
8 Anglishtja duhet të jetë në faqen 18, ndërsa shqipja në faqen
9 19, drejt fundit.

10 Për t'ju orientuar fillimisht, ky thjesht është vazhdimi
11 i intervistës që ka dhënë z. Rexhep Selimi për ZPS-në. Do t'ju
12 tregoj dy paragrafë, ose dy fragmente, dhe do t'ju kërkoj të
13 komentoni.

14 Shqipja fillon qysh në fillim. Shqipja -- më falni,
15 anglishtja fillon në fillim, shqipja drejt fundit.

16 Kërkoni një pyetje ku thuhet me fjalë të përgjithshme:

17 "Po ju na e përmendët ne, besoj se dje, se z. Sokol
18 Bashota mori përsipër ..."

19 Tek rreshti 20, është pyetja.

20 "Por ju dje na thatë ne që z. Sokol Bashota e mori
21 përsipër shkrimin dhe lëshimin ..."

22 E gjetët?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përgjigja që ka dhënë z.
25 Selimi është si në vijim:

1 "Po e saktësoj, po e saktësoj. Është marrë, jo e mori
2 përsipër.

3 "PY. Nga e dini ju këtë?

4 "PË. Supozoj.

5 "PY. Pra nuk e dini?"

6 Ai thotë:

7 "Por personi i vetëm që ka pasur kontakte me personat
8 jashtë shtetit dhe me LPK-në në Zvicër ka qenë pikërisht ai."
9 E ka fjalën për ju.

10 Shkojmë në faqen 19, në të njëjtën intervistë, dhe faqja
11 20 për shqipen. Në shqip duhet të jetë në fund, mbase drejt
12 fundit të faqes. Anglishtja është rreshti 10.

13 Z. Selimi thotë këtu:

14 "Në 1997-n, lidhjet me LPK-në, përfshirë Zërin e Kosovës
15 janë mbajtur vetëm nga një person, dhe ky person ishte Sokol
16 Bashota."

17 Ajo që ka thënë, që pretendon z. Selimi këtu a është e
18 vërtetë sipas jush?

19 PË. Jo, nuk është e vërtetë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pjesa e fundit që dua të
21 trajtoj me ju ka lidhje me nofkën tuaj ose me kodin që është
22 përdorur për ju. Dëshmitar, a jeni njohur me një numër ju
23 ndryshe?

24 PË. Po, për komunikime në radio kur i kemi pas. Kryesisht
25 kemi përdorur numra.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Cili ka qenë numri juaj?

2 PË. Numri 11.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë po ua them në këtë
4 formë. Ju e njihni Nuhi Bytyqin, e dini kush është?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ai ka sugjeruar në një
7 libër që ka vendosur se numrat që merrnin disa, përdornin disa
8 nga anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm u ishin dhënë sipas
9 rendit kur ishin kyçur në UÇK, apo sipas radhës së kyçjes në
10 UÇK. Me sa keni ju dijeni, a është e saktë kjo?

11 PË. S'është e saktë. Nuk ka mujt me dit Nuhi Bytyqi formën se
12 si janë dhanë këto numra edhe as kush është kyç i pari ai dyti
13 në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nuhi Bytyqi ka
14 ardh ma vonë, është marrë me kronikat e luftës, edhe ka mujt
15 me i përcjell zonat e ndryshme të --

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, atëherë, si e morët ju
17 këtë numër konkret?

18 PË. Thjesht nuk e di as kush e ka ba këtë, veç e di që është
19 ba një renditje [E padëgjueshme]. Ky atë numër, ai atë numër,
20 vetëm sa për identifikim. Ka pas numër edhe ma të vogël se sa
21 10 e më të madh se 10. Nuk e di saktë është, saktë se kush sa
22 ka pas, por kështu janë kanë. Nuk ka pas ndonji rregull rreth
23 numrave për shkak se këto janë kanë thjesht numra për
24 përdorimin e, në radiolidhje.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra ju po thoni që janë

1 thjesht rastësorë, rastësisht?

2 PË. Krejt rastësisht janë, po.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, kush ua ka dhënë këto
4 numra, po thoni ju?

5 PË. Nuk e mbaj mend. Nuk e mbaj mend, të them të drejtën, por
6 kur e kemi pas mundësinë me u pajis me radiolidhje dhe për
7 nevojat e komunikimit që mos me ra në gjurmë kështu, janë
8 marrë këta numra thjesht pa pas një qëllim të caktum. Thjesht
9 nuk, me pas kanë ashtu, ndoshta kishim pas preferenca të
10 numrave, por jo nuk ka pas ndonji rëndësi kjo.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Këto ishin
12 pyetjet e mia. Faleminderit z. Bashota.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
14 Gaynor.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
16 Smith.

17 Dhe mirëdita, Dëshmitar. Unë kam pyetje për katër tema.
18 Tema e parë lidhet me anëtarësimin e Jakup Krasniqit në
19 Shtabin e Përgjithshëm.

20 Kur ju ka intervistuar Prokurori i TPNJ-së, në mars të
21 2006-s, bëhet fjalë tani për provën P1870.1, në faqet 8 edhe
22 9, ju kanë bërë disa pyetje lidhur me këtë. Ju u përgjigjët se
23 ju vetë kishit qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm i
24 Drejtorisë Politike, dhe ju është bërë pyetja:

25 "Në atë kohë sa anëtarë keni qenë? Bëhet fjalë për vitin

1 1997.”

2 Ju jeni përgjigjur:

3 “Mund të kenë qenë shtatë ose tetë, por nuk jam
4 plotësisht i sigurt.”

5 “PY. A ju kujtohen, ju kujtohet se kush kanë qenë këta
6 persona?”

7 Dhe ju keni thënë që:

8 “Ka qenë Jakup Krasniqi.”

9 Dhe vazhduat edhe dhatë edhe emrat e disa personave të
10 tjerë.

11 Pra, a ju kujtohet që e keni thënë këtë në 2006?

12 PË. Nuk po më kujtohet saktë. Me e pas pas në transkript
13 ndoshta e kisha kriju një pasqyrë pak ma reale për ato që kam
14 thanë. S’po them që s’i kam thanë, por ka mundësi. Por jo për
15 Jakupin që është kyç në 1997, në 1996, a.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Për hir të kohës, më duhet
17 të kaloj. E kemi transkriptin, por duhet ta kaloj këtë.

18 Pyetja e dytë është ofrimi i shërbimit -- më falni,
19 shërbimi, ofrimi i shërbimeve -- zbulimit për Shtabin e
20 Përgjithshëm, dhënia e informacioneve të zbulimit për Shtabin
21 e Përgjithshëm.

22 Në të njëjtën intervistë ju keni thënë:

23 “Kemi pasur vërejtje për zonën e Dukagjinit sepse atje
24 ishte Tahir Zema. Në bazë të shërbimit të inteligjencës që
25 kishim ne në UÇK, ishim informuar që ai më herët ka qenë

1 trafikant droge dhe ishte dënuar në vitet e mëparshme, në të
2 shkuarën.”

3 Dhe më pas keni thënë -- ju është bërë një pyetje:

4 “Kur e keni marrë këtë informacion që Tahir Zemaj ka
5 marrë rolin e Ramush Haradinaj, kur e morët ju këtë
6 informacion -- a ju kujtohet se si mbërriti ky informacion në
7 Shtabin e Përgjithshëm?”

8 Përgjigjja juaj:

9 “Ju thashë që na erdhi nga persona në shërbimin e
10 inteligjencës.”

11 Tani pyetja që kam unë për ju është kjo: Çfarë ishte ky
12 shërbim inteligjence që i jepte informacione Shtabit të
13 Përgjithshëm?

14 PË. I nderuar Gjyqtar. Në notë e kam përcaktuar këtë se
15 thjesht ato kanë qenë persona të cilët unë i kam hamendësuar
16 si persona të shërbimit inteligjent. Nuk kam pas ndonjë vizion
17 të kuartë se çka është shërbimi inteligjent, nuk e kam as sot
18 me thanë të drejtën se nuk e njoh natyrën e punës së tyre. Por
19 thjesht kam hamendësuar për shkak të rëndësisë së
20 informacionit çfarë e dha ai në atë kohë, që më është duk
21 tepër interesant, e kam thanë se janë persona të cilët i kam
22 hamendësuar ose si persona të shërbimit inteligjent.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ata jepnin informacion
24 zbulimi ose informativ te Shtabi i Përgjithshëm, ia përcillni
25 këtë informacion, apo jo, Dëshmitar?

1 PË. Jo, mua personalisht ma kanë thanë. Por që nuk e di
2 emrat, nuk i njoh, dhe s'i kam njoft. Ia kam hamendësu.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do të kaloj tek tema tjetër.

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
5 dëshiroj që të bëj një korrigjim për transkriptin. Është në
6 faqen 124, rreshtat 5 deri në 6:

7 "... unë nuk e thashë atë, por jo për Jakupin."

8 Këtu lexohet, thuhet:

9 "Mendoj që ai është kyçur në 1997-n, ose në 1996-n."

10 Mendoj që duhet të shkruhet kështu:

11 "Nuk mendoj që ai është kyçur ..."

12 Do të doja që të bëhej ky korrigjim, sepse këtë tha
13 dëshmitari.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Dëshmitar, do të
15 vazhdojmë me një tjetër temë. Ju kam dëgjuar disa herë që keni
16 thënë që ju personalisht nuk i keni shkruar komunikatat. Dua
17 që ta shtjelloj më temë këtë temë. Në provën gjyqësore tanimë
18 të pranuar, P1870.1, në faqen 10, pyetja që ju bëhet është
19 kjo:

20 "Në këtë kohë, çfarë keni bërë ju? Le të themi gjatë
21 1997, çfarë pune keni bërë? Keni planifikuar për konfliktet e
22 ardhme --"

23 Dhe përgjigja që ju jepni është që:

24 "Ne kemi qenë kryesisht të përfshirë në shkrimin e
25 komunikatave ..."

1 Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, tani është kjo: Kur thua
2 "ne" për kë e ke pas fjalën?

3 PË. E kam pas fjalën për komplet përbërjen. Për njerëz të
4 tjerë, jo që i kam ba unë, por thjesht si strukturë. Se
5 atëherë nuk kemi pas mundësi me bo nai aksion apo nai
6 aktivitet, për shkak të shpërbërjes, por thjesht në atë kohë
7 janë ndarë disa komunikata me radhë dhe i kam referu atyre që
8 janë bërë prej grupeve të tjera jo personalisht vetë. Se
9 atëherë kam qenë veç vetëm dhe s'kam mujt me shkru një
10 komunikatë unë në Kosovë në atë periudhë si i vetëm, pa pas
11 një grup të njerëzve të cilët kishin mujt me dhanë një besim
12 të tillë për çështje të caktuara.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua ta shtjellojmë pak më
14 tepër bashkë këtë, Dëshmitar. Besoj që keni dhënë dëshmi që dy
15 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm kanë hartuar komunikatat. I
16 kanë shkruar komunikatat. Përkatësisht Xheladin Gashi dhe Nait
17 Hasani. Për mua personalisht nuk është e qartë në qoftë se ju
18 personalisht keni marrë pjesë apo jo në diskutime si anëtar i
19 Shtabit Qendror lidhur me përmbajtjen e komunikatave. A mund
20 të na e sqaroni këtë, Dëshmitar? Na sqaroni se cila është
21 dëshmia juaj lidhur me këtë pikë.

22 PË. E thashë më duket pak ma herët, se nuk kam qenë pjesë e
23 tyre.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A është dëshmia juaj,
25 Dëshmitar, që ka pasur ose gjashtë ose shtatë ose tetë prej

1 jush në Shtabin Qendror dhe se ti personalisht nuk ke
2 diskutuar asnjëherë komunikata, por ke qenë i informuar, ke
3 qenë në dijeni të faktit që komunikatat janë botuar në Zërin e
4 Kosovës, kinse në emër të, ose pretendohet që ka qenë, janë
5 botuar në emër të Shtabit të Përgjithshëm. A e kam kuptuar
6 saktë unë këtë, Dëshmitar?

7 PË. Po, po.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A pranoni ju, Dëshmitar, që
9 formulimet ose gjuha e përdorur për disa prej këtyre
10 komunikatave, që përfshijnë, për shembull, ekzekutimin e
11 bashkëpunëtorëve ose kolaboracionistëve të pretenduar, a
12 pajtoheni me mua që gjuha ka qenë shumë e rëndë, Dëshmitar?

13 PË. Po, se nganjëherë po. Po. Për atë sa kam mujt me i pa ato
14 komunikata në atë kohë, thashë mediat e informimit kanë qenë
15 shumë të kufizuara, por nëse në një komunikatë ka pas raste
16 kur vërtet gjuha ka qenë shumë e ashpër.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Megjithatë, pavarësisht
18 kësaj, juve asnjëherë nuk i keni diskutuar përmbajtjet e
19 këtyre komunikatave me kolegët e tjerë që ishin pjesë e
20 Shtabit Qendror, kështu?

21 PË. Po unë në fillim e kam thanë më duket këtu ma herët se
22 Nait Hasani më ka thanë se "Me këtë çështje merrem unë edhe
23 Plaku, domethënë, Xheladin Gashi". Dhe realisht nuk jam marrë
24 unë me atë. Nuk jam marrë, nuk e di. Ne po përmendim shpesh
25 Naitin edhe Xheladin Gashin këtu, por ai ka thanë një, "Unë

1 merrem me këtë punë me Plakun". Realisht nuk i kam diskutu atë
2 ma gjatë.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani do ju përmend një
4 tjetër përgjigje që keni dhënë. Për procesverbal e keni dhënë
5 në faqen P181783 [Sipas përkthimit], në faqen 16. Ju thoni si
6 më poshtë:

7 "Në përgjithësi në komunikatat e mëhershme, në
8 komunikatat e para ne komunikim publikisht që UÇK-ja nuk
9 lejonte veprimtari të cilët ishin në kundërshtim me luftën e
10 popullit të Kosovës. Dhe që një apel i tillë ishte lëshuar
11 disa herë. Dhe në raste, në pjesën më të madhe të rasteve
12 ishin marrë vendime për t'i vrarë ata."

13 Kjo është përgjigjja që keni dhënë ju në 2006. Dhe prapë
14 ju këtu përdorni fjalën "tonat", dhe pastaj përdorni fjalën
15 "ne". Domethënë, kur përdorni këto përemra, "ne" dhe "të
16 tanët", për kë e keni pas fjalën, për kë nënkuptonit,
17 Dëshmitar?

18 PË. Realisht për ta, për këtë çështje shpesh është e
19 nevojshme në këto procese me qenë edhe avokati prezent, edhe
20 thjesht që të ketë ndarje, as që e kam mendu, as që e kam dit
21 se çfarë impakti mundet me pas. Kam qenë në një intervistë në
22 2006, në një presioni që e kam potencu edhe në notë, në një
23 vend ku më kujtohet mua se kur më thuhet me një intervistë se
24 hetuesve nuk jua ndin për ty, ata përdorin teknika të
25 amerikanëve sikur në Guantanamo. Dhe tash mundesh me e dit se

1 cila ka qenë mundësia për me u përgjigj, pra, atyre personave
2 të cilët ma kujtojnë mua Guantanamo dhe metodat amerikane të,
3 në Guantanamo.

4 Andaj këtu nuk e di arsyet pse, por realisht këto i kam
5 referu asaj pjesës për të cilat kam mujt me i pa në media.
6 Komunikatat e saktë i kam pa në media.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani do të kaloj tek pjesa e
8 intervistës tuaj ku ju është lexuar deklarata mbrapsht, në
9 mënyrë të tillë që të mund ta rishikonit atë çfarë kishit
10 thënë. E kam fjalën për 2006. Kjo është prova e pranuar P18786
11 [Sipas përkthimit] në faqen 12.

12 Gjatë leximit personi thotë:

13 "Në qoftë se një komandant i zonës operative pasi ka
14 marrë informacionin, në qoftë se ky person ishte i bindur që
15 një person i caktuar ishte bashkëpunëtor serb, dhe ai nuk e
16 pranonte këtë, ai mund të urdhëronte që ky person të vritej."

17 Përgjigja që ju jepni është si më poshtë:

18 "Po, kjo është e drejtë. Në këtë rast, në qoftë se një
19 person i akuzuar i cili merret në pyetje nuk ka bërë asnjë
20 lloj kontakti me personin zyrtar të UÇK-së, dhe nuk është
21 dorëzuar në autoritetet e UÇK-së se ka marrë mesazhin,
22 strukturat ushtarake do e konsideronin atë si spiun dhe do të
23 merrnin masa ndëshkuese kundër këtij personi."

24 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

25 PË. Po, i nderuar gjyqtar, por në notë e kam potencuar, nuk e

1 di nëse është bërë përmirësimi aty ku kam thanë, aty ku
2 përmenden bashkëpunëtorët, fjala për, pikërisht për policinë
3 lokale të cilët ishin të uniformuar dhe të armatosur nga
4 regjimi i Serbisë atëherë, nga policia dhe ushtria serbe. Dhe,
5 por edhe këta persona, edhe pse kanë qenë të armatosur, edhe
6 pse kanë qenë me uniformë, ne nuk kemi pas të drejtë të
7 merremi me ta, askush s'ka pas të drejtë me u marrë me ta. Me
8 ta është kanë fjala me u marrë fjala vetëm në momentin kur ata
9 ia kthejnë pushkën një ushtari të UÇK-së thjesht është bërë
10 thirrje që të mos zbrapsemi para tyre për arsye se kishte me
11 ul autoritetin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës përballë
12 bashkëpunëtorëve të, përballë bashkëpunëtorëve të uniformuar
13 dhe të armatosur të policisë serbe.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në faqen tjetër që është
15 faqja 13, ju bëhet kjo pyetje:

16 "Në qoftë se një bashkëpunëtor vazhdonte ... me
17 veprimtaritë e veta, a ishte i autorizuar komandanti i zonës,
18 a kishte të drejtë komandanti i zonës që të urdhëronte vrasjen
19 e tij?"

20 Ju përgjigjeni:

21 "Sikurse e kam përmendur më herët, ishte Shtabi i
22 Përgjithshëm i cili mbi bazë kolegjiale vendoste lidhur me
23 masat ndëshkuese kundër armikut dhe bashkëpunëtorëve të
24 armikut. Ata lajmëroheshin përmes komunikatave që të ndalonin
25 veprimtarinë e tyre me armikun."

1 Përgjigja që ju keni dhënë mua më duket sikur ka qenë
2 shumë në përputhje me gjuhën ose formulimin e përdorur në
3 komunikata që ju kanë treguar sot dhe ditëve të tjera të
4 dëshmisë përpara Trupit Gjykses.

5 PË. Po në qoftë se doni me gjet krahasime me siguri edhe me
6 mund të gjenden ndonjë fjalë e tillë, i nderuar z. Gjyqtar,
7 por realisht nuk është në natyrën, as në gjuhën teme kjo.
8 Thjesht në qoftë se po thirrna, po pyetem tash për fjalë nëse
9 janë të ngjashme apo jo, diçka tjetër, po këto po mund me qenë
10 vetëm rastësore. Nuk është një gjuhë e jemja, nuk është kjo as
11 karakteri i imi që të them, të bëj një gjuhë të tillë. Fjala
12 ka qenë gjithmonë për ato çka kam thanë unë, vetëm për policinë
13 të cilën kanë qenë të veshur, qofshin ata shqiptarë, qofshin
14 ata të tjerë nga policia dhe ushtria serbe. Domethënë si
15 njerëz të aparatit të tyre.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju bënë pyetje gjithashtu
17 edhe lidhur me faktin se kush e ka dhënë komandantëve të
18 zonës, komandantëve të brigadave, strukturave të tjera, si për
19 shembull, kompanive dhe togave. Atyre kush jua ka dhënë të
20 drejtën që të merrnin masa kundër bashkëpunëtorëve që
21 perceptoheshin si të tillë? Pyetja është kjo:

22 "... kush jua dha atyre këtë të drejtë?"

23 Përgjigja që ju jepni ishte:

24 "Shtabi i Përgjithshëm."

25 Kur keni dhënë këtë përgjigje, Dëshmitar, nga e dinit ju

1 që këtë të drejtë jua ka dhënë atyre Shtabi i Përgjithshëm?
2 PË. Edhe këtë e kam thanë, është iu kam referu komunikatave
3 të cilat janë botuar në medime të ndryshme, ku iu është bërë
4 thirrje të gjithë këtyre bashkëpunëtorëve që po quan tash në
5 gjuhën, kolaboracionist, që u është bo thirrje me hjek dorë
6 nga veprimtaria e tyre. Unë iu kam referu vetëm komunikatave.
7 Jo që kam pas informacion të Shtabit të Përgjithshëm, për këtë
8 çështje.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do ju kërkoja që të sqaroni
10 një përgjigje tjetër të dhënë. Për procesverbal këtë e keni
11 thënë në faqen 16 të të njëjtit numër prove. Përgjigjja që ju
12 jepni është kjo:

13 "Mos harroni se kur urdhrat për ekzekutimin e
14 bashkëpunëtorëve jepeshin, ato mund të kryheshin, pra, urdhrat
15 mund të ekzekutoheshin nga çdokush që i njihte ata, sepse ata
16 do të futeshin ditë e natë. Kështu që për qëllime të marrjes
17 së informacionit nga rangjet e UÇK-së, bashkëpunëtorët
18 lëviznin ditë e natë përmes kanaleve sekrete."

19 A mund të na shpjegosh, mund të më shpjegosh, Dëshmitar,
20 se çfarë ke dashur të thuash që bashkëpunëtorët lëviznin ditë
21 e natë përmes kanaleve sekrete? Ju lutem, na e shpjegoni, na e
22 shtjelloni pak më tepër përgjigjen që keni dhënë në këtë rast?

23 PË. Kjo është për të njëjtit njerëz të cilët kanë qenë të
24 instaluar. Policia, policia lokale, të cilën e ka vesh atë
25 Serbia, pra policia serbe, kanë qenë fshatarë të cilët kanë

1 jetuar shpeshherë edhe në mesin e fshatrave tona. Dhe ata
2 normalisht s'e [E pakuptueshme] hy dhe, edhe nuk kanë lëviz
3 nga pjesa që kemi mujt ne me i identifiku ose me i kontrollu
4 nga ushtarët e UÇK-së, por kanë hi nëpër hapësirat që i kanë
5 anashkalu prezencën e ushtarëve të UÇK-së, dhe kanë mujt me
6 marrë informacione të ndryshme. Këtë kam dasht me thanë.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Së fundi, në fakt këtë temë
8 e kemi diskutuar dhe më herët, megjithatë, dua që të sqaroni
9 se cila është baza e njohurive tuaja. E kam fjalën për provën
10 P1870.6, faqja 18.

11 Pyetja ju bëhet është kjo:

12 "Kur jepej urdhri për vrasjen e bashkëpunëtorëve nga
13 Shtabi i Përgjithshëm, ai mund të zbatohet nga çdokush që mund
14 të identifikonte bashkëpunëtorin."

15 Pra, duhet që ta sqaroj që këtë jua ka lexuar përkthyesi
16 deklaratën.

17 Dhe përgjigjja që ju keni dhënë është: "Po".

18 Tani, pyetja që kam për juve është kjo: Nga e dinit juve
19 këtë, si e dinit juve këtë?

20 PË. Edhe një herë se -- e përshkrova situatën pastaj nuk
21 mujta me kuptu thelbin e pyetjes, i nderuar Gjyqtar. Nëse ka
22 mundësi.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po, patjetër. Në transkript
24 thuhet:

25 "Përkthyesi vazhdon që t'i lexojë pjesën e mbetur të

1 deklaratës dëshmitarit."

2 Dhe përkthyesi thotë:

3 "Kur urdhri për vrasjen e bashkëpunëtorëve jepej nga
4 Shtabi i Përgjithshëm, ai, urdhri pra, mund të zbatohet prej
5 çdokujt që mund të identifikonte bashkëpunëtorin."

6 Përgjigjja që ju jepni është: "Po".

7 Tani, pyetja që kam unë për ty është kjo: Nga e dinit ju
8 këtë gjë, domethënë ku e bazoni këtë përgjigje? Ku, nga e dini
9 që përgjigjja është kjo?

10 PË. Thjesht nga leximi i komunikatave që u dhanë në opinion.
11 Të cilat kanë qenë të njohura për krejt publikun, por
12 gjithsesi edhe për ushtarët e UÇK-së të cilët kanë qenë nëpër,
13 nëpër zona. Unë iu kam referu vetëm komunikatave të cilat kanë
14 dhanë një, kanë bo një thirrje të tillë për këto kategori. Dhe
15 unë personalisht pastaj e kam dhanë edhe mendimin tim se çka
16 kuptoj me fjalën "kolaboracionist", dhe pse një qytetar, pse
17 ka bashkëpunu me një serb nuk ka mujt me u qujt
18 kolaboracionist, ose pse ka ba një biznes me një serb, nuk ka
19 mujt me u qujt kolaboracionist. E keni aty në dëshminë time.
20 Thjesht fjala ka qenë gjithmonë për struktura të aparatit
21 serb.

22 Dhe informacionin e kam marrë vetëm nga këto, bash me
23 thanë, nga informacioni që kam marrë në media për komunikatat
24 që janë lëshu.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Për periudhën kur keni qenë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 159

1 anëtar i Shtabit Qendror dhe Shtabit të Përgjithshëm, a e keni
2 sqaruar se si Shtabi i Përgjithshëm i shpërndante ose i
3 komunikonte vartësve të vet, ose njësiteve vartëse, një urdhër
4 për të vrarë një bashkëpunëtor të caktuar? Si ndodhte kjo, si
5 realizohej kjo në praktikë?

6 PË. Aty ka qenë pyetja hipotetike ma shumë, por unë nuk e di
7 që ka pas një urdhër të Shtabit të Përgjithshëm për raste të
8 veçanta me emër e mbiemër që ky apo ai kolaboracionist duhet
9 të ekzekutohej. Nuk kemi pas as dhe një urdhër. Thjesht në
10 gjenerale, thirrja është bo në gjenerale. Dhe ma tepër kanë
11 qenë, e kuptoj që ma tepër kanë qenë komunikata si propagandë
12 e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe një lloj vërejtje
13 për me ia tërhjek vërejtjen të gjithë atyre të cilët vërtet
14 kanë mundur që ta dëmtojnë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të
15 Kosovës me aksionet e tyre kundër Ushtrisë Çlirimtare të
16 Kosovës me armë në dorë.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera për
18 ju, Dëshmitar, faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
20 Ka pyetje plotësuese nga Prokurori?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Faleminderit, Kryegjykatës.

24 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic:

25 Z. MISETIC: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 160

1 PY. Dëshmitar, kam disa pyetje të tjera plotësuese për ju që
2 do t'i vazhdoj dhe nesër. Së pari, do i kërkoja Sekretares që
3 të paraqesë një dokument. Juve ju bënë shumë pyetje lidhur me
4 përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm fillimisht Shtabi Qendror
5 në 1995, 1996, 1997.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Kështu që për këtë arsye do i
7 kërkoja Sekretares që të paraqesë në ekran një dokument që
8 sapo e kemi ngarkuar në listën e dokumenteve tona që është
9 SPOE00209518-00209528-ET në anglisht. Ndërkohë që versioni në
10 shqip ka numrin SPOE00209513 deri në 00209543.

11 PY. Do t'ju tregoj një intervistë të dhënë nga Nait Hasani në
12 vitin 2002, ku i është përgjigjur kësaj pyetjeje.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Në anglisht do kërkoja që të
14 shkojmë tek faqja 9520 dhe në versionin shqip po e njëjta
15 faqe, me të njëjtin numër. Besoj është drejt fundit të faqes.
16 Jo, ju kërkoj ndjesë, në fillim, në krye të faqes.

17 PY. Dëshmitar, kjo është diçka që ai e ka thënë në 2002:

18 "Kush përbënte Shtabin Qendror të UÇK-së?"

19 Përgjigja e tij ishte:

20 "Në Shtab bënë pjesë Azem Syla, Nait Hasani, Xheladin
21 Gashi, Sokol Bashota, Xhavit Haliti e Ali Ahmeti. Ndërkohë
22 Azem Syla ishte drejtuesi i Shtabit."

23 Këto gjashtë emra a janë në përputhje me gjashtë emrat që
24 keni përmendur ju në dëshminë tuaj, Dëshmitar?

25 PË. Po, i nderuar.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 161

1 PY. Faleminderit.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kërkoj që kjo
3 faqe e intervistës të pranohet në prova gjyqësore.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
5 kundërshtim?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Ne parashtrojmë që do ishte mirë
7 që të përdoret e gjithë intervista në mënyrë të tillë që ta
8 kemi të qartë kontekstin.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk duhet fare konteksti këtu,
10 ishte një pyetje e thjeshtë, edhe kjo pyetje lidhej me pjesën
11 e faqes që kërkoj të pranohet në provë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për cilën
13 faqe bëhet fjalë?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Është faqja SPOE00209520.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo faqe do
16 të pranohet në prova gjyqësore.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
18 kjo faqe do të marrë numrin e provës 1D223. A mund të na thoni
19 çfarë klasifikimi t'i vendosim?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Klasifikojeni si publike.
21 Faleminderit.

22 PY. Dëshmitar, do të kalojmë te një pjesë tjetër, te një
23 fragment tjetër i një libri që quhet "Flet komandant Remi".
24 Këtu trajtohet çështja ose tema se kush i lëshonte
25 komunikatat.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 162

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares
2 të paraqesë në ekran dokumentin SPOE00053263 deri në
3 SPOE00053359 në versionin anglisht. Ndërkohë që dokumenti në
4 shqip mban numrin SPOE00330195 deri në 00330361. Në anglisht
5 paraqitet faqja SPOE00053284, ndërkohë që në shqip
6 SPOE00330226.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të na thoni se
8 në çfarë liste materialesh gjenden këto dokumente?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Në listën fillestare.

10 PY. Dëshmitar, ndërkohë që paraqitet dokumenti në ekran, z.
11 Mustafa ka dhënë dëshmi dhe ka thënë që ai nuk e ka ditur se
12 kush ka qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm deri në shtator
13 të 1997. A mund të na thoni se kur jeni njohur me Rustem
14 Mustafën, me komandant Remin? Kur e keni njohur për të parë
15 këtë?

16 PË. Nuk mund, nuk e di. S'më kujtohet takimi i parë me të.

17 PY. Ai ka marrë rolin që kishte më përpara Zahir Pajaziti në
18 zonën e Llapit, apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Po, kështu e kujtoj.

20 PY. Në qoftë se ai ka qenë i përfshirë në veprimtari pas
21 vdekjes së Zahir Pajazitit, ai është koordinuar, është
22 bashkërenduar me juve, është ndërlidhur me juve?

23 PË. Në fillim ka mujt me u ndërlidh me Xheladin Gashin, por
24 ma vonë me mu. Jemi taku ma vonë, por nuk e di saktë kur [E
25 pakuptueshme].

1 PY. A keni ndonjë arsye për të kontestuar dëshminë e tij se
2 deri të paktën në shtator të 1997 ai nuk dinte se kush ishin
3 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm?

4 PË. Ka mundësi.

5 PY. Kjo pjesë është marrë nga një libër që quhet "Flet
6 komandant Remi". Atij i bëhet një pyetje:

7 "Kur janë nxjerrë deklaratat e para në emër të UÇK-së?"

8 Në përgjigje ai thotë:

9 "Nuk e kam idenë. Gjithmonë është thënë që deklaratat
10 janë dhënë nga Prishtina, megjithatë nuk mund të them shumë
11 mundësi lidhur me këtë. E di që Zahiri vetë ka hartuar
12 deklarata të vazhdueshme. Ai ka komunikuar me një telefon në
13 një vend të huaj dhe kështu janë lëshuar komunikatat."

14 "Po hollësi të tjera?"

15 Ai thotë që:

16 "Unë nuk do përqendrohesha në dy, tre komunikatat e para.
17 Unë e di që Zahiri ka nxjerrë shumë prej këtyre deklaratave.
18 Dhe në atë kohë Hakif që ishte, Hakifi që ishte vëllai i
19 Zaimit, Bajrami, pra që ka qenë në Teatrin Kombëtar, ka
20 përdorur, i ka përdorur, është përdorur për lëshimin e këtyre
21 deklaratave. Ndërkohë që për sa i takon një çështjeje teknike,
22 kjo çështje teknike është që vëllai i tij ka pasur një telefon
23 i cili nuk mund të përgjohej."

24 Tani, pyetja që kam për juve është kjo. A është e vërtetë
25 ajo çfarë thotë z. Remi këtu, domethënë, z. Mustafa dhe ai

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 164

1 këtu thotë që grupet operacionale mund të komunikojnë në
2 mënyrë të drejtpërdrejtë me dikë jashtë vendit për të
3 përcjellë informacion që më pas do të pasqyrohet në komunikata
4 pa shkuar dhe e konsultuar këtë me asnjë pjesë të Shtabit të
5 Përgjithshëm. A është e saktë kjo?

6 PË. Po, kjo është e saktë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kjo është një
8 faqe e një prove ekzistuese, domethënë do kërkoja që edhe kjo
9 faqe të shtohet provës që aktualisht mban numrin 0188.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
11 kundërshtim?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faqja
14 SPOE00053284 në shqip dhe në anglisht pranohet si provë
15 gjyqësore dhe do t'i bashkohet provës ekzistuese P0188.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
17 -- faleminderit, Kryegjykatës. Shikoj që ka ardhur koha për ta
18 mbyllur për sot.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
20 përfunduar dhe sot. Faleminderit që ishit me ne sot, dhe do të
21 doja të thoja që nuk duhet të flisni me askënd për dëshminë
22 tuaj.

23 Do kthehemi përsëri këtu në orën 9.00 të mëngjesit.

24 Shihemi nesër paradite, Dëshmitar.

25 DËSHMITARI: Faleminderit.

1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 Mund të vazhdoni, z. Dixon.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk doja që t'ju ndërprisja dhe po
5 prisja që të dilte dhe dëshmitari nga salla.

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 Dhe sikurse e kemi thënë shpeshherë në të shkuarën, kur
13 ZPS-ja nuk ka të drejtë që të përdorë dëshmi të tilla në qoftë
14 se nuk thërret dëshmitarin. Kështu që për këtë arsye ne
15 mendojmë që ky dokument nuk duhet të përdoret për të bërë
16 pyetje për dëshmitarët e tjerë.

17 Sepse, nuk është një dokument mbi të cilin mbështetet
18 ZPS-ja dhe kjo shkel të drejtat tona si Mbrojtje, sepse është
19 e pamundur për ne për të bërë pyetje lidhur me këtë dokument
20 sepse nuk do të ketë dëshmitar të Prokurorisë lidhur me këtë
21 dokument. Ky është një koment i cili nuk vlen vetëm për këtë
22 dokument, por edhe për raste të tjera të ngjashme në të
23 ardhmen.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju po kërkon
25 një kundërshtim në vazhdimësi për çështje të kësaj natyre?

1 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Z. HALLING: [Përkthim] A mund të jap unë shkurtimisht një
4 përgjigje? Kjo në fakt keqinterpretton praktikën në këtë proces
5 gjyqësor. Deklaratat e dëshmitarëve të cilët nuk janë
6 dëshmitarë të ZPS-së, në mënyrë të zakonshme u janë treguar
7 dhe dëshmitarëve të tjerë. Nuk ka pikë dallimi në qoftë se
8 bëhet fjalë për një dëshmitar të thërritur prej nesh, ose pra
9 në qoftë se statusi i dëshmitarit ndryshon apo jo.

10 Mbrojtja duhet të përdorë gjithashtu intervistën e ZPS-së
11 me të njëjtin dëshmitar edhe kjo ka ndodhur edhe në raste të
12 tjera të mëparshme.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, do i përgjigjem
14 unë kësaj.

15 Unë këtë intervistë e kam përdorur sepse është përdorur
16 nga Prokuroria me këtë dëshmitar, megjithatë komenti që bëri
17 Prokurori është i pavend. Është e pandershme që të bëhet një
18 koment i tillë dhe të ilustruhet ai me këtë shembull.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

20 Faleminderit.

21 E mbyllim seancën për sot, do të shihemi përsëri në orën

22 9.00

23 --- Seanca mbyllet në orën 16.32

24

25